

الله
رسول
محمد

**VETËM DASHURIA
MUND T'I SHKAKTOJË
DISFATË TERRORIZMIT**



**HARUN YAHYA
(ADNAN OKTAR)**

In 2001, jet planes were crashed into the World Trade Center and the Pentagon, injuring and killing thousands. In the days following these attacks, the world began debating the concept of terrorism that lay behind them. An atmosphere of fear and panic grew, especially in the United States. But that didn't last long: Soon the entire world began wondering how best to combat terrorism.

As soon as America recovered from the shock of 9/11, it joined with a large number of other countries to launch a worldwide war on terrorism. Right from the start, however, officials of this powerful coalition declared openly that it wouldn't be enough for them to fight on the military field alone. How should the struggle against terrorism be pursued?

This book concentrates on the only way it can be eradicated: by means of peace, tolerance, and love. This book offers examples from the Qur'an as well as from the Bible to show how each of the three divine religions forbids the use of unjust violence. It also gives examples to show that the only way to fight terrorism is to heal the root causes through the love, affection, compassion, humility, forgiveness, tolerance and concepts of justice that religion's morality instills in people--whom, following the verse from the Qur'an (10:25): "God calls to the Abode of Peace..." Such fortunates will do their utmost to build a world full of peace and love.




DY FJALË RRETH AUTORIT


I njohur me emrin HARUN JAHJA, Adnan Oktar, u lind në Ankara në vitin 1956. Pasi kreu studimet fillore dhe të mesme në Ankara, ai studioi për arte në Universitetin Mimar Sinan në Stamboll dhe filozofi në universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, ai ka botuar mjaft libra në lidhje me çështje politike, shkencore, dhe fetare. Duke qenë mjaft të vlerësuara në të gjithë botën, këto vepra kanë shërbyer për shumë njerëz si mjet për të gjetur besimin në Zot dhe për të arritur një njohje më të thellë për besimin e

tyre. Librat e Harun Jahjasë u drejtohen të gjithë lexuesve, pa marrë parasysh moshën, racën, apo kombësinë e tyre, sepse ata përqendrohen në një synim: të hapin horizontin e lexuesit duke e nxitur atë të mendojë për disa çështje të rëndësishme, si qenia e Allahut dhe Njeshmëria e Tij dhe të jetuarit sipas vlerave që Ai ka përcaktuar për ne.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



اللَّهُ
رَسُولُ
مُحَمَّدٍ



**VETËM DASHURIA
MUND T'I SHKAKTOJË
DISFATË TERRORIZMIT**

**HARUN YAHYA
(ADNAN OKTAR)**



PËR AUTORIN

The author, ëho ërites under the pen-name HARUN YAHYA, ëas born in Ankara in 1956. Having completed his primary and secondary education in Ankara, he then studied arts at Istanbul's Mimar Sinan University and philosophy at Istanbul University. Since the 1980s, the author has published many books on political, faith-related and scientific issues. Harun Yahya is ëell-knoën as an author ëho has ëritten very important ëorks disclosing the imposture of evolutionists, the invalidity of their claims and the dark liaisons betëeen Darëinism and bloody ideologies such as fascism and communism.

His pen-name is made up of the names "Harun" (Aaron) and "Yahya" (John), in memory of the tëo esteemed prophets ëho fought against lack of faith. The Prophet's seal on the cover of the author's books has a symbolic meaning linked to their contents. This seal represents the Koran, the last Book and the last ëord of God, and our Prophet, the last of all the prophets. Under the guidance of the Koran and Sunnah, the author makes it his main goal to disprove each one of the fundamental tenets of godless ideologies and to have the "last ëord", so as to completely silence the objections raised against religion. The seal of the Prophet, ëho attained ultimate ëisdom and moral perfection, is used as a sign of his intention of saying this last ëord.

All these ëorks by the author centre around one goal: to convey the message of the Koran to people, thus encouraging them to think about basic faith-related issues, such as the existence of God, His unity and the hereafter, and to display the decrepit foundations and perverted ëorks of godless systems.

Harun Yahya enjoys a ëide readership in many countries, from India to America, England to Indonesia, Poland to Bosnia, and Spain to Brazil. Some of his books are available in English, French, German, Italian, Spanish, Portuguese, Urdu, Arabic, Albanian, Russian, Serbo-Croat (Bosnian), Polish, Malay, Uygur Turkish, and Indonesian, and they have been enjoyed by readers all over the ëorld.


Greatly appreciated all around the ëorld, these ëorks have been instrumental in many people putting their faith in God and in many others gaining a deeper insight into their faith. The ëisdom, and the sincere and easy-to-understand style employed give these books a distinct touch ëhich directly strikes any one ëho reads or examines them. Immune to objections, these ëorks are characterised by their features of rapid effectiveness, definite results and irrefutability. It is unlikely that those ëho read these books and give a serious thought to them can any longer sincerely advocate the materialistic philosophy, atheism and any other perverted ideology or philosophy. Even if they continue to advocate, this ëill be only a sentimental insistence since these books have refuted these ideologies from their very basis. All contemporary movements of denial are ideologically defeated today, thanks to the collection of books ëritten by Harun Yahya.

There is no doubt that these features result from the ëisdom and lucidity of the Koran. The author certainly does not feel proud of himself; he merely intends to serve as a means in one's search for God's right path. Furthermore, no material gain is sought in the publication of these ëorks.

Considering these facts, those ëho encourage people to read these books, ëhich open the "eyes" of the heart and guide them in becoming more devoted servants of God, render an invaluable service.

Meanëhile, it ëould just be a ëaste of time and energy to propagate other books ëhich create confusion in peoples' minds, lead man into ideological chaos, and ëhich, clearly have no strong and precise effects in removing the doubts in peoples' hearts, as also verified from previous experience. It is apparent that it is impossible for books devised to emphasize the author's literary poëer rather than the noble goal of saving people from loss of faith, to have such a great effect. Those ëho doubt this can readily see that the sole aim of Harun Yahya's books is to overcome disbelief and to disseminate the moral values of the Koran. The success, impact and sincerity this service has attained are manifest in the reader's conviction.

One point needs to be kept in mind: The main reason for the continuing



cruelty and conflict, and all the ordeals the majority of people undergo is the ideological prevalence of disbelief. These things can only come to an end with the ideological defeat of disbelief and by ensuring that everybody knows about the wonders of creation and Koranic morality, so that people can live by it. Considering the state of the world today, which forces people into the downward spiral of violence, corruption and conflict, it is clear that this service has to be provided more speedily and effectively. Otherwise, it may be too late.

It is no exaggeration to say that the collection of books by Harun Yahya have assumed this leading role. By the Will of God, these books will be the means through which people in the 21st century will attain the peace and bliss, justice and happiness promised in the Koran.

The works of the author include The New Masonic Order, Judaism and Freemasonry, Global Freemasonry, Islam Denounces Terrorism, The Disasters Darwinism Brought to Humanity, Communism in Ambush, Fascism: The Bloody Ideology of Darwinism, The 'Secret Hand' in Bosnia, Behind the Scenes of The Holocaust, Behind the Scenes of Terrorism, Israel's Kurdish Card, The Oppression Policy of Communist China and Eastern Turkestan, Solution: The Values of the Qur'an, The Fetter of Islam and Its Expected Spring, Articles 1-2-3, A Weapon of Satan: Romanticism, Signs from the Chapter of the Cave to the Last Times, Signs of the Last Day, The Last Times and The Beast of the Earth, Truths 1-2, The Eastern World Turns to God, The Evolution Deceit, Precise Answers to Evolutionists, The Blunders of Evolutionists, Confessions of Evolutionists, The Qur'an Denies Darwinism, Perished Nations, For Men of Understanding, The Prophet Moses, The Prophet Joseph, The Prophet Mohammed, The Prophet Solomon, The Golden Age, Allah's Artistry in Colour, Glory is Everywhere, The Importance of the Evidences of Creation, The Truth of the Life of This World, The Nightmare of Disbelief, Knowing the Truth, Eternity Has Already Begun, Timelessness and the Reality of Fate, Matter: Another Name for Illusion, The Little Man in the Tower, Islam and the Philosophy of Karma, The Dark Magic of Darwinism, The Religion of Darwinism, The Collapse of the Theory of Evolution in 20 Questions, Allah is Known Through Reason, The Qur'an Leads the Way to Science, The Real Origin of Life, Consciousness in the Cell, A String of Miracles, The Creation of the Universe, Miracles of the Qur'an, The Design in Nature, Self-Sacrifice and Intelligent Behaviour Models in Animals, The End of Darwinism, Deep Thinking, Never Plead Ignorance, The Green Miracle: Photosynthesis, The Miracle in the Cell, The Miracle in the Eye, The Miracle in the Spider, The Miracle in the Gnat, The Miracle in the Ant, The Miracle of the Immune System, The Miracle of Creation in Plants, The Miracle in the Atom, The Miracle in the Honeybee, The Miracle of Seed, The Miracle of Hormone, The Miracle of the Termite, The Miracle of the Human Body, The Miracle of Man's Creation, The Miracle of Protein, The Miracle of Smell and Taste, The Secrets of DNA.

The author's childrens books are: Wonders of Allah's Creation, The World of Animals, The Splendour in the Skies, Wonderful Creatures, Let's Learn Our Religion, The World of Our Little Friends: The Ants, Honeybees That Build Perfect Combs, Skillful Dam Builders: Beavers.

The author's other works on Quranic topics include: The Basic Concepts in the Qur'an, The Moral Values of the Qur'an, Quick Grasp of Faith 1-2-3, Ever Thought About the Truth?, Crude Understanding of Disbelief, Devoted to Allah, Abandoning the Society of Ignorance, The Real Home of Believers: Paradise, Knowledge of the Qur'an, Qur'an Index, Emigrating for the Cause of Allah, The Character of the Hypocrite in the Qur'an, The Secrets of the Hypocrite, The Names of Allah, Communicating the Message and Disputing in the Qur'an, Answers from the Qur'an, Death Resurrection Hell, The Struggle of the Messengers, The Avoiced Enemy of Man: Satan, The Greatest Slander: Idolatry, The Religion of the Ignorant, The Arrogance of Satan, Prayer in the Qur'an, The Theory of Evolution, The Importance of Conscience in the Qur'an, The Day of Resurrection, Never Forget, Disregarded Judgements of the Qur'an, Human Characters in the Society of Ignorance, The Importance of Patience in the Qur'an, General Information from the Qur'an, The Mature Faith, Before You Regret, Our Messengers Say, The Mercy of Believers, The Fear of Allah, Jesus Will Return, Beauties Presented by the Qur'an for Life, A Bouquet of the Beauties of Allah 1-2-3-4, The Iniquity Called "Mockery," The Mystery of the Test, The True Eidom According to the Qur'an, The Struggle with the Religion of Irreligion, The School of Yusuf, The Alliance of the Good, Slanders Spread Against Muslims Throughout History, The Importance of Following the Good Word, Why Do You Deceive Yourself?, Islam: The Religion of Ease, Enthusiasm and Excitement in the Qur'an, Seeing Good in Everything, How do the Unwise Interpret the Qur'an?, Some Secrets of the Qur'an, The Courage of Believers, Being Hopeful in the Qur'an, Justice and Tolerance in the Qur'an, Basic Tenets of Islam, Those Who do not Listen to the Qur'an, Taking the Qur'an as a Guide, A Lurking Threat: Heedlessness, Sincerity in the Qur'an.

PËR LEXUESIN

Arsyeja pse një kapitull i veçantë i është kushtuar teorisë së evolucionit është se kjo teori përmban bazat e të gjitha filozofive anti-shpirtërore (fetare). Pasi që Darwinizmi kundërshton faktin e krijimit, dhe me këtë, ekzistencën e Zotit, në këto 140 vitet e fundit ka bërë që shumë njerëz ta braktisin besimin e tyre apo të bien në dyshim. Kështu që, të treguarit se kjo teori është një mashtrim është një detyrë e rëndësishme, e cila është ngushtë e lidhur me religjionin. Është e domosdoshme që ky shërbim i rëndësishëm t'i ofrohet secilit. Disa nga lexuesit tanë mund të kenë shansin që të lexojnë vetëm një nga librat tonë. Kështu që, ne mendojmë se është me vend që një kapitull t'ia kushtojmë kësaj teme.

Të gjitha librat e autorit shpjegojnë në dritën e vargjeve Kur'anore çështje që kanë të bëjnë me besimin dhe njerëzit ftohen që të mësojnë fjalët e Allahut dhe të jetojnë sipas tyre. Të gjitha temat që kanë të bëjnë me vargjet e Allahut janë të sqaruara në atë mënyrë sa që nuk lënë hapësirë për dyshim apo pyetje në mendjen e lexuesit. Stili i qartë dhe i rrjedhshëm bëjnë që lexuesi i çdo moshe dhe nga cilido grup shoqëror t'i kuptoj ato me lehtësi. Ky tregim efektiv dhe i qartë bën të mundur që ato të lexohen shumë shpejt. Edhe ata të cilët ashpërsisht kundërshtojnë natyrën shpirtërore janë të influencuar nga faktet që këto libra dokumentojnë dhe nuk mund të hedhin poshtë vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Ky dhe të gjithë librat e tjerë të autorit mund të lexohen në mënyrë individuale, apo të diskutohen në grup. Lexuesit e etshëm që të marrin sa më shumë nga librat e shikojnë të dobishëm diskutimin duke ia treguar njëri tjetrit mendimet dhe përvojat.

Përveç kësaj, është në shërbim të madh të religjionit që të kontribohet në prezantimin dhe leximin e këtyre librave, të cilat janë të shkruara vetëm për kënaqësin e Allahut. Të gjithë librat e autorit janë jashtëzakonisht bindës. Për këtë arsye, ata të cilët dëshirojnë t'ju komunikojnë fenë njerëzve të tjerë, njëra nga metodat më efektive është inkurajimi i tyre që të lexojnë këta libra.

Shpresojmë se lexuesi do të shikojë pasqyrën e librave të tjerë në fund të këtij libri dhe të vlerësoj materialin e pasur në çështjet e lidhura me besimin, të cilat janë të dobishme dhe kënaqësi për t'u lexuar.

Në këta libra, nuk do të gjeni, sikurse në disa libra tjerë, pikëpamje personale të autorit, sqarime të bazuara në burime të dyshimta, stile të zhveshura nga respekti dhe nderimi i duhur i temave të shenjta, e as rrëfime të pashpresa, dyshim-nxitëse dhe pesimiste që krijojnë dyshime në mendje dhe devijime në zemër.

www.harunyahya.com

HYRJE...8

TAKSA E PËRGJAKSHME E TERRORIT...20

**IDEOLOGJITË ATEISTE DHE
LINDJA E TERRORIZMIT...34**

**VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË
DISFATË TERRORIZMIT...48**

**NJË THIRRJE PËR PAQE: TOLERANCA DHE
PARIMET E VËRTETA MORALE NË
DHIATËN E VJETËR DHE TË RE...98**


**MORALI FISNIK I PROFETIT
MUHAMMED (savs)...132**

**ZGJIDHJET PËR TERRORIN DHE ANARKINË
NGA BEDIUZZAMAN SAID NURSI...150**

PËRFUNDIM...164

MASHTRIMI I EVOLUCIONIT...178

HYRJE



Në vitin 2001, aeroplanët reaktiv u përplasën në Qendrën Botërore të Tregtisë dhe në Pentagon, duke lënduar dhe vrarë me mijëra njerëz. Në ditët që pasuan këto sulme – plotësisht të papritura për nga koha dhe mënyra, të drejtuara kundër superfuqisë së vetme botërore – bota filloi të diskutoj për konceptin e terrorizmit që lanë pas.

U krijua një atmosferë frike dhe panik, posaçërisht në Shtetet e Bashkuara. Por kjo nuk zgjati shumë: Së shpejti e tërë bota filloi të pyetet se cila ishte mënyra më e mirë për ta luftuar terrorizmin. Asnjë vend më nuk mund të qëndronte mënjane nga lufta kundër terrorizmit dhe të deklaronte: “Ato sulme nuk ishin të drejtuara nga ne.” Qytetarët e secilit komb kuptuan se do të mund të mund të ballafaqoheshin në çdo kohë me fytyrën e errët të terrorizmit, qoftë kur janë duke fjetur, duke shikuar televizion, duke i dërguar fëmijët në park apo duke punuar në zyre. Ata kuptuan se qëllimi i terrorizmit ishte të paralizonte shoqërinë, duke bërë që qytetarët të ngurrojnë të dalin në rrugë, të përdorin sa më pak transportin publik apo të shkojnë të blejnë – thënë shkurt, të krijoj një atmosferë të përhershme frike. Posa Amerika rimori veten nga shoku i 9/11, u bashkua me një numër të madh të vendeve tjera për të nisur një luftë botërore kundër terrorizmit. Mirëpo, që nga fillimi zyrtarët e këtij koalicioni të fuqishëm deklaruan haptas se nuk do të mjaftonte të luftohej vetëm në fushën ushtarake.

Si duhet të vazhdohet lufta kundër terrorizmit? Për të

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

dhënë përgjigjen në këtë pyetje, duhet t'i identifikojmë rrënjët e terrorizmit. Për ta bërë këtë, duhet ta analizojmë rrjedhën e shekullit të kaluar, gjatë të cilit terrorizmi u shfaq për herë të parë si kërcënim serioz.

Dy Luftërat Botërore të shekullit 20, bashkë me shumë konflikte regjionale dhe akte të ndryshme të dhunës vendore, e shndërruan atë në shekullin më të përgjakshëm. Veç kësaj, drejt fundit të mijëvjeçarit, përparimet e vazhdueshme teknologjike vetëm sa ndihmuan terroristët që të zgjerojnë shtrirjen e tyre. Sot, vetëm një prekje e një butoni do të mund të vriste me qindra njerëz të pafajshëm. Terrorizmi i teknologjisë së lartë do të mund t'i shkaktonte dëme prej miliarda dollarësh cilëndo ekonomi kombëtare dhe të modelonte politikën botërore pa u shfaqur kurrë haptas. Është e qartë se pas sulmeve në Nju Jork dhe Uashington D.C. në Shtetet e Bashkuara – fuqinë më të madhe teknologjike në



September 11 resulted in the deaths of thousands of people, and in injuries to many more.



VETËM DASHURIA MUND T’I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

botë – asnjë vend tjetër nuk mund ta konsideroj veten të sigurt nga terrorizmi apo larg shtrëngimit të tij vdekjeprurës. Ç’është më e keqja, nëse nuk ndërmerren kundërmarrjet e nevojshme, terrorizmi i shekullit 21 do të bëhet edhe më i fuqishëm, derisa një sulm i vetëm kimik, biologjik apo madje bërthamor mund të vras dhjetëra mijëra njerëz.

DEFINICIONI I VËRTETË I TERRORIZMIT

Me terrorizmin që dominon rendin e ditës në botë, definicionet e terrorit, terroristit dhe të terrorizmit marrin një domethënie krejtësisht tjetër. Shumë vende e definojnë terrorizmin, hartojnë profilet terroriste dhe i publikojnë listat e organizatave terroriste në dritën e interesave të tyre kombëtare. “Organizatave që konsiderohen terroriste” prej disa vendeve për vendet tjerat janë luftëtarë të lirisë. Kombet që një vend i konsideron “terroriste,” tjetri vend i pranon si “aleat besnik.” Prandaj, kush e definon terrorizmin? Kush e përcakton – dhe në çfarë mënyre e përcakton – se ç’është një terrorist? Për të vendosur një kriter, njeriu mund të nxjerr në pah dy karakteristika të veçanta të terrorizmit:

1) Marrja në shenjë e civilëve: Secili vend i okupuar ka të drejtë t’i kundërvihet një ushtrie e cila e okupon territorin e tij. Por nëse kjo rezistencë përfshin sulme në caqe civile, çdo arsytim bëhet i pavlefshëm. Siç do ta shohim më vonë në këtë libër, ky definicion është në harmoni të plotë me rregullat Islamike mbi luftën. Profeti Muhammed (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) i ka urdhëruar pasuesit e tij të luftojnë kundër atyre që u

TERROR'S VENUE



Time,




Newsweek, 27.09.93



Time, 21.08.2000



Time, 17.08.98



Time, 29.04.96



Newsweek, 04.02.2002

Terrorism is currently costing lives in many countries across the world. In the fight against it, terrorism's ideological foundations must be torn down. To this end, everyone who believes in peace must pull together.

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

kanë shpallur luftë atyre. Por ai po ashtu ju urdhëroi atyre që kurrë të mos i konsiderojnë civilët si objekte sulmi. Përkundrazi, secili Mysliman u urdhërua – dhe ende është i obliguar – të jetë shumë i kujdesshëm për të siguruar sigurinë e atyre që nuk luftojnë.

2) Shkatërrimi i paqes: Nëse nuk ka gjendje lufte, atëherë terrorizmi mundet të përfshijë gjithashtu sulmet në caqe ushtarake apo zyrtare. Sulmet që kanë për qëllim të prishin marrëdhëniet paqësore në mes të shteteve apo shoqërive janë akte të terrorizmit, madje edhe kur të jenë të drejtuara ndaj caqeve ushtarake.

Të gjitha sulmet që kërcënojnë paqen apo që janë të drejtuara ndaj caqeve civile, madje edhe në gjendje lufte, janë terrorizëm. Nuk mund të bëhet fjalë për mbrojtjen, miratimin apo arsyetimin e sulmeve të tilla. Megjithatë, një dhunë e tillë është shumë e përhapur në botën moderne. Për këtë arsye çfarëdo lufte ndaj terrorizmit duhet të jetë gjithëpërfshirëse. Secila fazë e saj duhet të planifikohet me kujdes, me qëllimin përfundimtar të çrrënjosjes totale të tërë këtij koncepti. Kjo, pastaj, kërkon që individët në secilin komb të distancohen plotësisht nga terrorizmi. Çdo formë e terrorizmit duhet të dënohet qartë – pavarësisht prej arsyeve apo qëllimeve të saj, pavarësisht prej caqeve të saj, ku lind ajo, apo si bëhet ajo. Ngjashëm, çdokush që kundërshton terrorizmin në mënyrë të sinqertë do të duhej të tregonte ndjeshmëri të njëjtë për mijëra viktima të pafajshme që ai ka vvarë – jo vetëm në Qendrën Botërore të Tregtisë, por edhe në sulmet në Japoni dhe Spanjë, në Turkestanin Lindor dhe Indonezi, në masakrën e më shumë se gjysmë milion pjesëtarësh të fisit Hutu në Ruanda, në vrasjen e popullsisë së pambrojtur në Palestinë, Izrael dhe në mbarë globin.

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

Kur të dënohet me forcë çdo formë e terrorizmit, atëherë kryesit e krimeve më s'do të kenë mbështetje nga asnjë vend apo të lejohen të kërkojnë strehim brenda kufijve të tij. Thënë fjalë për fjalë, terroristët s'do të kenë ku të fshihen.

BAZA IDEOLOGJIKE E TERRORIZMIT

Para se lufta kundër terrorizmit të mund të vij deri në një mbarim definitiv, pikë së pari duhet të identifikohet filozofia që përbën bazën e tij, bashkë me mjetet që duhet të përdoren. Prandaj, ky libër merret me pikënisjen themelore të terrorizmit, si edhe me fatkeqësitë në të cilat shpie ai. Pikënisja e tij është supozimi se dhuna është një virtyt në vetvete dhe një mjet i fuqishëm për të zgjidhur problemet sociale dhe politike. Ndërsa vrasja e të pafajshmëve, prishja e rendit publik dhe shkatërrimi i paqes, çdo akt terrorist nën ndikimin e ideve që i janë imponuar, duke ia mbushur atij mendjen për të besuar se është i përfshirë në një luftë të arsyeshme. Terrorizmi mund të shërohet vetëm kur njerëz të tillë të kuptojnë logjikën e gabueshme të çdo ideologjie që frymëzon terrorizmin dhe nxitë dhunën – dhe kur të kuptojnë që shoqërimi me të kurrë nuk mund t'i shpie askund. Derisa të zbulohen gabimet dhe kundërshtimet e atyre ideologjive, të gjitha masat e ndërmarra kundër terrorizmit mund të jenë vetëm afat-shkurta. Shpejt terrorizmi do të rishfaqet, në vende të ndryshme dhe nën rrethana të ndryshme, prapa një maske tjetër.

Ne mund t'i japim fund terrorizmit vetëm duke e shkatërruar infrastrukturën e tij ideologjike. Në kapitujt pasues, do të shihni se themeli ideologjik i terrorizmit modern në fakt shkon prapa

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

në kohë të Darwinizmi Social dhe prirjet materialiste që burojnë prej tij. Njerëzit që i ekspozohen këtij mësimi besojnë se jeta është një arenë lufte dhe se vetëm të fortit mbijetojnë. Të dobët janë të dënuar të eliminohen. Njeriu dhe, në fakt, e tërë gjithësia, janë të dyja produkte të rastësisë. Prandaj, askush nuk është përgjegjës ndaj askujt për veprimet e tij. Këto ide dhe të ngjashme me to pashmangshmërisht u mbushin njerëzve mendjen që të jetojnë një mënyrë shtazarake të jetës, ku vrazhdësia, agresiviteti dhe dhuna konsiderohen si të pranueshme apo madje edhe të drejta.

**Ti (Muhammed) merre të lehtë,
urdhëro për të mirë dhe hiq prej
të padijshmëve.
(Kuran 7:199)**

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

Kushdo që mbështetet në terrorizëm, duke menduar se dhuna është e vetmja mënyrë për të arritur qëllimet e tij, është në të vërtetë nën ndikimin e Darwinizmit Social dhe të mendimit materialist, pa marr parasysh fenë apo racën e tij, apo cilit grupin i takon ai. Grupet bashkëkohore terroriste që pohojnë të veprojnë në emër të fesë janë po ashtu nën ndikimin e Darwinizmit dhe materializmit, edhe pse ato pohojnë se kryejnë veprat e tyre terroriste në emër të fesë. Kjo për arsye se kushdo që jeton në pajtim me parimet morale të shpallura nga Zoti, është e pamundur të miratoj dhunën e çfarëdo forme qoftë ajo, dhe aq më pak të arrijë një qëllim “më të lartë” duke vrarë të tjerët. Prandaj, ata të cilët mbështeten në metoda të tilla ndjekin pikërisht të kundërtën e vlerave morale që përkrahen nga feja, duke kryer veprimet e tyre nën ndikimin e ideologjive materialiste.

Në librin *Islami dënon terrorizmin*, u bë e qartë se Islami hedh poshtë me forcë të gjitha format e terrorizmit, pa marr parasysh se ndaj kujt mund të jenë të drejtuara ato. Në dritën e vargjeve të Kuranit, u shpjegua se si parimet morale të fesë u bëjnë thirrje njerëzve për paqe, tolerancë dhe lehtësi. Po ashtu u theksua pandershmëria e atyre që dënojnë vetëm ato akte terrorizmi që janë të drejtuara kundër tyre: Një qëndrim i tillë vetëm se dobëson luftën kundër terrorizmit; dhe çdonjëri që jeton në pajtim me parimet morale të Islamit duhet ta luftoj terrorin në të gjitha format e tij. Baza e kësaj lufte intelektuale mbështetet në zbulimin e parimeve të vërteta morale të fesë.

Politikanët e sotëm, komentuesit politik dhe akademikët pajtohen se fuqia ushtarake, e vetme, nuk mjafton për ta çrrënjësor terrorizmin. Ky libër përqendrohet në mënyrën e vetme që mund

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

ta çrrënjos atë: me anë të paqes, tolerancës dhe dashurisë. Të gjitha fetë e frymëzuara nga Zoti, të cila Zoti i zbriti me anë të dërguarve të Tij janë udhërrëfyes të dobishëm. Ky libër ofron shembuj nga Kurani si edhe nga Bibla (edhe pse kjo e fundit është shtrembëruar pjesërisht) për të treguar se si secila nga fetë hyjnore ndalon përdorimin e padrejtë të dhunës. Ai po ashtu jap shembuj për të treguar se e vetmja mënyrë për të luftuar terrorizmin është të shërohen arsyet që e shkaktuan atë përmes dashurisë, dhembshurisë, mëshirës, nënshtrimit, faljes, tolerancës dhe parimeve të drejtësisë që morali fetar rrënjosh në njerëz – të cilët, pasojnë ajetin Kuranor (10:25): **“Allahu thërret për në Xhenet (Banesën e Paqes)...”** Ata fatlumë do të bëjnë gjithçka munden për të ndërtuar një botë përplot paqe dhe dashuri.





**Nga ju le të jetë grup që thërret
në atë që është e dobishme,
urdhëron për punë të mbara dhe
ndalon nga e keqja. Të tillët
janë ata të shpëtuarit.
(Kuran, 3:104)**



**TAKSA E
PËRGJAKSHME
E TERRORIT**

Terrorizmi është njëri prej kërcënimeve më të rënda me të cilin përballet bota e shekullit tonë të 21-të sepse aktet e dhunës i sheh si mënyrën e vetme për t'i arritur qëllimet politike. Qëllimi apo problemi varet në veçanti nga botëkuptimi individual terrorist. Në sytë e një terroristi, dilemat dhe konfliktet politike të shkaktuara nga dallimet etnike dhe kulturore mund të zgjidhen vetëm me anë të dhunës. Asnjë grupim nuk mund të marr atë që dëshiron, përveç se me anë të "gjakut dhe hekurit".

Terroristi beson se qëllimet e tij – imponimi i kërkesave të tij, përhapja e propagandës së organizatës së tij – mund të arrihet vetëm me dëmtimin e përbërjes së shoqërisë; kur ankthi, frika dhe konflikti të dominojnë jetën e përditshme. Disa grupime kanë për qëllim të përfitojnë nga atmosfera e rrëmujës që shkaktojnë veprimet e tyre. Ata mendojnë se do të jetë më lehtë të arrijnë qëllimet e tyre aty ku stabiliteti shoqëror është rrënuar, e individët janë të tendosur nga frika dhe pasiguria. Ata pretendojnë se nga ky shkatërrimi do të lind ajo që ata quajnë "ndershmëri dhe drejtësi." Por të shpresosh që aktet e terrorizmit mund të vendosin ndershmëri dhe drejtësi ose që problemet mund të zgjidhen me anë të dhunës, është një gabim i tmerrshëm. Dhuna është kundër produktive: Të gjithë ata që jetojnë me shpatë do të vdesin nga shpata.

Në Kuran (13:25), Zoti i përshkruan të tillët si "**ata (të cilët) bëjnë shkatërrime në tokë.**" Deri më tani ata kanë arritur vetëm

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

të rrisin numrin e të vdekurve nga mesi i të pafajshmëve – si edhe nga mesi i vet përkrasësve të tyre. Çdo vit, sulmet terroriste bëjnë që me mijëra njerëz të jetojnë në frikë dhe ankth dhe të vuajnë dëme ekonomike, e të mos i përmendim ata të cilët plagosen apo vriten. Terrorizmi kërcënon tërë njerëzimin, taksa e tij është aq e tmerrshme sa që luftimi i tij është bërë urgjentisht i nevojshëm.

TERRORIZMI ËSHTË FARE PRANË SHTËPISË!

Vlerësohet se ekzistojnë rreth 500 grupe terroriste në botë. Këtu përfshihen kartelët ndërkombëtar që kontrollojnë tregtinë me drogë, armë dhe prostitucion, si edhe organizatat e fshehta, lëvizjet e vogla, grupe të ndryshme radikale ideologjike dhe kulte të devijuara që ndërmarrin aksione gjoja në emër të fesë. Shumë organizata terroriste veprojnë brenda kufijve të vendeve të tyre, por një numër i tyre sulmojnë ato vende që i kanë identifikuar si vende “armike”, përmes sulmeve në vendet dhe individët e mirënjohur që, llogarisin, se do të nxitin reagim të madh të publikut. Nga ky reagim, ata përpiqen të arrijnë famë, në fakt famë për të keq, e cila shpresojnë se do ta rritë fuqinë e tyre.

Edhe pse terrorizmi ka ekzistuar që nga kohërat më të hershme, përmes organizatave të fshehta sikurse Sikari apo Vrasësit dhe lulëzuan në kohërat moderne përmes kuadrove revolucionare sikurse “sans-cullotes” të Revolucionit Francez apo Nihilizmi Rus i shekullit 19-të, kërcënimi i tij i vërtetë arriti kulmin në shekullin e 20-të, që pa një shpërthim të akteve të terrorit dhe të numrit të terroristëve që i kryen ato. Armët për

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

shkatërrim në masë dhe përparimi i shpejtë i teknologjisë i bëri sulmet terroriste shumë më të lehta dhe rriti shumë aftësinë e tyre shkatërruese.

Gjatë viteve të 1960-ta njerëzit filluan të mendojnë seriozisht se ç'do të mund të ndodhte po qe se një grup terrorist do të arrinte të siguronte ndonjë lloj të armës bërthamore që do të mund të rezultonte me vdekjen e dhjetëra mijëra njerëzve. Një sulm biologjik apo kimik do të mund të zhdukte popullsi të tëra nga faqja e dheut. Fatmirësisht, nuk ndodhi asnjë sulm i tillë. Mirëpo, gjasat për sulme të këtilla u rritën gjatë viteve të 1990-ta. Këto shqetësime vetëm sa u shtuan me rrëzimin e Bashkimit Sovjetik dhe dobësimin e kontrollit mbi arsenalin e tij bërthamor. Shtrirja e Internetit dhe lehtësimi për marrjen e çdo forme të informacionit shtuan shqetësimet edhe më tepër. ¹ Frika nga terrorizmi u bë objekt i qindra filmave dhe librave. U shkruan raporte për pasojat e mundshme; u bënë hulumtime. Tani, është



Bhagwan Shree Rajneesh, leader of a perverted cult that poisoned 750 people in Oregon, here seen with his followers..

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

tejet e qartë që terroristët do të mund të shkonin përtej veprimeve të njohura dhe të kufizuara sikurse vënia e bombave, plaçkitjet e armatosura, marrjet dhe kidnapimet e aeroplanëve, për të sulmuar komunitete të tëra. Sulme të tilla do të mund të bëheshin me anë të tele-dirigjuesve apo kompjuterit, pa kurrfarë ndërhyrje të drejtpërdrejtë njerëzore.

Frika që u shfaq në ShBA së voni lidhur me armët biologjike sikurse bakteria e antraksit zbuloi shkallën e kërcënimit që paraqet bio-terrorizmi dhe armët biologjike. Me ndihmën e një kimisti me përvojë në një laborator të thjeshtë, terroristët tani mund të kërcënojnë jetët e mijëra njerëzve. Njëri prej shembujve të parë për këtë ndodhi në vitin 1984, kur 750 njerëz u helmuan në katër restorante në një qytet të vogël në Oregon.² Më vonë, u zbulua se një kult i Kohës së Re i frymëzuar nga religjioni Hindu nën udhëheqjen e Baghuan Shree Rajneesh ishte përgjegjës për këtë. Nxënësit kishin rritur bakterie të salmonelës në fermat e tyre dhe i kishin vendosur në baret për sallata në restorantet e zonës. Në vitin 1995, kulti Aum Shinrikyo ("E vërteta më e lartë") liroi gazin helmues sarin në sistemin hekurudhor nëntokësor të Tokios, që çoi në vdekjen e 12 njerëzve dhe lëndimin e 5,500 të tjerëve. Hetimet e pastajme zbuluan se ky kult ishte përpjekur të ndërtoj armë biologjike në laboratorët e vet – duke zbuluar kështu se çfarë rreziku të madh paraqet terrorizmi për publikun.³

Në shekullin e 21-të, teknologjia kompjuterike pritet të luaj një rol të rëndësishëm për sulmet terroriste. Ndërkohë, mënyra më "konvencionale" e terrorizmit, si vënia e bombave, zjarrvëniet e qëllimshme, marrjet dhe kidnapimet e aeroplanëve ende po ndodhin në mbarë botën, nga Evropa në Amerikë, nga Azia në

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)



The Oregon attack was an important sign of the threat posed by terrorist groups who possess biological weapons.

Afrikë. Që nga viti 1962, për shembull, pjesëtarët e organizatës terroriste të ETA-s (Euskadi Ta Askatasuna), që luftojnë për pavarësinë e regjionit Bask, kanë kryer shumë sulme terroriste në Spanjë, që rezultuan me vdekjen e më shumë se 800 njerëzve. ⁴ Me vite të tëra, Armata Republikane Irlandeze ka pushtuar titujt kryesor botëror me sulmet e saj të përgjakshme për të fituar pavarësinë për Irlandën Veriore. Qëllimi qendror i IRA-s është t'i jap fund kontrollit Britanik mbi Irlandën Veriore dhe të arrij ribashkimin e ishullit të Irlandës. Përgjithësisht ajo ka vepruar në Irlandën Veriore dhe në Londër, por gjithashtu ka qenë e përfshirë në vendosjen e bombave në vende të ndryshme evropiane si Gjermania. Që nga viti 1969, sulmet terroriste të IRA-s dhe metodat Britanike "kundër-terroriste", kanë shkaktuar vdekjen e më shumë se 3,200 njerëzve në të dyja anët e konfliktit. ⁵ Bombat e vendosura nga IRA në aeroporte dhe stacione të metrosë, prapë të drejtuara ndaj



Aum Shinrikyo



HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

civilëve, kanë shkaktuar dëm në vlerë prej miliona dollarësh. Gjatë një takimi futbolla të Kampionatit Evropian të Futbollit më 15 Qershor 1996, shpërthimi i një veture bombë të IRA-s në qendrën tregtare të Mançesterit rezultoi me rreth 200 të lënduar.

Tani, asnjë vend s'mund të ndihet i sigurt nga ky lloj kërcënimi. Këta pak shembuj që sapo i përmendëm tregojnë se sa shumë ka arritur terrorizmi të ndikojë në jetët e njerëzve. Nuk është më problem i vetëm disa kombeve veçanta, është një kërcënim me të cilin përballet tërë njerëzimi. Pasi që askush s'mund të thotë kur, ku dhe si do të sulmojnë terroristët, lufta kundër tyre më nuk mund të konsiderohet detyrë e vetëm një numri të vogël të vendeve apo organizatave. Terrorizmi, që kërcënon mbarë botën, mund të zgjidhet nëse njerëzit qëllimshëm mbështesin njëri tjetrin në kërkim të paqes, miqësisë dhe vëllazërisë.

FYTYRA E ERRËT E TERRORIZMIT

Aktualisht terrorizmi po shkakton vuajtje dhe humbje materiale në mbarë botën, jo vetëm në Shtetet e Bashkuara, por në shtetet Afrikane të Ugandës, Angolës dhe Nigerisë; në kombet Evropiane të Britanisë së Madhe, Francës dhe Spanjës; në shtetet Aziatike si Japonia dhe kudo në Lindjen e Mesme dhe Amerikën Latine. Civilët mund të përballen me një sulm terrorist në çdo moment, qoftë duke ndenjur në shtëpi apo në sallën e një kinemaje, në një qendër tregtare, në autobus apo në vendin e

For years, the militants of the ETA and the IRA murdered many civilians and caused great physical damage in Spain and the UK.



VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

tyre të punës. Është e natyrshme se aftësia e terrorizmit për të hyrë në shtëpitë e njerëzve ka shkaktuar ankth dhe alarm të konsiderueshëm. Njerëzit ngurrojnë të hyjnë në vende ku ka shumë njerëz apo të përdorin transportin publik; jetët e tyre të përditshme po bëhen të padurueshme. Por kjo është pikërisht ajo që terrorizmi dëshiron të ndodhë: komunitete të tëra që jetojnë në frikë dhe të alarmuara.

Dëshmia e sulmeve të tmerrshme kudo në botë padyshim se vërteton këtë shqetësim. Në vitin 1996, ndodhën 296 incidente me 314 njerëz të vvarë dhe 2,912 të lënduar. Në vitin 1997, fushëveprimi i terrorizmit filloi të zgjerohej: Prej 439 sulmeve, 398 kishin për cak vendet e punës apo hapësirat jozyrtare, që rezultoi me humbjen e 139 jetëve të civilëve, 39 prej të cilëve ishin shërbyes civil apo personel ushtarak. ⁶

Sipas Departamentit të Shtetit të ShBA-ve, numri i sulmeve terroriste në vitin 2000 përjetoi një ngritje prej tetëmbëdhjetë për qind në krahasim me vitin 1999, me 423 njerëz të vdekur dhe 791 të lënduar. Në mes të viteve 1981 dhe 2000, numri i përgjithshëm i të vdekurve si pasojë e sulmeve terroriste ishte 9,184.⁷ Këto shifra nuk përfshijnë të gjithë ata që vdiqën në të gjitha sulmet terroriste në mbarë botën. Raporti mori parasysh vetëm sulmet e bëra nga organizatat ndërkombëtare terroriste, jo ato të shkaktuara nga grupet lokale terroriste. Vetëm në Turqi kishte 21,866 sulme terroriste në mes të 15 Gushtit 1984 dhe 31 Tetorit 2001, që kushtuan me jetën e 5,605 zyrtarëve të sigurimit dhe 4,646 civilëve. 16,562 pjesëtarë tjerë të forcave të sigurimit dhe 5,091 civil u lënduan. ⁸

Humbja materiale dhe dëmi ekonomik i shkaktuar prej



Graphs prepared by the U.S. State Department. The top one shows the regional distribution of terrorist incidents between 1995 and 2000. The bottom graph gives the chronological distribution of such incidents from 1981 through 2000.

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT



On August 10, 2001, more than 250 died in an attack on a train by UNITA guerrillas fighting for Angolan independence.

aksioneve terroriste i shtojnë kësaj pamjeje edhe një tjetër dimension kthjellues. Rrëmuja dhe anarkia e nxitur nga incidente të tilla ndalon investimin në rajonet e prekura. Sulmet që kanë në shënjestër infrastrukturën ekonomike nuk zbrapsin vetëm zhvillimin. Burimet ekzistuese shkatërrohen po ashtu, duke krijuar vështirësi ekonomike që pengojnë jetën shoqërore përgjatë një sfere të gjerë të fushave, në veçanti edukimin. Shpenzimet ushtarake të luftës kundër terrorizmit imponojnë edhe një barrë tjetër. Ky devijim i burimeve që do të duhej të shpenzohet në ngritjen e standardit të jetesës prek jo vetëm popullin në fjalë, por tërë ekonominë globale.

Kjo përmbledhje zbulon tablonë e zymtë që paraqet terrorizmi – që sjell shkatërrim në mbarë botën dhe që shkakton humbje të pallogaritshme të jetëve njerëzore.



On August 30, 1996, 300 people died when a bomb exploded on a train in the Assam region of India. The attack is believed to have been carried out by separatist Bodo guerrillas.



As a result of bomb explosions at the U.S. embassies in Kenya and Tanzania on August 7, 1998, 224 people were killed and hundreds were injured.



On October 21, 1999, a rocket attack on a crowded shopping center in the Chechen capital of Grozny resulted in 110 deaths and 400 injuries.



THE BLOODY TERROR OF THE SHINING PATH

This Marxist-Leninist-Maoist guerrilla group operates in Peru. Founded in the 1960s by Abimael Guzman, a professor of philosophy, the organization was originally regarded as just another political movement. In the 1970s, however, the Shining Path turned into a savage guerrilla group that is now one of the bloodiest terrorist organizations in the world.

Guzman's statements in support of violence are particularly striking. In an April 19, 1980 address, the Shining Path's leader declared, "The future lies in guns and cannons."⁹ One of his guerrilla followers praised the use of violence: "Blood makes us stronger ... and if it is flowing, it is not harming us, but giving us strength." The organization openly stated that its struggle was built on the use of violence and debated how this could be increased in Peru. As a result, some 30,000 Peruvians were killed in the conflict.

The 1980s saw the end of Guzman's teaching career and the beginning of ongoing terrorism all over Peru. Like the Japanese kamikazes during World War II, Guzman and the Shining Path romanticized death. They believed it was a small price to pay for the rewards awaiting them beyond what Guzman called the "river of blood." Many innocent civilians were abducted, raped, tortured and killed; over one percent of the population died brutal deaths related to political violence. To further their cause, Guzman--then commonly known as "President Gonzalo"--and his Shining Path sought out and killed people of especially

modest means, including teachers, mayors and civic leaders.¹⁰

For years, the Shining Path inflicted physical and psychological damage, forcing the Peruvian public to live in fear. That is a natural consequence of terrorism and, as will be emphasized throughout this book, love is the only way of defeating its root causes. Such a love for humanity will overcome the blind hatred and political necrophilia that terrorism is fed from.



On October 21, 1999, a rocket attack on a crowded shopping center in the Chechen capital of Grozny resulted in 110 deaths and 400 injuries.



**IDEOLOGJITË
ATEISTE DHE
NGRITJA E
TERRORIZMIT**



ë një person i sëmurë të mjekohet si duhet, është jetike një diagnozë e saktë. Çfarëdo mjekimi që pason atë diagnozë duhet të zbatohet me përpikëri dhe vendosmëri, derisa sëmurja të largohet përfundimisht nga trupi. Në të kundërtën, sëmundja do të përsëritet në mënyrë të pashmangshme. E njëjta gjë vlen për njëren prej sëmundjeve më serioze që prek shoqërinë. Njëra prej arsyeve kryesore pse nuk mund të gjejmë zgjidhje efikase për problemet shoqërore të këtij shekulli është sepse shkaktarët e tyre nuk janë identifikuar në mënyrë të duhur. Kur merremi me ndonjë problem shoqëror, gjëja e parë që duhet të bëjmë është të përcaktojmë se cilët janë shkaktarët që e nxitin atë. Përndryshe, çfarëdo hapa që të ndërmerren mund të jenë vetëm të përkohshëm.

Rrënjët e terrorizmit shpeshherë kërkohen në gjëra konkrete; dhe kështu lufta kundër tij, që janë të drejtuara ndaj këtyre caqeve sipërfaqësore, nuk mund të jap rezultate të qëndrueshme. Për ta çliruar botën nga terrorizmi, faktorët parësor që qëndrojnë pas tij duhet të identifikohen dhe të asgjësohen.

RRJETA E KOKLAVITUR E LOGJIKËS SË TERRORISTËVE

Nuk është e mundshme që terrorizmi të mposhtet me anë të masave të sigurisë. Vetvetiu, forca ushtarake nuk ka mundësi të përballet me dhunën në rritje, duke krijuar një qark të lig në

VETËM DASHURIA MUND T'Ë SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

të cilin gjakderdhjes vazhdohet t'i përgjigjet me më shumë gjakderdhje. Kur të filloj lufta kundër terroristëve, duhet ta kuptojmë – dhe pastaj ta luftojmë – mënyrën e të menduarit të tyre, mënyrën se si e shohin ata jetën dhe qeniet tjera njerëzore dhe si e arsyetojnë ata përdorimin e dhunës nga ana e tyre.

Një terrorist beson se mund të arrij sukses vetëm me anë të përdorimit të dhunës. Ai ka dëshirë që njerëzit përreth t'ia kenë frikën atij dhe e mbulon veten me mizori, vrazhdësi dhe agresivitet për ta ngjallur atë frikë. Kushdo që i kundërshton idetë e tij është

Terrorists believe they can achieve their aims only by violence. Through violence they spread fear in society, which they hope to add to their power.





një armik, të cilin ai e konsideron si objekt që duhet asgjësuar. Në artikullin e tij, "Terroristët na konsiderojnë ne si Caqe, jo si Njerëz", psikoterapeuti dhe autori i revistës *Journal Sentinel* analizon mënyrën e të menduarit të terroristit dhe mënyrën se si ata arsyetojnë sulmet e dhunshme që janë të drejtuara ndaj njerëzve të pambrojtur:

"Hulumtuesit i kanë hedhur një vështrim aspekteve të psikes së [terroristëve]. Ajo që më së shumti u ka rënë atyre në sy është aftësia e tyre për t'i konsideruar viktimat e tyre si gjëra, si objekte, si statistikë që, ata shpresojnë, do të shfaqet në një listë të vdekurish."

*"Ata nuk duan t'i përjetojnë viktimat e tyre si qenie njerëzore, ashtu si do ta konsideronin një shok apo të dashur të tyre. Ata përpiqen që t'i shohin ata më tepër si figura në një tabelë politike të shahut. Si pasojë e kësaj, nga këndvështrimi i tyre, terroristët nuk e shohin veten si 'vrasës.' Për të vrarë me lehtësi dhe indiferencë të pashpirt, ata na çnjerëzojnë në 'caqe' në mendjet e tyre" ... 'Kauza e tyre, çfarëdo qoftë ajo, është mjaft e shenjtë, fisnike apo e pashpresë sa që arsyeton masakrën që ata shkaktojnë... Për shumicën e terroristëve, interesi kryesor i tyre qëndron në rezultate, jo në individë ... Atyre ju intereson ... efekti i masakrës, jo vet përjetimi i masakrës. Terroristët duan ta vrasin shpresën, apo një mënyrë jete, apo shpirtin e një grupi njerëzish apo të një kombi të tërë. Ata asgjësojnë qeniet njerëzore sepse besojnë se të veprosh kështu është rruga më e shpejtë dhe më e drejtë për ta arritur atë qëllim."*¹¹

Filip Çard tërheq vëmendjen ndaj një çështje më se të rëndësishme: se terroristët nuk ndjejnë as brejtjen më të vogël të

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT


ndërgjegjes për vdekjen e të tjerëve. Përkundrazi, sa më shumë njerëz që vrasin, aq më të suksesshëm e konsiderojnë veten dhe i gëzohen këtij fakti. Mendje të tilla fare lehtë mund të vrasin njerëz të pafajshëm dhe të hedhin bomba në



fëmijë të vegjël. Për ta, gjakderdhja shndërrohet në burim kënaqësie. Ata pushojnë së qeni njerëz dhe shëndrrohen në përbindështa të egër. Nëse njëri prej tyre shfaq keqardhjen më të vogël, ai menjëherë damkoset si tradhtar nga shokët e tij më radikal. Të qenit më radikal dhe më i përgjakshëm konsiderohet si devotshmëri më e madhe ndaj kauzës, kështu që zelli për të vvarë rritet vazhdimisht. Pasi që çdo debat mund të përkufizohet si tradhti, terroristët pa dallim përdorin armët kundër njëri tjetrit dhe kryejnë sulme ndaj grupeve të përçara brenda radhëve të tyre.

Kjo lidhje e zjarrtë me dhunën shkon përtej ideologjive politike dhe në të vërtetë buron nga një ide e gabuar për natyrën njerëzore. Mënyra e të menduarit terrorist është e frymëzuar nga filozofia materialiste dhe mendimi Darwinist. Darwinizmi i konsideron qeniet njerëzore si shtazë dhe pohon se gjallesat evoluojnë përmes një lufte për mbijetesë në natyrë. Eliminimi i të dobëtëve, në mënyrë që të fuqishmit të dalin fitimtar, formon thelbin e çdo mendimi të shtrembëruar terrorist.

The savagery of terrorism is felt in almost every country in the world. According to U.S. State Department figures, the year 2000 saw an 8 percent increase in terrorist incidents over 1999.



MËNYRA E TË MENDUARIT TERRORIST U FORMUA NGA DARVINIZMI

Sipas teorisë së evolucionit të Çarlls Darvinit, ekziston një luftë e vazhdueshme në natyrë dhe një garë e pamëshirshme për mbijetesë. Të fuqishmit gjithmonë i mundin të dobëtit, duke mundësuar kështu përparimin. Nga ky koncept erdh ideja e “luftës për mbijetesë” dhe terme të tilla si “racat e favorizuara” (të bardhët Evropian) dhe ato “inferiore” (racat Aziatike apo Afrikane). Kjo logjikë raciste vendosi bazën e urrejtjes dhe konflikteve në mbarë botën. Pastaj, ideja e Darvinit e “mbijetesës së më të aftëve” arsyetoi një numër shumë të madh të lëvizjeve që çuan njerëzimin në urrejtje, armiqësi, konflikt dhe luftë.


Darvinizmi akoma indoktrinon njerëzit me mashtrimin se njerëzit nuk janë asgjë më shumë veçse një specie tejet e zhvilluar e kafshës, rezultat i rastësisë së verbër dhe që nuk ka Krijues. Kjo teori pohon se bota një kohë nuk përmbante asgjë tjetër përveç gurëve, dheut dhe gazrave të pajetë. Jeta u shfaq përmes një rastësie të plotë si rezultat i ndikimit të forcave natyrore si era dhe shiu dhe vetëtimia në molekulat organike. Teoria vazhdon të shpjegoj gjithë jetën në tokë, duke përfshirë qeniet njerëzore, si produkt i forcave të verbra të natyrës dhe rastësisë së thjeshtë. Mirëpo kjo teori e evolucionit është një mashtrim shumë i madh që dhunon ligjet më themelore të kimisë dhe biologjisë dhe kundërshton haptas gjithë arsyen dhe logjikën. (Për më shumë informacion lidhur me këtë temë, shih Kapitullin 7, Mashtrimi i Evolucionit). Mirëpo, kjo teori i imponohet shoqërisë moderne me

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

një propagandë të jashtëzakonshme dhe njerëzit e indoktrinuar me këtë ide besojnë se janë produkte të rastësive kimike dhe biologjike – pa kurrfarë përgjegjësie ndaj Krijuesit dhe kodit të Tij moral. Veç kësaj, ata që janë të magjepsur nga logjika Darwiniste – që e shohin jetën si një fushëbetejë dhe që për këtë arsye e arsyetojnë çdo lloj ligësie në luftën për mbijetesë – u është shpërlarë truri me idenë e tmerrshme se është normale që njerëzit tjerë të trajtohen si kafshë, madje edhe të asgjësohen.

Njerëzit e edukuar me ide të tilla e shëndrruan shekullin e 20-të në një shekull egërsish, përkrahën konfliktin si pjesë të Darwinizmit dhe madje e konsideruan luftën si mjetin më të rëndësishëm për shtyrjen përpara të qëllimeve të tyre. “Konflikti dialektik” u shëndrrua në të ashtuquajturin arsyetim për masakrat e kryera nga ideologët komunist. Gjatë këtij shekulli, terrori komunist kushtoi me jetën e rreth 120 milion njerëzve. “Lufta absurde e Darvinit për mbijetesë në mes të racave” dhe “seleksionimi natyror” u bënë baza e Nazizmit. Adolf Hitleri pohonte se vetëm racat superiore mund – apo duhet – të mbijetojnë. Terrori fashist që shkaktoi ai nxiti një valë të masakrës në mbarë botën. Rreth 55 milion njerëz vdiqën në Luftën e Dytë Botërore, e cila filloi si rezultat i politikave të luftës dhe okupimit të Nazistëve. Ata njerëz në shekullin 21 të cilët u qëndrojnë ende besnik atyre ideve, e konsiderojnë dhunën si rrugën e vetme dhe duan që ky shekull të shënohet në histori si shekull i terrorit.

Teoria e Darwinizmit se njeriu është një kafshë luftarake, me të cilën aq shumë njerëz janë të indoktrinuar në mënyrë të nënvetëdijshme, i ka shkaktuar dëm të tmerrshëm njerëzimit. Sulmet terroriste janë jehona të saj. Sloganet Darwiniste që pohojnë



HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

se vetëm më të fuqishmit mund të mbijetojnë, që lëvdojnë dhunën, mbështesin konfliktin dhe luftën e konsiderojnë virtutet duhet të hidhen, njëherë e përgjithmonë, në shportën e historisë. Përmbysja e Darwinizmit mund t'i minoj të gjitha ato ideologji që mbështesin konfliktin dhe dhunën.

Në anën tjetër, definimi i natyrës njerëzore nga ana e besimeve monoteiste dallon shumë. Krishterimi, Judaizmi dhe Islami – të tri fetetë të cilave u besojnë shumica e njerëzve në botë– të gjitha e kundërshtojnë vlerën Social Darwiniste të quajtur konflikt. Siç do të shohim më në hollësi në pjesët në vazhdim, secila prej këtyre feve ka për qëllim të sjell paqe dhe siguri në botë, ndërsa e kundërshtojnë tiraninë, torturën dhe vrasjen e të pafajshmëve. Ato pajtohen se konflikti dhe dhuna janë koncepte jonormale dhe të padëshiruara, që i përdhunojnë parimet morale që Zoti ka përcaktuar për Njeriun. Darwinizmi, në anën tjetër, e konsideron dhunën dhe konfliktin si thelbësore dhe prandaj të arsyeshme. Thënë shkurt, burimi i ankthit të terrorist në botë qëndron në ateizëm dhe në ekuivalentët bashkëkohor të tij: Darwinizmin dhe materializmin.

Pasi që shkollat në shumë vende e mësojnë Darwinizmin si fakt të qartë shkencor, gjenerata të reja të terroristëve janë të pashmangshme. Nga ai këndvështrim, është e ngutshme që të ndalohet që të rinjtë të mësohen në shkolla se janë rezultat i rastësisë, që kanë prejardhje prej kafshëve, plotësisht të lirë dhe pa kurrfarë obligimesh ndaj Zotit dhe se mund të mbijetojnë vetëm duke dalë fitimtar në luftën për mbijetesë. Çdo njeri i edukuar të besoj në koncepte të tilla do të jetë në mënyrë të pashmangshme vetjak, agresiv, i pamëshirë dhe i prirur ndaj



HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

dhunës. Këta të rinj lehtë bëhen pre e indoktrinimit anarkik dhe terrorist. Duke i pasuar ideologjitë e tilla, ata mund të bëhen aq mizor sa të vrasin fëmijët dhe të vrasin vëllezërit dhe motrat e tyre pa rrahur qerpik. Grupet terroriste komuniste, raciste dhe fashiste që kanë pllakosur botën për njëqind vitet e fundit janë produkte pikërisht të një sistemi të tillë të edukimit.

Duke qenë kështu, duhet ta demaskojmë kalbësinë e vërtetë të logjikës terroriste. Njerëzit duhet të vetëdijesohen për këtë fakt, sa më mirë që të jetë e mundshme, se gjithë ata që e mbështesin dhe që besojnë në Darwinizëm gabohen. Njeriu nuk është i lirë të veproj sipas dëshirës së vet dhe nuk është pa përgjegjësi. Kemi Krijuesin i Cili na vëzhgon në çdo kohë, i Cili i din madje edhe mendimet tona më intime dhe i Cili, në jetën e përtejme (në ahiret), do të kërkojë prej nesh që të japim llogari për të gjitha veprat tona. Zoti ynë e ka krijuar Njeriun të ndryshëm prej kafshëve, sepse ne posedojmë shpirt, arsye, vullnet të lirë, gjykim dhe aftësi për të bërë dallim. Nëse një person me vullnet të dobët, që zemërohet lehtë, e konsideron veten dhe të tjerët thjeshtë si kafshë, ai mund të sillet pa kurrfarë mëshire dhe tu shkaktoj dëm atyre me lehtësi. Nuk paraqet kurrfarë dallimi nëse ata janë fëmijë plotësisht të pafajshëm. Por kushdo që posedon arsye dhe vetëdije dhe e din se në vetvete ka shpirt, të cilin Zoti ia ka dhuruar, e përmban zemërimin e tij – pa marr parasysh pasojat. Gjykimi dhe vetëdija e tij do të mbisundojë gjithmonë. Ai s’do të bëj kurrë as gjënë më të vogël për të cilën Zoti një ditë do të kërkojë të jap llogari.

Modern schools teach Darwinism as if it were a scientific fact. This dissemination of Darwinist philosophy helps the rise of social violence, including terrorism. Indoctrinated with the idea that conflict and struggle are a part of life, young people slowly begin to regard violence as perfectly normal and even take pleasure in it.

VETËM DASHURIA MUND T'Ë SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

Në Kuran (01: 7-10), Zoti shpall se Njeriu është i frymëzuar me të dya të keqen dhe vullnetin për ta shmangur atë. Prandaj, nuk qëndron ndonjë proces i imagjinuar evolutiv në themel të degjenerimit moral dhe të kryerjes së krimeve. Amoraliteti dhe krimi burojnë prej anës së ligë të natyrës njerëzore, e cila mund të mposhtet vetëm me anë të devotshmërisë personale ndaj vlerave morale të cilat Zoti ia ka mësuar njerëzimit përmes fesë. Nëse njerëzit nuk besojnë në Zotin dhe nuk besojnë që kurdoherë duhet t'i japin Atij llogari për veprimet e tyre, ata nuk kanë arsye të shmangin kryerjen e veprave të liga në formë të lakmisë personale dhe veprimeve të pandershme apo të këqijave shoqërore si luftërat, vrasjet në baza raciste, luftërat e bandave kriminale apo sulmet e pamëshirë të kokërruarve. Në nivel më pak dramatik, kjo shpjegon arsyen pse njerëzit lihen të vdesin nga uria dhe moskeqardhjen dhe padrejtësinë e shfrenuar sot në botë. Mizoritë e atyre të cilët e konsiderojnë Njeriun vetëm si një specie kafshësh, që besojnë se ata, sikurse kafshët, janë të përfshirë në një luftë për mbijetesë nuk kanë mbarim. Duke mos besuar në Zotin dhe në jetën e përtejme, ata i nxisin edhe të tjerët që po ashtu t'i harrojnë ato.

Çdo qenie njerëzore bart në vete një shpirt të frymëzuar në të nga Zoti dhe është përgjegjëse ndaj Krijuesit i Cili e krijoi atë nga asgjëja. Në Kuran (75: 36-40), Zoti i përkujton ata të cilët mendojnë për vetveten si krejtësisht të lirë të veprojnë si të duan se ata u krijuan dhe do të ringjallen pas vdekjes: **“A mos mendon njeriu se do të lihet duke mos zënë asgjë (pa kurrfarë përgjegjësie). A nuk ka qenë ai një pikë ujë që derdhet, e pastaj u bë gjak i trashë, që Ai e krijoi dhe e përsosi? Dhe prej tij Ai i bëri dy lloje:**

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

mashkullin dhe femrën. A nuk është Ai (Zot) i fuqishëm që t'i ngjall të vdekurit?"

Deri më tani, ne jemi përqendruar në mënyrën se si Social Darwinizmi, duke besuar se dhuna është zgjidhje për çdo problem, nxitë dhunën dhe është baza e terrorizmit. Për këtë arsye rrëzimi i teorisë Darwiniste – e cila mëson se njeriu është kafshë, se vetëm ata që janë fizikisht të fuqishëm mund të mbijetojnë dhe se jeta njerëzore është një fushëbetejë – do të rrëzojë po ashtu një rreth prej shtyllave të terrorizmit. Mënyra më efikase për të mbrojtur njerëzit nga ankthi i terrorizmit është edukimi shpirtëror. Shoqëritë mund të arrijnë paqe të përhershme vetëm kur individët e tyre të mësojnë të jetojnë sipas normave të duhura morale. Jashtë kësaj, masat tjera, normat dhe masat parandaluese për të rregulluar jetën e shoqërisë mund të arrijnë vetëm deri në një pikë të caktuar, por kurrë nuk mund ta çrrënjosin kamxhikun e terrorizmit.



**VETËM DASHURIA
MUND T'I
SHKAKTOJË
DISFATË
TERRORIZMIT**

Në Kuran (32: 9), Zoti shpall se Ai ia ka frymëzuar vet shpirtin e Tij Njeriut, Krijimit të Tij dhe se njeriu është mëkëmbësi i Tij në tokë (Kuran, 6: 165). Një prej dallimeve më të rëndësishme midis Njeriut dhe kafshëve është se Njeriu u krijua si me dëshira tokësore ashtu edhe me ndërgjegje. Çdo njeri posedon dëshira që e nxisin atë drejt të keqes, së bashku me një ndërgjegje që e frymëzon atë që t'i shmanget asaj. Pranë tipareve aq të këndshme të frymëzuara nga kjo ndërgjegje – dashuria, sakrifica, mëshira, përulja, dhembshuria, ndershmëria, besnikëria dhe mirësia – ai posedon po ashtu prirje shkatërruese dhe të padëshirueshme, që burojnë prej dëshirave të tij tokësore. Mirëpo, duke iu falënderuar ndërgjegjes së tij, besimtari mund të bëj dallimin midis të mirës dhe të keqes dhe të zgjedhë atë që është moralisht e drejtë. Besimi i fortë në Zotin dhe frika ndaj Zotit, besimi në ahiret, frika e fuqishme për vuajtjet e pafund të Xhehenemit (Ferrit) dhe një dëshirë e zjarrtë për Xhenetin (Parajsën) të gjitha i përmbajnë të ankoruara joshjet e dëshirave tokësore të tij. Prandaj, ai gjithmonë sillet mirë ndaj njerëzve, është falës, të ligës i përgjigjet me mirësi, ju ndihmon atyre që kanë nevojë dhe shfaq mëshirë, dashuri, dhembshuri dhe tolerancë.

Terroristët, në anën tjetër, u nënshtrohen dëshirave tokësore të tyre për dhunë në vend të ndërgjegjeve të tyre dhe lehtë mund t'u kthehen të gjitha formave të ligësisë. Ata shëndrohen në njerëz pa dashuri, agresiv, të cilët me lehtësi u shkaktojnë dëm

VETËM DASHURIA MUND T'Ë SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

të tjerëve pa brejtjen më të vogël të ndërgjegjes. Duke mos ndier kurrfarë frike ndaj Zotit, ata nuk e njohin moralin e fesë dhe as që e praktikojnë atë. Asgjë s'mund t'i ndaloj ata që të mos kryejnë krime.

Rregullat që mbizotërojnë në shoqëri mund të arrijnë vetëm deri në përmbajtjen e qytetarëve të saj. Duke iu falënderuar njësave të tij për zbatimin e ligjit, shteti mund të jetë në gjendje që t'i mbroj rrugët dhe hapësirat publike pjesërisht, dhe – duke iu falënderuar një sistemi të fuqishëm të drejtësisë – mund të jetë në gjendje që të ndërmarr masat e nevojshme për të siguruar rendin publik dhe për të siguruar që shkalla e krimit të bie. Por pasi që është e pamundshme që të vëzhgohet secili individ, 24 orë në ditë, është e domosdoshme që ndërgjegjet e njerëzve të futen në këtë barazim në një fazë të caktuar. Dikush që nuk është i vëmendshëm ndaj zërit të ndërgjegjes së tij lehtë mund t'i kthehet krimit kur është vetëm apo kur është i rrethuar me njerëz të një mendjeje. Rezultat i kësaj është një shoqëri e individëve të cilët me kënaqësi gënjejnë kur e shohin të nevojshme, nuk ndiejnë brejtje të ndërgjegjes për përfitimet e padrejta dhe nuk ndiejnë kurrfarë shqetësimi që shtypin apo shfrytëzojnë të dobëtit. Në një shoqëri që ka humbur të gjitha vlerat shpirtërore dhe nuk ndien frikë ndaj Zotit, masat krejtësisht materiale nuk do të zgjedhin çdo problem. Morali i fesë, në anën tjetër, e urdhëron individin që t'i shmanget veprave të këqija, madje edhe kur është vetëm dhe kur është i vetëdijsëm se askush në shoqërinë në të cilën jeton s'do ta ndëshkojë kurrë për keqbërjet e tij. Individin i cili është i vetëdijsëm se Zoti do të kërkojë nga ai llogari për secilin veprim të tij, secilin vendim të tij dhe secilën fjalë të tij – dhe do ta shpërblejë në përputhje me

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

atë që ka vepruar në ahiret – gjithmonë do t'i shmanget të keqes.

Organizatat terroriste nuk mund të kenë kursesi vend në një shoqëri njerëzitet e së cilës i shmanget të keqes sipas vullnetit të lirë të tyre. Aty ku mbizotëron morali fetar, problemet që krijojnë organizatat që mbështesin përdorimin e dhunës do të zhduken në mënyrë të natyrshme. Nëse e tërë shoqëria posedon veti të larta si ndershmëria, flijimi, dashuria dhe drejtësia, nuk mund të ketë vend për gjëra të tilla si varfëria, ndarja e pabarabartë e të ardhurave, padrejtësia, shtypja e të dobëtimit, apo kufizimet e lirive. Përkundrazi, do të dal në shesh një rend shoqëror që do t'i përmbush nevojat e nevojtarëve, ku i pasuri mbron të varfrin dhe i forti të dobëtimit, ku çdo njeri mund të gëzojë përkujdesjen më të mirë shëndetësore, shkollimin dhe sistemet më të mira transportuese. Aty, toleranca dhe mirëkuptimi do të mbisundojnë raportet në mes të grupeve të ndryshme etnike, në mes të feve dhe kulturave të ndryshme.

Për këto arsye, morali i vërtetë është çelësi për të zgjidhur aq shumë probleme shoqërore. Burimi i këtij çelësi, është Kurani, të cilin Zoti e ka shpallur si udhërrëfyes për njerëzimin.

ISLAMI I MODERUAR-ME FJALË TË TJERA, ISLAMI I VËRTETË

Për gjysmë shekulli pasi që iu shpall ajeti i parë Profetit Muhammed (mëshira dhe paqja e Allahut qofshin mbi të), Islami pësoi një përhapje të tillë që është parë rrallëherë. Ai u përhap nga Gadishulli Arabik në tërë Lindjen e Mesme, Afrikën Veriore dhe madje në Spanjë, duke tërhequr vëmendjen e shumë njerëzve në Perëndim. Me fjalët e ekspertit të famshëm Islamik Gjon L. Espozito, "Ajo që mahnitë më së tepërmi lidhur me përhapjen e hershme të Islamit është shpejtësia e saj dhe suksesi. Dijetarët perëndimor janë mahnitur me këtë." ¹² Gjatë shekujve të ardhshëm, Islami u shtri në të gjitha skajet e botës, nga Indonezia në Amerikën Latine. Sot, Islami pranohet si feja që rritet më së shpejti dhe përafërsisht një miliard pasues të tij përfaqësojnë rreth një të pestën e popullatës botërore. Interesimi për Islamit është rritur në veçanti pas sulmeve terroriste të 11 Shtatorit të vitit 2001 (Për më shumë hollësi, shih *Ngritja e Islamit* nga Harun Jahja).

Duke vështruar botën Islamike sot, shohim praktika të shumëllojshme fetare, varësisht nga zakonet dhe traditat e ndryshme të shoqërive, trashëgimisë së tyre kulturore dhe botëkuptimeve të tyre. Kjo i ka shtyrë disa individë që kanë bërë hulumtime apo që janë përpjekur të kuptojnë Islamit të formojnë përshtypje të gabueshme. Ato ndryshime mund të simbolizojnë vetëm vlerat tradicionale të shoqërisë së studiuar, por jo të vet Islamit. E vetmja mënyrë që të arrihet në një mendim të saktë për Islamit është të lihen anash këto dallime dhe t'i drejtohet Kuranit, ku është paraqitur thelbi i moralit Islamik dhe veprimeve të Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin me të).

Edhe në qoftë se Myslimanët përbëjnë shumicën në një shoqëri, kjo nuk nënkupton se sjellja e asaj bashkësie, pikëpamjet dhe mendimet do të jenë domosdo Islamike, dhe as se ato duhet mbrojtur në emër të Islamit. Kur të bëhet vlerësimi i pikëpamjes për Islamin të një individi apo shoqërie, këtë duhet ta kemi parasysh gjithmonë. Dallimet mund të burojnë prej kushteve që mbizotërojnë atje. E vetmja mënyrë për të përcaktuar nëse ato pikëpamje janë të sakta është duke iu drejtuar Kuranit, burimit më të saktë të së vërtetës për Islamin, dhe veprimeve të Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).

Është shumë e padrejtë të dënohet Islami dhe Myslimanët pa studiuar Kuranin për të mësuar nëse një praktikë e veçantë shfaqet në të. Studimi i mënyrës së jetës së një shoqërie të vetme vetëm se mund të çorientoj seriozisht cilindo njeri që përpiket të kuptoj Islamin dhe të formoj opinione për të. Së pari, ajo që duhet bërë është të mësohet për Islamin nga burimi i tij i vërtetë. Pastaj, pasi që të jenë marr parasysh modelet e ndryshme në pjesë të ndryshme të botës në dritën e atyre kriterëve, shumë njerëz që vetëm kishin supozuar se kishin dijeni për Islamin do të mësojnë për të për herë të parë dhe mund të lirohen prej gabimeve viktime e të cilave kanë qenë deri atëherë.

Islami ndalon vrasjen e të pafajshmëve

Sipas Kuranit (5:32), është gjynah i madh të vritet një person i pafajshëm dhe kushdo që e bën këtë do të përjetojë vuajtje të mëdha në jetën e përtejme:

“... Kush mbyl një njeri (pa të drejtë), pa pasë mbytur ai

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si të kishte mbytur gjithë njerëzimin. E kush e ngjall (bëhet shkak që ai të jetë gjallë) është si të kishte ngjallur (shpëtuar) tërë njerëzimin. Atyre (beni israilve) u erdhën të dërguarit Tanë me argumente, mandej edhe pas këtij (vendimi) shumë prej tyre e teprojnë (kalojnë kufijtë në mbytje) në këtë tokë.”

Ky ajet barazon mbytjen e një të pafajshmi me vrasjen e tërë njerëzimit! Një ajet tjetër (25:68) shpreh rëndësinë që besimtarët ia kushtojnë jetës:

Edhe ata që pos All-llahut, nuk lusin zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto, ai gjen ndëshkimin.

Edhe në një ajet tjetër (6:151), Zoti shpall urdhrin në vazhdim: Thuaj: “Ejani t’ju lexojë atë që me të vërtetë ju ndaloi Zoti juaj: të mos i shoqëroni Atij asnjë send, të silleni mirë me prindërit, të mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë juve dhe ata, të mos u afroheni mëkateve të hapta apo të fshehta, të mos e mbytni njeriun sepse mbytjen e tij e ndaloi All-llahu, përpos kur është me vend. Këto janë porositë e Tij, kështu të mendoni thellë.

Çdo Mysliman i cili beson në Zotin me sinqeritet, i cili me përpikëri vepron në përputhje me ajetet e Tij të shenjta dhe ia ka frikën vuajtjes në ahiret, do t’i shmanget dëmtimit madje edhe të një personi tjetër. Ai është i vetëdijshëm se Zoti i Drejtësisë së pafund do ta shpërblejë atë ashtu siç e meriton për të gjitha veprat e tij. Në njërin prej haditheve, Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

qofshin mbi të) radhiti sojet e njerëzve me të cilët Allahu nuk është i kënaqur:

“Ata të cilët sillen në mënyrë të vrazhdë dhe të padrejtë në tokat e shenjta, ata të cilëve u pikon zemra për zakonet e të padijshmëve dhe ata që padrejtësisht derdhin gjakun e njeriut.”¹³

Terrorism targets the innocent, although God forbids the killing of even one innocent person.



Islami i urdhëron njerëzit të sillen në mënyrë të drejtë

Morali Islamik i urdhëron besimtarët që të sillen në mënyrë të drejtë dhe të moralshme kur sjellin një vendim, kur flasin apo punojnë – shkurt, në çdo fushë të jetës së tyre. Urdhrat e Zotit në Kuran dhe në sunnetin e Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) përshkruajnë hollësisht këtë kuptim të drejtësisë. Me paralajmërimet e tyre, të gjithë të Dërguarit që na prezantohen në Kuran sollën paqe dhe drejtësi për të gjitha shoqëritë ku ata u dërguan. Profetët ndihmuan që të hiqet mizoria dhe despotizmi nga shpatullat e shoqërisë së besimtarëve. Siç na ka shpallur Allahu në një ajet (10:47):

Secili popull kishte të dërguarin e vet, e kur u vinte i dërguari i tyre bëhej gjykimi i drejtë mes tyre. Atyre nuk u bëhet padrejtësi.

Veçoria më e rëndësishme e kuptimit Islamik të drejtësisë është se ai urdhëron drejtësinë në të gjitha kohërat, madje edhe nëse njeriu ka të bëjë me një person i cili është i dashur dhe i afërt për të. Siç urdhëron Allahu në një ajet tjetër (4:135):

O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hir të All-llahut edhe nëse është kundër vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose varfanjak, pse All-llahu di më mirë për ta. Mos ndiqni pra dëshirat tuaja e t'i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrembëroni ose tërhiqeni, All-llahu plotësisht di ç'ka punoni.

Ky ajet qartë dëshmon se për një besimtar, pasuria apo pozita

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

në shoqëri e kujtdo me kënd ka të bëj njeriu nuk ka rëndësi. Ajo që është me rëndësi është drejtësia – askush s’duhet të trajtohet padrejtësisht – dhe ajetet e shenjta të Zotit duhet të zbatohen me përpikëri. Në një ajet tjetër (5: 8), urdhërohet:

O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të All-llahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos ju shtyjë urrejtja ndaj një populli e t’i shmangeni drejtësisë. Bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Keni frikë All-llahun se All-llahu e di atë që veproni.

Në këtë ajet, Zoti urdhëron besimtarët të sillen gjithmonë me drejtësi, madje edhe me armiqtë e tyre. Asnjë Mysliman nuk mund të sjell një vendim të pamenduar, duke u bazuar në faktin se personi me të cilin ka të bëj një herë e kishte dëmtuar apo e kishte lënë në situatë të vështirë. Madje edhe kur ai është armik personal, nëse pala tjetër është me të vërtetë në faj, çdo Mysliman është i detyruar të përgjigjet me vullnet të mirë dhe të shfaq moralin që Zoti ka urdhëruar.

Besimtarëve, Zoti u ka dhënë këtë urdhër (60:8): **“All-llahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; All-llahu i do ata që mbajnë drejtësinë.”** Këtu Ai i informon Myslimanët se si duhet të jenë marrëdhëniet e tyre me njerëzit tjerë. Këto ajete janë pikërisht themeli i sjelljes së një besimtari ndaj të tjerëve, i formuar jo prej natyrës së njerëzve me të cilët ka të bëj ai, por nga shpalljet e Zotit në Kuran. Kjo është arsyeja pse Myslimanët me zemër të dëlirë gjithnjë përkrahin atë që është e drejtë. Vendosmëria e tyre në këtë çështje shpallet me këto fjale (Kuran, 7:181): **“E ndër ata që krijuam Ne, ka njerëz që udhëzojnë**

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

në të drejtën e edhe vepronë në pajtim me të.”

Ajetet tjera në Kuran mbi çështjen e drejtësisë lexojnë:


All-llahu ju urdhëron që t'u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me drejtësi mes njerëzve. Sa e mirë është kjo që ju këshillon. All-llahu dëgjon dhe sheh si veproni. (4:58)

Thuaj: “All-llahu më urdhëroi mua drejtësinë dhe në tërësi kthejuni Atij në çdo namaz (lutje) dhe adhuronit Atë duke qenë të sinqertë në lutje vetëm për të. Ashtu sikur që ju filloi (krijoi) së pari do të ktheheni te Ai. (7:29)

All-llahu urdhëron drejtësi, bamirësi dhe ndihmë të afërmve. Ai ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim. (16:90)

Në mbarë botën, njerëzit i nënshtrohen një trajtimi të vrazhdë për shkak të racës së tyre, të gjuhës apo ngjyrës së lëkurës. Megjithatë sipas pikëpamjes së drejtësisë siç është përcaktuar në Kuran, përkatësia etnike e një personi, raca apo gjinia nuk kanë rëndësi, sepse Islami pohon se të gjithë njerëzit janë të barabartë. Fjalët e Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të): “Të gjithë ju jeni pasardhës të Ademit dhe Ademi u krijua prej dheut”¹⁴ theksojnë se nuk ekziston asnjë dallim midis njerëzve. Ngjyra e lëkurës, pozita shoqërore dhe pasuria nuk i japin aspak epërsi askujt.

Racial and national differences between people are not an element of conflict, but a source of cultural wealth.



VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

Sipas Kuranit, njëra prej arsyeve pse u krijuan fise, popuj dhe kombe të ndryshme është në mënyrë që “ata të mund ta njohin njëri tjetrin.” Të gjithë janë robër të Zotit dhe duhet t'i mësojnë kulturat, gjuhët, zakonet dhe aftësitë e ndryshme të njëri tjetrit. Një qëllim që qëndron prapa ekzistencës së kombeve dhe racave të ndryshme është pasuria kulturore, jo lufta dhe konflikti. Të gjithë besimtarët e sinqertë e dinë se vetëm të besuarit – me fjalë të tjera, frika ndaj Zotit dhe besimi në Të – mund të japin epërsi. Siç ka shpallur Zoti në Kuran (49:13):

O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat) e All-llahu është i dijshtëm dhe hollësishtë i njohur për çdo gjë.

Në një ajet tjetër (30:22), Ai ka shpallur se:

Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve dhe i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Padyshim se në këtë ka argumente për çdo njeri.

Historia ofron shumë shembuj të besimtarëve që sjelljen me drejtësi të plotë ndaj njerëzve tjerë, duke e ndihmuar Islamin të zhvillohet me një shpejtësi të pabesueshme në një territor të gjerë, duke e përfshirë Afrikën Veriore, tërë Lindjen e Mesme dhe madje Gadishullin Iberik. Me anë të këtyre pushtimeve, njerëzia dhe toleranca e moralit Islamik u përhap në shumë raca, kombe, bashkësi dhe individë, duke bashkuar miliona njerëz në një lidhje të tolerancës reciproke, të paparë ndonjëherë. Hulumtuesi i njohur Joel Augustus Rogers ka studiuar shumë raca dhe raportin në mes

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

të racës së zezë dhe vendeve tjera. Në librin e tij "Gjinia dhe Raca", ai e përshkruan ndikimin e Islamit në botë me këto fjalë:

Njëra prej arsyeve pse Islami ishte i aftë të mbijetoj me kaq shkëlqim për shekuj të tërë është mungesa pothuajse e plotë në këtë religjion e ulerësimeve të bazuara në racë dhe klasë, mospërfillja e ngjyrës së lëkurës së një individi apo klasës së tij shoqërore dhe fakti se ngritja në nivelet më të larta të një shoqërie bazohet vetëm e vetëm në aftësi... Islami vendosi një përzierje më madhështore dhe në të njëjtën kohë më të lirë racore në histori dhe përzierja e këtyre racave ndodhi në trungun e perandorisë më të gjerë që bota ka parë ndonjëherë. Në kulmin e fuqisë së saj Perandoria Islame u shtri nga Spanja dhe Franca qendrore në Perëndim deri në Indi, Kinë dhe Oqeanin Paqësor në Lindje, duke përfshirë Azinë Qendrore. Sunduesit e këtyre territoreve të gjera ishin të ngjyrave të ndryshme. Ngjyra e lëkurës së njerëzve ishte madje edhe më pak e rëndësishme për Myslimanët se sa që ngjyrat e luleve në një kopsht kanë rëndësi për vet lulet.¹⁵

Profesori Hamilton Aleksandër Rosken Gib është njëri prej ekspertëve më të shquar botëror për Islam. Në librin e tij *Për ku Islami?*, ai përshkruan pikëpamjen Islamike për racat tjera:

Asnjë shoqëri tjetër nuk ka një dosje të suksesit që bashkohet në një barazi të pozitës, të mundësisë dhe të përpjekjeve të racave aq të shumta dhe të ndryshme të njerëzimit... Islami ka ende fuqi të pajtoj elemente në dukje të papajtueshme të racës dhe traditës. Nëse kundërshtimi i shoqërive të mëdha të Lindjes dhe Perëndimit do të zëvendësohet ndonjëherë me bashkëpunim, ndërmjetësimi i Islamit është një kusht i domosdoshëm.¹⁶

VETËM DASHURIA MUND T'Ë SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

Morali Islamik ka për synim një shoqëri të ndërtuar në vëllazëri dhe paqe, liri dhe siguri. Kjo është arsyeja pse të gjitha shoqëritë që bien në kontakt me Islamin janë larguar nga metodat shtypëse, mizore dhe agresive dhe, në vend të kësaj, kanë ndërtuar shoqëri paqësore dhe të qytetëruara. (Për më shumë hollësi, shih *Drejtesia dhe Toleranca në Kuran* nga Harun Jahja.)



Joel Augustus Rogers

Në veprat e tyre, shumë historian Perëndimor kanë dokumentuar ndikimet e thella dhe pozitive të Islamit në shoqëritë që ranë në kontakt me të. Në librin *Zhvillimi i Njerëzimit*, Profesori Robert Briffault bën fjalë për raportin në mes të shoqërisë Perëndimore dhe Islamit:

Idetë që frymëzuan Revolucionin Francez dhe Deklaratën e të Drejtave, që udhëhoqi hartimin e Kushtetutës Amerikane dhe ndezi atë luftë për pavarësi në vendet Latino Amerikane (dhe gjetiu) nuk ishin shpikje të Perëndimit. Ato gjetën frymëzimin dhe burimin e tyre final në Kuranin e Shenjtë.¹⁷

Këto fragmente të shkëputura tregojnë se si gjatë shekujve të kaluar, morali Islamik i ka mësuar njerëzit për paqe, tolerancë dhe drejtësi. Në ditët tona, gati çdokush është duke kërkuar një model të tillë dhe nuk ka ndonjë arsye pse një kulturë e tillë të mos ndodhë edhe njëherë. Gjithë çka nevojitet është dëshira e njerëzve për të jetuar në pajtim me parimet morale të Kuranit, duke filluar nga vetvetja dhe më vonë, duke u përpjekur që ato t'ua

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

transmetojnë të tjerëve. Kur çdonjëri, prej niveleve më të larta deri te ato më të ulta, fillon të zbatojë parimet morale të urdhëruara në Kuran, ata do të bëhen të drejtë, të mëshirshëm, tolerant, përplot dashuri, të respektueshëm dhe falës. Ajo, pastaj, do të sjell paqe në tërë shoqërinë.

Myslimani duhet të përdor fjalë të buta për t'ju bërë thirrje njerëzve në moralin e Islamit

Secili Mysliman ka për detyrë t'i thërras të tjerët në moralin e Islamit, t'i bëj me dije për ekzistencën e Zotit dhe argumentet e krijimit të Tij, Zoti Vet ka shpallur këtë përgjegjësi në Ajetin 3:104: "Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit." Ai shpall po ashtu mënyrën se si duhet bërë kjo thirrje:

Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) në atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit. (16:125)

VETËM DASHURIA MUND T'Ë SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

Një fjalë e mirë dhe një lehtësim (që i bëhet lypësit) është më e dobishme se një lëmshë që përcillet me të keqe. All-llahu nuk ka nevojë për askënd, është i Butë. (2:263)

Besimtarët e sinqertë e dinë rëndësinë e kësaj përgjegjësie, të përshkruar në Ajetin 3:114: **“I besojnë All-llahut dhe Ditës së Fundit, këshillojnë për të mirë dhe largojnë nga të këqijat dhe përpiqen për punë të dobishme. Ata janë prej të mirëve.”** Prandaj, ata i thërrasin të gjithë ata rreth tyre – shokët, kushërinjtë, çdokënd që munden – të besojnë në Zotin, t’ia kenë frikën Atij dhe të shfaqin moral të drejtë. Kjo karakteristikë e bukur e Myslimanëve përshkruhet në Ajetin 9:71:

Besimtarët dhe besimtare janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë dhe ndalojnë nga e keqa, e falin namazin

dhe japin zeqatin, respektojnë All-llahun dhe të Dërguarin e Tij.

Të tillët do t’i mëshirojë All-llahu.

All-llahu është ngadhënjes, i urtë.

Nga ky ajet, është e qartë se të gjithë besimtarët, gjatë gjithë jetës së tyre janë të obliguar të shpjegojnë moralin e drejtë, të jetojnë në pajtim me të, t’i

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)



këshillojnë të tjerët të bëjnë vepra të mira dhe t'i këshillojnë që t'i shmangen të keqes. Zoti i urdhëron besimtarët të përdorin fjalë të mira: "E ti robërve të Mi thuaju: "Le ta thonë vetëm atë që është më e mira..." (17:53)

Zoti i përshkruan fjalët e mira dhe të këqija me këtë analogji në Kuran (14:24-27)

A nuk ke kuptuar se si All-llahu bëri shembull: fjalën e mirë si pema e mirë që rrënjët e saj janë thellë (në tokë) e degët e saj janë lart, E që me vullnetin e Zotit, ajo e jep frytin e vet në çdo kohë. All-llahu, pra u parashtron njerëzve shembuj ashtu që ata të mendojnë. Dhe shembulli i fjalës së keqe si një pemë e keqe që është shkukur mbi tokë e që nuk ka të qëndruar. All-llahu forcon ata që besuan në fjalën e fortë (të mirë) në jetën e kësaj bote edhe në botën tjetër, ndërsa mizorët All-llahu i bën të humbur. All-llahu punon çka të dojë.

Çdonjëri që dëshiron të qoj një jetë të moralshme duhet t'i inkurajoj të tjerët drejt mirësisë. Çdonjëri i cili dëshiron t'i shoh të tjerët të sillen sipas ndërgjegjes së tyre duhet t'i inkurajojnë ata

VETËM DASHURIA MUND T'Ë SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

të veprojnë në atë mënyrë dhe çdonjëri që i kundërvihet mizorisë duhet t'i paralajmërojnë ata që përfshihen në të. Thënë shkurt, çdonjëri që dëshiron që drejtësia të mbizotëroj duhet t'i thërras të gjithë të tjerët të veprojnë në përputhje me të. Mirëpo, kur të bëhet kjo thirrje, ajo që është më se e rëndësishme të mbahet në mend është se vetëm Zoti mund t'i frymëzoj njerëzit të bëhen Mysliman dhe sepse fjalët e ëmbla mund të kenë ndikim në ta. Zoti ka shpallur se Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të), për shkak të karakterit të tij fisnik dhe parimeve të larta morale, gjithmonë u soll mirë me njerëz dhe e ka rekomanduar si shembull që duhet ndjekur për mbarë njerëzimin.

Islami urdhëron (për) solidaritet dhe bashkëpunim midis njerëzve

Në Kuran (5:2), Zoti ka dhënë këtë urdhër:

... Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e armiqësi. Kini dro dënimit të All-llahut, se me të vërtetë All-llahu është ndëshkues i fortë.

Siç e bën të qartë ky varg, besimtarët luftojnë vetëm për atë që është e mirë. Ata i konsiderojnë fjalët e Zotit në Ajetin 4:127 të Kuranit: **“çfarëdo të mire që punoni, All-llahu di shumë për të.”** Ata nuk harrojnë kurrë se do të shpërblehen për gjithë çka veprojnë në praninë e Zotit tonë, por Zoti shpall se ndihma e kënaqshme reciproke duhet të jetë në një kornizë të “mirësisë dhe besimit.” Kuptimi i mirësisë shpjegohet gjithashtu në Ajetin 2:177:

Nuk është tërë e mira (e kufizuar) të ktheni fytyrat tuaja

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut dhe Ditës së Fundit, Engjëjve, Librit dhe Pejgamberëve dhe pasurinë që e do, ua jap të afërmve, bonjakëve, të varfërve, udhëtarëve, lypësve dhe për lirimin e robërve, dhe ai që e fal namazin, e jap zeqatin, dhe ata që kur premtojnë e zbatojnë, dhe të durueshmit në skamje, në sëmundje dhe në flakën e luftës. Të tillët janë ata të sinqertit dhe të tillët janë ata të devotshmit.

Prandaj, mirësia e vërtetë, ndryshon mjaft nga mënyra se si shoqëria e kupton atë në përgjithësi. Ata të cilët nuk jetojnë në pajtim me parimet morale të Kuranit i konsiderojnë veprat e mira si dhurata që ata japin, kurdo që ata të dëshirojnë. Zakonisht ata i kufizojnë veprat e tilla të mira në dhënien e të hollave një lypësi apo ia lëshojnë ulësen e tyre në autobus një personi më të moshuar.

Mirëpo, siç kemi mundur të kuptojmë nga ajeti i mësipërm, Kurani e përshkruan të mirën si një koncept që rrethon gjithë jetën e një besimtari, si një obligim që duhet të përmbushet gjatë gjithë jetës së tij, jo vetëm kur atij t'ia merr mendja apo kur ndodhë t'i bie në mend. Si një rob i Allahut, çdo Mysliman posedon sinqeritet të vërtetë dhe u ndihmon të varfërve dhe atyre që kanë nevojë, madje edhe nëse ai vet është nevojli, që madje heq dorë prej gjërave që i do (Kuran, 76:8). Në Ajetin 51:19, i cili lexon: **“Dhe në pasurinë e tyre kishin përcaktuar të drejtë për lypësin dhe për të ngratin (që ka nevojë por nuk lyp).”** Zoti ka shpallur se dhënia e ndihmës, ndihma e dhënë të tjerëve dhe bërja e veprave të mira të gjitha janë detyrë e Myslimanëve. Ata ndihmojnë pa kushtëzim dhe besimtarët janë të gatshëm të bëjnë çfarëdo sakrifice për t'i nxitur të tjerët drejt asaj që është e mirë. Ata nuk presin

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

shpërblim për këtë, përveç fitimit të kënaqësisë së Zotit. Në Ajetin 76:9-10, Zoti përshkruan sjelljen e tillë nga ana e besimtarëve:

Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të All-llahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim. Ne i frikësohemi (dënimit të) Zotit tonë në një ditë që fytyrat i bën të zymta dhe është shumë e vështirë.

Myslimanët e dinë se Allahu është Zoti i drejtësisë së pafund dhe kurrë nuk harron se sjellja e mirë e tyre do të shpërblehet siç e meritojnë në ahiret. Ata nuk harrojnë as se jeta në këtë botë është vetëm jetë e përkohshme dhe se banesa e tyre e vërtetë shtrihet në praninë e Zotit. Në Kuran, Ai i paralajmëron njerëzit për fundin e tyre të pashmangshëm dhe i thërret ata të sillen në një mënyrë me të cilën Ai është i kënaqur:

Ne nuk i krijuam qiejt dhe tokën dhe çdo gjë në mes tyre ndryshe vetëm me urtësi (të madhe). E s'ka dyshim se momenti i fundit (kiameti) do të vijë, e ti (Muhammed) sillu në mënyrë të njerëzishme. (15:85)

Adhuroni All-llahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, silluni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve, ndaj fqiu të afërt, ndaj fqiu të largët, ndaj shokut pranë vetes, ndaj udhëtarit të largët dhe ndaj robërve. All-llahu nuk e do atë që është kryelartë dhe atë që lavdërohet. (4:36)

Shpërblimi për ata që shfaqin sjellje të kënaqshme është një lajm shumë i mirë për tërë njerëzimin dhe është shpallur në këto vargje, me këto fjalë:

(Përkujto) Ditën kur Ne Xhehenemit i themi: "A je

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

mbushur?" E, ai thotë: "A ka ende?" (50:30)

Atyre që patën frikë nga (dënimi) All-llahu, u thuhet: "Ç'është ajo që shpalli Zoti juaj?" Ata thonë: "Shpalli çdo të mirë!" Ata që bënë vepra të mira, edhe në këtë jetë kanë shpërblim të mirë, por shpërblimi i tyre në botën tjetër është shumë më i mirë, e sa vend i mirë është ai i të devotshëmve. Është Xheneti i Adn-it, ku do të hyjnë, nën të rrjedhin lumenj, aty kanë çka të dëshirojnë, ashtu i shpërblen All-llahu të ruajturit. (16:30-31)



Qur'anic morality demands humility, tolerance, and kindness. Peace and security reign in societies which live by these virtues.





Nuk është ashtu (si thonë ata),
po ai që është dorëzuar All-
llahut dhe është bami-rës, ai e
ka shpërblimin e vet te Zoti i tij,
për ata nuk ka frikë, as nuk
kanë pse të mër-ziten.
(Kuran, 2:112)

S'ka dyshim se All-llahu nuk bën
pa drejtë as sa grimca, e nëse
ajo vepër është e mirë, Ai e
shumëfishon atë dhe Vetë Ai i jep
shpërblim të madh.
(Kuran, 4:40)



Islami na urdhëron të bëjmë vepra të mira dhe t'i shmangemi të keqes

Besimtarët mësojnë kuptimin e vërtetë të së mirës dhe të keqes nga Kurani, një libër i shpallur nga Zoti si Standard me anën e të cilit bëhet dallimi i të vërtetës nga e rrejshmja. “Konceptet si e mira dhe e keqja, e drejta dhe e gabuara, shpjegohen në Kuran me shembuj që çdo njeri mund t'i kuptoj. Frika e besimtarëve ndaj Zotit u dhuron atyre dritë dhe mirëkuptim për t'ju ndihmuar të bëjnë dallimin midis të mirës dhe të keqes. (8:29)”

Myslimanët kalojnë gjithë jetën e tyre duke vënë në jetë dijeninë e tyre për të mirën dhe të keqen, siç përshkruhet në Kuran. Mirëpo ata marrin në shpatullat e tyre edhe një tjetër përgjegjësi të rëndësishme: t'i thërrasin të tjerët ta shohin të vërtetën, t'i shmangen të keqes dhe të jetojnë sipas parimeve morale të Kuranit. Besimtarët kalojnë gjithë jetën e tyre duke u treguar njerëzve për dallimin midis të mirës dhe të keqes, sepse për besimtarin, Zoti ka dhënë këtë urdhër (3:104):

Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit.

Në Ajetin 3:110, Zoti thekson se si ata të cilët veprojnë në përputhje me këtë urdhër janë shumë më të mbarë se të tjerët:

Je jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve. Të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në All-llahun. E sikur ithtarët e librit të besonin drejt, do të ishte shumë më e mirë për ta. Disa prej tyre janë besimtarë, por shumica e tyre janë larg rrugës së Zotit.

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

Besimtarët e zbatojnë këtë detyrë Kuranore jo vetëm në lidhje me ata që janë të padijshëm për dallimin midis të drejtës dhe të gabuarës dhe pa dije për fenë, por po ashtu në lidhje me vet besimtarët. Njerëzit bëjnë gabim jo vetëm për shkak të mosdijes, por ndonjëherë për shkak të harresës, gabimisht apo të nxitur nga dëshirat tokësore. Duke qenë kështu, besimtarët e nxisin të mirën dhe e ndalojnë të keqen duke e përkujtuar njëri tjetrin për urdhrat Kuranore. Ata ia tërheqin vërejtjen njëri tjetrit se në këtë botë, ata që nuk arrijnë t'i shmangen të keqes do të pësojnë vuajtjet e xhehenemit (ferrit), se vetëm ata të cilët bëjnë vepra të mira dhe me devotshmëri zbatojnë obligimet e tyre fetare do të shpërblehen me Xhenet (Parajsë). Ajo përgjegjësi e hirshme nënkupton se ata kurrë nuk ndiejnë lodhje apo dëshpërim gjersa vazhdojnë t'i paralajmërojnë të tjerët me dhembshuri dhe dashuri, pa marr parasysh çfarë gabimesh mund të kenë bërë ata. Në shumë vargje, Zoti shpall se Ai i do ata të cilët kanë durim dhe i thërret besimtarët të jenë të durueshëm kur i zbatojnë parimet morale të Kuranit:

O ju që keni besuar, kërkonin ndihmë me durim e me të falur, se vërtetë All-llahu është me durimtarët. (2:153)

... Ata të cilët kishin durim dhe bënë vepra të mira, të tillët kanë falje (të gabimeve) dhe shpërblim të madh. (11:11)

Islami na urdhëron që të keqen ta kthejmë me të mirë

Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj, (të keqen) ktheje me mirësi, se atëherë ai, mes teje dhe të cilit ka armiqësi, do të bëhet (si) mik i afërt. (41:34)

VETËM DASHURIA MUND T'Ë SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

Ti të keqen kthe me më të mirën. Ne e dimë më së miri atë që shpifin ata. (23:96)

Në këto vargje, Zoti u premtan besimtarëve se mund të sigurojnë rezultate pozitive, për aq kohë sa ata të përvetësojnë qëndrim të mirë përballë keqbërjes. Kurani thekson se madje kur një besimtar ka të bëjë me një armik, ai prapëseprap mund të vendos një miqësi të ngrohtë. T'i përgjigjesh të keqes me të mirë është po ashtu një pjesë thelbësore e mëshirës. Kur cilido besimtar sheh të tjerët të përvetësojnë një qëndrim me të cilin Zoti nuk do të jetë i kënaqur, ai pikësëpari mendon se çfarë pasoja do të ketë kjo për ta në ahiret. Pastaj ai u afrohet atyre me durim dhe përlulje, duke mos pranuar t'ia lejoj vetes të jetë mendjemadh.

Gjatë gjithë jetës së tyre, besimtarët mund të takojnë njerëz me karaktere shumë të ndryshme. Megjithatë, ata nuk do të ndryshojnë botëkuptimin e tyre për parimet morale në pajtueshmëri me njerëzit që takojnë. Të tjerët mund të flasin me tallje, të përdorin fjalë të shëmtuara, të zemërohen apo madje të sillen në mënyrë armiqësore. Megjithatë besimtari i sinqertë kurrë nuk pushon së qeni i sjellshëm, modest dhe i mëshirshëm. Ai nuk do t'ju përgjigjet fjalëve të shëmtuara me më shumë fjalë të njëjta. Ai nuk do t'ju qeshet atyre që tallen me të dhe as që do t'i përgjigjet zemërimit me zemërim, por mbetet i durueshëm dhe tolerant. Përballë sjelljes ofenduese, ai do të përgjigjet me parime të drejta morale dhe me një dhembshuri të tillë sa që tjetri do të ndjehet i turpëruar.

Ky është morali që Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të) na këshillon. Në njërin prej haditheve, ai thotë: *"Mos ktheni të keqen me të keqe, por shfajësoni dhe falni."* –¹⁸ Në një hadith tjetër, ai u bën thirrje besimtarëve me këto fjalë: *"Asnjëri*

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

prej jush nuk duhet të jetë person i dobët i cili thotë: 'Ai i cili nuk është i mëshirshëm s' do të jetë i mëshiruar.'" ¹⁹

Në Kuran (5:13), Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të) i është thënë të jetë që falës kur t'i bëhet tradhti nga disa prej bijve të Izraelit:

... Ata braktisën një pjesë me të cilën ishin urdhëruar. Ti vazhdimisht do të vëresh tradhtinë e një pjese të tyre, përpos një pakice nga ata. Pra falju dhe hiq (mos ua vë veshin) tyre. All-llahu i do ata që bëjnë mirë.

Siç tregon ky ajet, morali i dobët i shprehur prej dikujt tjetër nuk është arsyezim për të shprehur të njëjtën gjë. Secili individ është përgjegjës vetëm ndaj Zotit për veprimet e tij. Sipas Kuranit, veprimi me dhembshuri, dashuri dhe moral të duhur përballë sjelljes së keqe të dikujt tjetër është shenjë e moralit të lartë që zbulon nivelin e devotshmërisë ndaj Zotit. Një ajet (10:26) zbulon shpërblimin që do të sjellë një qëndrim aq i kënaqshëm:

Atyre që bëjnë vepra të mira, u takon e mira (xheneti) edhe më tepër (e shohin All-llahun). Fytyrat e tyre nuk i mbulon pluhuri i zi as nënçmimi, ata janë banues të xhenetit, aty janë përgjithmonë.

Islami i urdhëron besimtarët të jenë falës, gjithmonë

Një shenjë e rëndësishme e dhembshurisë është aftësia e një personi për të falur. Në Ajetin 7:199, Zoti u bën thirrje robërve të Tij që të falin: **Ti (Muhammed) merre të lehtë, urdhëro për të mirë dhe largohu prej të padijshmëve.**

VETËM DASHURIA MUND T'Ë SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

Disave ky qëndrim mund t'ju duket i vështirë, por në sytë e Zotit, do të shpërblehet mirë. Ata të cilët i kaplon zemërimi munden po ashtu të refuzojnë të falin gabimet. Por besimtarëve, Zoti u ka shpallur se më mirë është me falë dhe në Ajetin 42:40, ka rekomanduar këtë moral:

Ndëshkimi i të keqes, bëhet me një të keqe në të njëjtën masë, e kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është tek All-llahu...

Në një ajet tjetër (42:43), Zoti shpall:

“Kush bën durim dhe fal, s'ka dyshim se ajo është virtyti më i lartë (i lavdishëm).”

Ajeti 24:22 thekson se kjo është një formë shumë e lartë e moralit:

Të ndershmit dhe të pasurit nga ju, të mos betohen se nuk do t'u japin të afërmve, të varfërve dhe atyre që për hir të All-llahut lanë vendlindje e tyre, po le t'ua falin (gabimin) dhe mos t'ua zënë për të madhe. A nuk dëshironi që All-llahu t'ua falë. All-llahu falë dhe mëshiron shumë.

Me këto fjalë, Ai i nxitë besimtarët të marrin parasysh pozitën e tyre kur vjen deri te falja. Sepse çdonjëri dëshiron që Zoti ta falë atë, ta mbrojë dhe të mëshirohet mbi të, po ashtu ne shpresojmë se gjithë të tjerët do t'na shfajësojnë dhe do t'na i falin gabimet tona. Prandaj, Zoti ka urdhëruar besimtarët që të sillen me të tjerët në të njëjtën mënyrë që do të dëshironin të tjerët të sillen

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)


ndaj tyre. Kjo përgjegjësi e rëndësishme i nxitë besimtarët të jenë falës ndaj njëri tjetrit. Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të) i inkurajoi ata me këto fjalë: *“Më së afërmi Zotit është ai person, i cili e falë, kur e ka nën sundimin e tij, dikend që do ta dëmtonte atë.”* ²⁰ Besimtarët, duke qenë të vetëdijshëm se në secilin moment mund të bëjnë gabim, sillen në mënyrë tolerante ndaj të tjerëve. Ato ajete në Kuran që flasin për pendimin e bëjnë të qartë se mosbërja kurrë e gabimeve nuk është po aq e rëndësishme sa vendosmëria për t’mos i përsëritur kurrë ato. Njëri prej këtyre ajeteve (4:17) lexon:

Pendim i pranueshëm te All-llahu është vetëm ai i atyre që e bëjnë të keqen me mosdije e pastaj shpejt pendohen; të tillëve All-llahu ju pranon pendimin, se All-llahu është më i dijsmi, më i urti.

Në rrethanat që zbulojnë sinqeritetin e një individi, besimtarët sillen në mënyrë falëse dhe me dhembshuri ndaj njëri tjetrit. Nëse ai i cili ka bërë gabim pendohet sinqerisht për gabimin e bërë, ata nuk mund ta gjykojnë atë për veprat e tij të kaluara. Madje edhe nëse besimtarët kanë plotësisht të drejtë dhe të tjerët janë plotësisht në gabim, prapsepap nuk bëhen nuk pendohen për faljen, sepse Zoti rekomandon një sjellje të tillë si shembull të moralit të drejtë (3:134):

Të cilët japin kur janë shlrirë edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllëfin, që u falin (të keqen) njerëzve, e All-llahu i do bamirësit.

Kur vjen puna tek falja, besimtarët nuk bëjnë dallim në mes të gabimeve të mëdha dhe të vogla, dhe as që formojnë

A vibrant garden scene with a path, flowers, and trees, framed by an ornate gold border. The path is a narrow, light-colored walkway that leads from the foreground into a lush garden. The garden is filled with various flowers, including large pink and white peonies, smaller red flowers, and clusters of blue flowers. The background is a dense forest of tall, thin trees with green foliage. The entire scene is enclosed within a decorative gold frame with intricate scrollwork and a blue inner border.

**Dhe ti, jij i durueshëm, se
All-llahu nuk ua humb
shprblimin bëmirsve.
(Kuran, 11:115)**

botëkuptimin e tyre të faljes në përputhje me këtë. Ndonjëri mund të ketë bërë një gabim që u ka shkaktuar dëm të madh të tjerëve, humbje të madhe financiare, madje edhe humbjen e jetës. Sidoqoftë besimtarët janë të vetëdijshëm se gjithçka ndodhë me lejen e Zotit, si pjesë e fatit të përcaktuar prej Tij. Kur vjen puna tek gjërat e tilla, ata prandaj vendosin veten e tyre në duart e Zotit dhe nuk ndjejnë kurrfarë zemërim personal.

Dhe e kundërta, nëse ndonjëri e shkel këtë rregull Kuranor dhe tejkalon kufijtë e përcaktuar nga Zoti, vetëm Zoti mund ta gjykoj sjelljen e atij personi. Kurrë nuk i takon besimtarit të gjykoj – apo të refuzoj të fal – cilindo njeri për çfarëdo çështje. Personi të cilit i vjen keq me të vërtetë dhe pendohet do ta ketë shpërblimin e tij vetëm në praninë e Zotit. Në shumë vargje, Zoti ka shpallur se përveç “shoqërimit të shokëve Atij,” Ai do t’i fal gabimet e besimtarëve që pendohen sinqerisht. Pasi që një njeri nuk mund të dijë për pendimin e tjetrit, besimtarët falin thjeshtë në mënyrën që Zoti ua ka shpallur atyre. Nëse Kurani ka çfarë të thotë në lidhje me një çështje të veçantë, ata e trajtojnë personin që ka bërë gjynah në atë pikëpamje.

Islami i urdhëron besimtarët të jenë falës, gjithmonë

Një shenjë e rëndësishme e dhembshurisë është aftësia e një personi për të falur. Në Ajetin 7:199, Zoti u bën thirrje robërve të Tij që të falin: **Ti (Muhammed) merre të lehtë, urdhëro për të mirë dhe largohu prej të padijshmëve.**

Disave ky qëndrim mund t’ju duket i vështirë, por në sytë e Zotit, do të shpërblehet mirë. Ata të cilët i kaplon zemërimi

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

munden po ashtu të refuzojnë të falin gabimet. Por besimtarëve, Zoti u ka shpallur se më mirë është me falë dhe në Ajetin 42:40, ka rekomanduar këtë moral:

Ndëshkimi i të keqes, bëhet me një të keqe në të njëjtën masë, e kush fal e bën pajtim, shpërblimi i tij është tek All-llahu...

Në një ajet tjetër (42:43), Zoti shpall:

" Kush bën durim dhe fal, s'ka dyshim se ajo është virtyti më i lartë (i lavdishëm)."

Ajeti 24:22 thekson se kjo është një formë shumë e lartë e moralit:

Të ndershmit dhe të pasurit nga ju, të mos betohen se nuk do t'u japin të afërmve, të varfërve dhe atyre që për hir të All-llahut lanë vendlindje e tyre, po le t'ua falin (gabimin) dhe mos t'ua zënë për të madhe. A nuk dëshironi që All-llahu t'u falë. All-llahu falë dhe mëshiron shumë.

Me këto fjalë, Ai i nxitë besimtarët të marrin parasysh pozitat e tyre kur vjen deri te falja. Sepse çdonjëri dëshiron që Zoti ta falë atë, ta mbrojë dhe të mëshirohet mbi të, po ashtu ne shpresojmë se gjithë të tjerët do t'na shfajësojnë dhe do t'na i falin gabimet tona. Prandaj, Zoti ka urdhëruar besimtarët që të sillen me të tjerët në të njëjtën mënyrë që do të dëshironin të tjerët të sillen ndaj tyre. Kjo përgjegjësi e rëndësishme i nxitë besimtarët të jenë falës ndaj njëri tjetrit. Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të) i inkurajoi ata me këto fjalë: *"Më së afërmi Zotit është ai person, i cili e falë, kur e ka nën sundimin e tij, dikend që do ta dëmtonte atë."*²⁰ Besimtarët, duke qenë të vetëdijshëm se në secilin moment mund të bëjnë gabim, sillen në mënyrë tolerante ndaj të

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)



tjerëve. Ato ajete në Kuran që flasin për pendimin e bëjnë të qartë se mosbërja kurrë e gabimeve nuk është po aq e rëndësishme sa vendosmëria për t'mos i përsëritur kurrë ato. Njëri prej këtyre ajeteve (4:17) lexon:

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

Pendim i pranueshëm te All-llahu është vetëm ai i atyre që e bëjnë të keqen me mosdije e pastaj shpejt pendohen; të tillëve All-llahu ju pranon pendimin, se All-llahu është më i dijsmi, më i urti.

Në rrethanat që zbulojnë sinqeritetin e një individi, besimtarët sillen në mënyrë falëse dhe me dhembshuri ndaj njëri tjetrit. Nëse ai i cili ka bërë gabim pendohet sinqerisht për gabimin e bërë, ata nuk mund ta gjykojnë atë për veprat e tij të kaluara. Madje edhe nëse besimtarët kanë plotësisht të drejtë dhe të tjerët janë plotësisht në gabim, prapeseprap nuk bëhen nuk pendohen për faljen, sepse Zoti rekomandon një sjellje të tillë si shembull të moralit të drejtë (3:134):

Të cilët japin kur janë shpirtërisht edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllëfin, që u falin (të keqen) njerëzve, e All-llahu i do bamirësit.

Kur vjen puna tek falja, besimtarët nuk bëjnë dallim në mes të gabimeve të mëdha dhe të vogla, dhe as që formojnë botëkuptimin e tyre të faljes në përputhje me këtë. Ndonjëri mund të ketë bërë një gabim që u ka shkaktuar dëm të madh të tjerëve, humbje të madhe financiare, madje edhe humbjen e jetës. Sidoqoftë besimtarët janë të vetëdijshëm se gjithçka ndodhë me lejen e Zotit, si pjesë e fatit të përcaktuar prej Tij. Kur vjen puna tek gjërat e tilla, ata prandaj vendosin veten e tyre në duart e Zotit dhe nuk ndjejnë kurrfarë zemërim personal.

Dhe e kundërta, nëse ndonjëri e shkel këtë rregull Kuranor dhe tejkalon kufijtë e përcaktuar nga Zoti, vetëm Zoti mund ta gjykojë sjelljen e atij personi. Kurrë nuk i takon besimtarit të gjykojë – apo të refuzojë të fal – cilindo njeri për çfarëdo çështje. Personi

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

të cilit i vjen keq me të vërtetë dhe pendohet do ta ketë shpërblimin e tij vetëm në praninë e Zotit. Në shumë vargje, Zoti ka shpallur se përveç “shoqërimit të shokëve Atij,” Ai do t’i fal gabimet e besimtarëve që pendohen sinqerisht. Pasi që një njeri nuk mund të dijë për pendimin e tjetrit, besimtarët falin thjeshtë në mënyrën që Zoti ua ka shpallur atyre. Nëse Kurani ka çfarë të thotë në lidhje me një çështje të veçantë, ata e trajtojnë personin që ka bërë gjynah në atë pikëpamje.



ISLAMI I URDHËRON NJERËZIT TË SILLEN ME BUTËSI

Zoti posedon mëshirë të pakufishme dhe është falës, mbrojtës dhe i butë ndaj besimtarëve. I Gjithëmëshirsmi dhe Mëshirëploti i ka vënë të gjitha mirësitë e gjithësisë në dispozicion të Njeriut, duke e mbështetur atë me të dërguar për të zbuluar rrugën e drejtë. Ai i udhëzon të gjithë njerëzit të jenë robër të singertë të Tij me ndihmën e shpalljeve të Tij, duke qenë secila prej tyre një tabelë udhëzuese për në atë rrugë. Zoti ynë është Halimi (I Mëshirshmi), Adl (Zoti i Drejtësisë së pafund), 'Afu (Shlyesi i gjynaheve), Asim (Mbrojtësi), Barr (Burimi i gjithë Mirësisë), Ghafir (Falësi), Hafiz (Mbrojtësi), Karim (Zemërgjeri), Latif (I ndieshmi), Muhsin (Zoti i mirësisë së pafund), Rauf (i Gjithëmëshirmi), Salam (Krijuesi i sigurisë), Teu(v)ab (Pranuesi i pendimit) dhe Vehab (Dhuruesi).

Besimtarët e dinë se janë nën mbrojtjen e Zotit tonë dhe janë të vetëdijshëm për mirësinë dhe butësinë e Tij të pafund. Për atë arsye, ata janë të etur të bëhen robër të tillë që e kënaqin Atë, të cilët meritojnë mëshirën e Tij dhe Parajsën. Siç kemi parë, një veti që dallon besimtarët është se ata janë përplot dashuri dhe dhembshuri. Një Mysliman sillet me shumë butësi, gjithmonë duke i trajtuar të tjerët në mënyrë të njerëzishme. Zoti ka ofruar natyrën e butë të Profetit tonë (Paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të) si shembull për të gjithë besimtarët (3:159):

Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falju atyre dhe kërko

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në All-llahun, se All-llahu i do ata që mbështeten.

Ky ajet përshkruan se si natyra e butë, e moralshme e Profetit tonë (Paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të) pati ndikim pozitiv/ndikoi pozitivisht në njerëz, me anën e së cilës ata u bënë edhe më të devotshëm ndaj tij. Kurani përshkruan karakteret fisnike të profetëve të tjerë të dashur si shembuj që duhet ndjekur. Një ajet (11:87) rrëfen se si, kur Profeti Shuajb (paqja qoftë mbi të) u dërgua të populli i Medjenit, ata i thanë atij: Ata thanë: “O Shuajb, a namazi yt po të thotë të na urdhërosh që ta braktisim atë që adhuruan prindërit tanë, ose(po të urdhëron) për të punuar në pasurinë tonë ashtu si të dëshirojmë? Vërtet, ti qenke i butë e i mençur”. (Kjo ishte tallje e tyre). Morali i lartë i Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) është një tjetër shembull për çdonjëri. Kurani na tregon se ai ishte i ndjeshëm, i butë dhe plot dashuri. Vargjet në fjalë lexojnë:

Edhe lutja e Ibrahimit për babain e vet nuk ishte tjetër, pos për shkak të një premtimi që ia pat premtuar atij, e kur iu bë e qartë se ai ishte armik i All-llahut, u largua prej tij. S’ka dyshim, Ibrahimit ishte shumë i ndjeshëm dhe i butë. (9:114)

Vërtet, Ibrahimit ishte shumë i butë, shumë i dhimbshëm dhe i kthyesëm. (11:75)

Zoti i ka urdhëruar besimtarët e tij që gjithmonë të sillen në mënyrë të mirë, të flasin me njerëzi dhe të sillen mirë me të tjerët. Profetët e tij u sollën në pajtim me këtë. Për shembull, kur Profeti

VETËM DASHURIA MUND T'Ë SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

Musa (Mojsiu) (paqja qoftë mbi të) po bëhej gati të shkonte te Faraoni, njëri prej sunduesve më tiran dhe më mizor i të gjitha kohërave, Zoti iu drejtua Musait me këto fjalë (20:42-44):

Shko me argumentet e Mia ti dhe vëllai yt, e mos e hiqni prej kujdesit të përmendurit ndaj Meje. Shkoni që të dy te faraoni, se ai vërtet e ka tepruar. Atij i thuani fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet.

Këto vargje janë përkujtues i rëndësishëm se çdo njeri është i obliguar të jetoj sipas parimeve morale që shpall Kurani dhe të përvetësoj moralin e profetëve. Kurani i këshillon këto ideale për njerëzimin: Dashurinë ndaj të gjitha krijesave që Zoti ka krijuar; me qenë i njerëzishëm dhe i butë sa më shumë që të jetë e mundshme; që gjithmonë përkrah kompromisin dhe tolerancën; që kurrë nuk flet në mënyrë të ashpër, madje edhe në rrethanat më të vështira; që bën sakrifica me kënaqësi dhe me vetdëshirë; që gjithnjë dëshiron dhe përpiqet për më të mirën për të tjerët; që i lë prapa vetes dëshirat e veta personale; që u dëshiron të tjerëve pikërisht atë që e dëshiron për veten e tij; që është gjithmonë i shpejtë për t'ju ofruar ndihmë atyre që kanë nevojë; dhe që i hedh poshtë të gjitha format e mizorisë. Kjo, pa dyshim, është pikërisht modeli etik të cilin po e kërkon njerëzimi.

Islami mbështet lirinë e besimit

Në çështjet e besimit, Islami u ofron njerëzve liri të plotë dhe të shprehur në mënyrën më të qartë. Kështu ka qenë që prej se Islami u shpall së pari dhe formon bazën e moralit të sotëm Islamik. Vargjet lidhur me këtë temë (2:256) janë plotësisht të qarta:

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

Në fe nuk ka dhunë. Është sqaruar e vërteta nga e kota. E kush nuk i beson të pavërtetat, e i beson All-llahut, ai është kapur për lidhjen më të fortë, e cila nuk ka këputje. All-llahu dëgjon gjithçka dhe është i Gjithëdijsëm.

Sipas Islamit, njerëzit janë të lirë të zgjedhin çfarëdo besimesh që dëshirojnë dhe askush nuk mund ta detyroj askënd tjetër. Po, një Mysliman është i obliguar t'ua komunikoj të tjerëve Islamit dhe t'ua shpjegoj ekzistencën e Zotit, të tregoj se Kurani është libri i shpalljes së Tij, se Profeti Muhammed (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të) ishte i dërguar i Tij, të flas për ahiretin (jetën e përtejme) dhe Ditën e Gjykimit dhe për bukurinë e moralit Islamik. Mirëpo detyra e tij është e kufizuar vetëm në shpjegimin e fesë. Në një ajet (16:125), Zoti ia bën me dije Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të) se ai është vetëm i dërguar:

Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit.

Një ajet tjetër (18:29) thotë: E ti thuaj: **“E vërteta është nga Zoti juaj, e kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë...”**. Në Ajetin 26:3, Zoti ynë paralajmëron Profetin (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të): A mos do të mbysësh ti veten (Muhammed) (me pikëllim) pse ata nuk bëhen besimtarë?!

Ai po ashtu ia bën Profetit të Tij (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) këtë paralajmërim (50:45):

Ne dimë më së miri çka thonë ata, e ti ndaj tyre nuk je ndonjë

VETËM DASHURIA MUND T’I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

dhunues, ti këshilloje me këtë Kuran atë që i ka frikë kërcënimit Tim.

Njerëzit janë të lirë të zgjedhin në mënyrë të drejtë apo të gabueshme. Kur Islami – rruga e drejtë që Zoti ka shpallur – të shpjegohet, ata fillojnë të besojnë me vullnetin e tyre të lirë, duke arritur në këtë vendim pa u ushtruar presion mbi ta. Nëse bëjnë zgjidhje të gabueshme, do të përballen me pasojat e tyre në ahiret. Ajeti 10:99 i Kuranit në lidhje me këtë temë përmban urdhrin dhe përkujtimin më të qartë: “Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t’i besonin çka janë në tokë që të gjithë. A ti do t’i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë? “

Kur ndonjëri prej besimtarëve i shpjegon çështjet, ndonjëri mund të filloj të besoj menjëherë, ndërsa një tjetër mund të përvetësoj një qëndrim tallës dhe agresiv. Njeriu i cili pason ndërgjegjen e tij mund të vendos t’ia përkushtoj jetën e tij arritjes së kënaqësisë së Zotit, madje derisa një tjetër, duke vepruar si vepruan mohuesit, mund t’iu përgjigjet atyre fjalëve të mira me ligësi. Mirëpo, mohimi i tij nuk do ta shpie cilindo që bëri thirrjen të vuaj apo të bie në dëshpërim. Në Ajetet 12: 103-104, Zoti thotë: “Po ti edhe pse lakmon (për besimin e tyre), shumica e njerëzve nuk do të besojnë. Megjithatë që ti nuk kërkon prej tyre ndonjë shpërblim për të (për këshillë e udhëzim). Ai (Kurani) nuk është tjetër vetëm se këshillë për mbarë njerëzit. “

Ajo që është me rëndësi është se pa marr parasysh se në çfarë reagimi has, njeriu i cili vepron në pajtim me Kuranin vazhdon të shfaqë aso morali me të cilin Zoti është i kënaqur, nuk pranon të bëj lëshime për të dhe i lë gjërat në duart e Zotit. Zoti na ka thënë se feja e Tij duhet të shpjegohet në mënyrën më të

**Një fjalë e mirë dhe një lehtësim
(që i bëhet lypësit) është më e
dobishme se një lëmoshë që për-
cillet me të keqe. All-llahu nuk ka
nevojë për askë, është i Butë.**

(Kuran 2:263)



VETËM DASHURIA MUND T’I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

mirë. Në fjalët e Kuranit (29:46):

“Tthtarët e librit mos i polemizoni ndryshe (kur i thirrni në fenë tuaj) vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thuajuni: “Ne i besuam asaj që na u zbrit dhe që u zbrit juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij. “

Nuk guxojmë të harrojmë se çdo ngjarje, e madhe apo e vogël, ndodhë sipas një fati të krijuar prej Zotit. Ai ia zbulon rrugën e drejtë çdonjërit që thirret të besoj në Të. Për këtë arsye, besimtarët nuk ndiejnë shqetësim për sjelljen e atyre të cilët e refuzojnë Atë. Kurani jap disa shembuj. Në Ajetin 18:6, Zoti i thotë Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të) të mos shqetësohet kur ata të cilët ai i thërret të besojnë e refuzojnë atë: **“A thua ti, do ta shkatërrosh veten nga hidhërimi pas tyre, nëse ata nuk i besojnë këtij ligjërimi (Kuranit)?”** Një tjetër Ajet (28:56) lexon: **“Është e vërtetë se ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti, por All-llahu udhëzon kë të dojë dhe Ai është që di më së miri për të udhëzuarit.”**

Kjo nënkupton se thirrjet që bën një individ, të gjitha fjalët e këndshme të tij dhe çdo hollësi që ai përdor mund të kenë efekt vetëm me vullnetin e Zotit.

Përgjegjësia e vetme e një besimtari është t’i thërras njerëzit të lexojnë Kuranin. Ai nuk mund të fajësohet për mospranimin e ateistëve për të ndryshuar jetën e tyre, e as me atë se si ata do të fitojnë mundimet e ferrit për veten e tyre. Në Ajetin 2:119, Zoti ynë i tha Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të): **“Ne të dërguam ty me të vërtetën (Kuranin), përgëzues dhe qortues, e ti nuk je përgjegjës për banuesit e Xhehenemit.”**

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

Zoti i ka dhuruar njerëzimit si arsye ashtu edhe vetëdijen. Të dërguarit e Tij dhe librat hyjnor që iu shpallën atyre u kanë treguar rrugën e drejtë dhe njerëzit janë përgjegjës për zgjidhjet e tyre. Morali Islamik mund të jetohet me një vendim të sinqertë për ta jetuar atë – duke ia dorëzuar veten Zotit dhe duke dëgjuar ndërgjegjen e vet, e cila gjithmonë e urdhëron njeriun të bëjë atë që është e drejtë. Është një shkelje e plotë e moralit Islamit të bindet dikush me forcë të besoj, sepse ajo që është e rëndësishme është dorëzimi individual i vetvetes Zotit me gjithë zemër dhe duke besuar sinqerisht. Nëse cilido sistem i obligon njerëzit të besojnë, atëherë ata “të konvertuar” do të bëhen besimtar vetëm prej frikës. E vetmja mënyrë e pranueshme për ta jetuar një fe është brenda një mjedisi që e len ndërgjegjen e njeriut plotësisht të lirë. Këtë Zoti ia shpalli Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) (88:21-26):

E ti pra, këshillo, se je vetëm përkujtues, Ti ndaj tyre nuk je mbizotërues! Përveç atij që zmbraçet e nuk beson, All-llahu atë me vuajtje të mëdha e dënon. Vetëm te Ne kthimin e kanë. Dhe vetëm detyrë Jona është llogaria e tyre.

Vlen të përmendet se Islami i lë njerëzit të lirë të bëjnë zgjidhje sipas dëshirës së tyre dhe i urdhëron ata t'i respektojnë fetë tjera. Madje edhe nëse dikush beson në atë që Kurani e përshkruan si besëtytni, ai prapëprap mund të jetojë në paqe dhe siguri në tokat Myslimane dhe lirisht t'i përmbush obligimet e veta fetare. Në Ajetet 109:2-6, Zoti e urdhëron Profetin tonë (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të) që t'ju thotë atyre që e mohojnë Atë:

Unë nuk adhuroj atë që ju e adhuronit! As ju nuk jeni

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

adhurues të Atij që unë e adhuroj! Dhe unë kurrë nuk do të jem adhurues i asaj që ju adhuroni! Por edhe ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj! Ju keni fenë tuaj (që i përmbaheni), e unë kam fenë time (që i përmbahem)!

Sipas moralit Islam, çdonjëri është i lirë t'i kryej obligimet në përputhje me besimin e vet të veçantë. Askush nuk mund t'i ndalojë të tjerët që t' mos përmbushin obligimet e veta të veçanta fetare, dhe as që mund t'i obligoj ata që të adhurojnë ashtu siç dëshiron ai. Kjo dhunon moralin Islam dhe është e papranueshme për Zotin. Sipas modelit Islamik të shoqërisë çdo njeri është i lirë të adhuroj dhe të përmbush obligimet që e shoqërojnë besimin e veçantë të zgjedhur të tij. Kurani (22:40) i përshkruan manastiret, kishat, sinagogat dhe vendet e adhurimit të Njerëzve të Librit të gjitha nën mbrojtjen e Zotit:

... E sikur All-llahu të mos i zmbapste disa me disa të tjerë, do të rrënoheshin manastiret, kisha, havrat e edhe xhamitë që në to përmendet shumë emri i All-llahut. E All-llahu patjetër do ta ndihmojë atë që ndihmon rrugën e Tij, se All-llahu është shumë i fuqishëm dhe gjithnjë triumfues.

Jeta e Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të) është përplot me shembuj të tillë. Kur të Krishterët erdhën ta vështrojnë atë të falej në xhaminë e tij, ai ua liroj atë që ata ta përdorin. ²¹ Një lloj i tillë i tolerancës u ruajt gjatë kohës së kalifëve të cilët pasuan Profetin (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të). Pasi që u pushtua Damasku, një kishë që ishte shëndrruar në xhami u nda në dy pjesë, në mënyrë që të Krishterët të mund të falen në njëren pjesë dhe Myslimanët në tjetrën. ²²

Islami urdhëron që t'i jepet fund tiranisë

Myslmanët kurrë nuk duhet të qëndrojnë të heshtur përballë tiranisë për të cilën janë dëshmitarë, apo për të cilën madje dëgjojnë prej tjetërkujt. Dhembshuria e tyre që buron prej moralit të Kuranit, i udhëzon ata që t'i kundërvihen çdo lloj tiranie, ligësie dhe shtypjeje, t'i mbrojnë të shtypurit, të nisin luftë idesh në emër të tyre. Pa marr parasysh se a kanë të bëjnë me shokët e tyre më të afërt apo me të huaj me të cilët nuk i bashkon asnjë interes i përbashkët, ata sillen në një mënyrë të përcaktuar për të parandaluar çdo lloj tiranie. Për më tepër, ata e shfrytëzojnë këtë mundësi për të fituar kënaqësinë e Zotit dhe e zbatojnë moralin e Kuranit. Pasi që ndërgjegjja e një besimtari është aq shumë e ndjeshme, dhembshuria e tij kurrë nuk e lejon atë të mbyll sytë qoftë edhe përpara padrejtësisë apo mizorisë më të vogël. Ai do të zërë vendin e tij në pararojë të atij morali duke iu shmangur çfarëdo veprimi që mund të jetë i padrejtë apo që mund të shtyp dikend tjetër. Kurdoherë që ai sheh dikend tjetër të sillet në atë mënyrë, ndërgjegjja e tij nuk e lë rehat derisa t'mos bëj gjithçka është e mundshme për t'i rregulluar gjërat. Dhembshuria e sinqertë nuk lë vend për të harruar tiraninë, për ta shpërfillur apo për të nënvlerësuar atë.

Të paditurit veprojnë rrallëherë derisa tirania të mos qëndroj në pragun e derës së tyre. Kjo buron nga harresa apo mohimi i tyre se në ahiret, ata do të sillen përballë gjitha veprave të tyre të mira dhe të këqija me të cilat u takuan në këtë botë. Por besimtari, i vetëdijshëm për këtë, do të sillet madje edhe me njerëzit plotësisht të panjohur të cilët kurrë më parë s'i ka parë



**E kush ka fjalën më të mirë prej atij
që thërret te All-llahu, vepron,
(punë) të mira dhe thotë: “Unë jam
prej muslimanëve?”
(Kuran, 41:33)**

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)


me dhembshuri të madhe dhe do të përpiqet që t'i shpëtoj ata nga tirania. Madje edhe nëse askush tjetër nuk e përkrah atë, ai do të mbledhë gjithë fuqinë e tij që të parandaloj të ligën. Edhe pse shumica e njerëzve mund të sillen ndryshe, mungesa e ndërgjegjes tek ata kurrë nuk e prek besimtarin e sigurtë. Në ahiret, Myslimanët e dinë se do të japin llogari për atë që kanë bërë për të ndaluar të keqen. Ata s'do të mund të nxirren me arsytetime si: "Nuk e kam parë atë" apo "Nuk kam dëgjuar për këtë" apo "Kurrë nuk e kam ditur se çfarë po ndodhte."

Siç shpallet në Kuran (19:80): **"...e ai (njeriu) ka për të ardhur tek Ne i vetmuar,"** çdo qenie njerëzore do të kthehet te Krijuesi i saj e vetmuar. Njerëzit do të sillen në praninë e Allahut, do të gjykoohen dhe do të japin llogari për veprat e tyre në këtë botë. Vetëm ata të cilët pasuan urdhrat e ndërgjegjes së tyre do të dalin nga kjo marrje në pyetje ashtu si është më së miri. Ata të cilët janë sjellë mirë, që u janë kundërvënë të gjitha formave të mizorisë, që kanë luftuar të keqen dhe që kanë qëndruar në rrugën e Zotit mund të presin shpërblim të merituar. Zoti përmend këtë çështje në një ajet tjetër (2:112):

Nuk është ashtu (si thonë ata), po ai që i është dorëzuar All-llahut dhe është bamirës, ai e ka shpërblimin e vet te Zoti i tij, për ata nuk ka frikë, as nuk kanë pse të mërziten.



**Ë ti pra, këshillo, se je vetëm
përkujtues,
Ti ndaj tyre nuk je mbizotërues!
(Kuran, 88:21-22)**



**Sikur të kishte dashur Zoti yt,
do t'i besonin çka janë në tokë
që të gjithë. A ti do t'i detyrosh
njerëzit të bëhen besimtarë?
(Kuran,10:99)**



**THIRRIA PËR PAQE,
TOLERANCË DHE MORAL
TË DUHUR/TË
VËRTETË NË DHIATËN
E VJETËR DHE
DHIATËN E RE**

Pjesa e mëparshme u mor me thirrjet që Kurani u bën njerëzve për të jetuar në dashuri dhe siguri, që e vë theksin në faktin se Islami është fe e paqes. Sikurse fetë tjera hyjnore, Islami sugjeron një model të shoqërisë së njerëzve të mëshirshëm, të pjekur, të matur, të butë, fisnik, të mirë, dashamirës, besnik, të kuptueshëm, falës dhe tolerant të cilët i shmangen luftimit dhe konfliktit. Ai po ashtu i urdhëron besimtarët të përpiqen që ta vënë në jetë një shoqëri të tillë.

Librat hyjnor të shpallur para Kuranit mund t'u jenë nënshtruar një numri shtrembërimesh, por ato ende përmbajnë pjesë që përputhen me të. Këta libra janë Tevrati dhe Ungjijtë. Sot, edhe pse të përziera me fjalët e njerëzve dhe kështu të shtrembëruara, ato përbëjnë bërthamën e asaj që quhet Bibël. Dy pjesët themelore të Biblës, Dhiata e vjetër dhe Dhiata e re e , bazohen në Tevrat dhe Ungjijtë në mënyrë relative, duke përfshirë shumë libra të tjerë dhe letra. Si Dhiata e vjetër ashtu edhe ajo e re mbështetin dashurinë, paqen dhe tolerancën, dhe po ashtu e ndalojnë terrorin dhe shtypjen/tiraninë. Në këtë pjesë, do të flasim për atë se si Çifutët dhe të Krishterët nga mbarë bota duhet të ndërmarrin veprime në dritën e këtyre urdhrave për t'iu kundërvënë terrorizmit.

Dhiata e vjetër përbëhet nga pesë libra që përfshijnë Tevratin që i është dhënë Profetit Musa (paqja qoftë mbi të), Librin e Psalmeve dhe shkrime tjera nga profetët Çifut dhe tregimet për jetët e tyre. Çifutët besojnë në Dhiatën e vjetër. Të krishterët besojnë po ashtu në Dhiatën e re, përveç Dhiatës së vjetër, e cila

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT



përbëhet prej katër ungjijve, Veprat e Apostujve pas vdekjes së Jezuit (Isait, as), dhe një numër letrash. Mirëpo, sipas Kuranit, librat hyjnor të Biblës u shtrembëruan pasi që iu shpallën njerëzimit. Kjo nënkupton se të dyja Dhiata e vjetër dhe Dhiata e re nuk janë më fjalë e paprishur e Zotit. Ne duhet t'i konsiderojmë ato si libra që përmbajnë elemente hyjnore që përputhen me Kuranin, por gjithashtu edhe gabime të ndryshme njerëzore. Prandaj, kur i shfrytëzojmë/i fusim në përdorim Dhiatën e vjetër dhe Dhiatën e re, duhet ta kemi parasysh nëse përmbajtjet e tyre janë në harmoni me Kuranin.

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

THËNIET NGA DHIATA E VJETËR QË E GJYKOJNË TERRORIN DHE PËRKRAHIN DASHURINË DHE PAQEN

Kërkoni të mirën dhe jo të keqen, që të rroni, dhe kështu Zoti, Perëndia i ushtrive, do të jetë me ju, ashtu si thoni ju. Urreni të keqen, dashuroni të mirën ...

(Amos 5: 14-15)

Siç u theksua/vu në pah më herët, librat hyjnor të zbritur nga Zoti për të udhëzuar robërit e Tij përshkruajnë një shoqëri ideale përplot dashuri, paqe, tolerancë dhe drejtësi. Në Kuran, për shembull, Zoti përshkruan Tevratin që iu shpalli Çifutëve si udhëzim:

Në e zbritëm Tevratin, në të cilin është udhëzimi i drejtë dhe drita. Sipas tij gjykuan ndaj atyre që ishin jehudi, pejgamberët që ishin të bindur, gjykuan edhe dijetarët e devotshëm e paria fetare, ngase ishin të obliguar ta ruanin librin e Allahut dhe ishin mbrojtës të tij... (5:44)

Sot, mund të gjejmë pjesë të urdhrave hyjnor të Tevratit në Dhiatën e vjetër, që i udhëzojnë njerëzit t'i shmangen të keqes, tiranisë, vjedhjes, korrupsionit, të pavërtetës dhe mizorisë dhe të shfaqin moral të vërtetë. Në fakt, Zoti thotë në Kuran se:

Ai (All-llahu) tha: "O Musa, Unë të gradova ty mbi njerëzit me shpalljen Time dhe me të folurit tim. Merr atë që të dhashë dhe bëhu mirënjohës. Dhe i përshkruan atij në pllaka çdo gjë (që i nevojitej), si këshillim dhe sqarim për secilin send. "Merri këto me seriozitet dhe urdhëroje popullin tënd që t'i përvetësojë më të mirat e tyre (dispozitat

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

me shpërblim më të madh). Unë do t'ua tregoj vendbanimin mëkatarëve. (7:144-145)

TË GJITHA FORMAT E DHUNËS DHE TIRANISË

JANË TË NDALUARA

Dhiata e vjetër përshkruan në mënyrë të konsiderueshme fatin që i pret ata të cilët bëjnë mëkate dhe duan ta përhapin të keqen dhe i paralajmëron njerëzit që të mos pasojnë atë rrugë. Xhindosja dhe dëmtimi i tjerëve, duke u përpjekur që t'i largojnë ata nga rruga e drejtë, gjakderdhja dhe grindja të gjitha përshkruhen si mënyra të sjelljes me të cilat Zoti nuk është i kënaqur, të cilat Ai i ka ndaluar. Ai i dënon të gjithë ata që ndjekin rrugën e së keqes dhe shtypjes, duke shpallur se të tillët kurrë nduk do të jenë të shpëtuar. Disa tregime të Dhiatës së vjetër e vënë këtë në pah:

Simeoni dhe Levi janë vëllezër; shpatat e tyre janë vegla dhune. Mos hyftë shpirti im në mendjen e tyre, lavdia ime mos u bashkoftë me kuvendin e tyre! Sepse në mërinë e tyre kanë vrarë njerëz, në kryeneçësinë e tyre u kanë prerë leqet e këmbëve demave. Mallkuar qoftë mëria e tyre, sepse ka qenë e egër, dhe tërbimi i tyre sepse ka qenë mizor! Unë do t'i ndaj te Jakobi dhe do t'i shpërndaj te Izraeli. (Zanafilla 49: 5-7)

Por të pabesët janë si deti i trazuar, që nuk mund të qetësohet dhe ujërat e të cilit vjellin llucë dhe baltë. "Nuk ka paqe për të pabesët", thotë Perëndia im. (Isaia 57: 20-21)

Dëgjoni fjalën e Zotit, o bij të Izraelit, sepse Zoti ka një

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)



konflikt me banorët e vendit: “Nuk ka në fakt as sinqeritet, as mëshirë dhe as njohje të Perëndisë në vend. Nuk bëhet tjetër përveç shpërbetimeve, gënjeshtreve, vrasjeve, vjedhjeve, shkeljeve të kurorës, shkeljeve të çdo kufizimi dhe derdhet gjak mbi gjak. Për këtë shkak vendi do të jetë në zi dhe tërë banorët e tij do të vuajnë, bashkë me kafshët e fushës dhe me shpendët e qiellit; madje edhe peshqit e detit do të eliminohen. Megjithatë askush të mos kundërshtojë, askush të mos qortojë tjetrin, sepse populli yt është si ai që grindet me priftin. (Osea 4: 1-4)

Galaadi është një qytet keqbërësish dhe i përlyer me gjak. Ashtu si bandat e cubave rrinë në pritë për një njeri, kështu një turmë priftërinjsh masakron në rrugën e Sikemit, kryen gjëra të kobshme. (Osea 6: 8-9)

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

Njeriu i mëshirshëm i bën të mirë vetes, kurse njeriu mizor mundon mishin e tij. I pabesi realizon një fitim të rremë, por ai që mbjell drejtësi do të ketë një shpërblim të sigurt Ashtu si drejtësia të çon në jetë, kështu ai që shkon pas të keqes gjen vdekjen Të çoroditurit nga zemra janë të neveritur për Zotin, por ata që janë të ndershëm në sjelljen e tyre pëlqehen nga Edhe kur i shtrëngon dorën një tjetri për një besëlidhje, njeriu i keq nuk do të mbetet i pandëshkuar, por pasardhësit e të drejtëve do të shpëtojnë. (Fjalët e urta 11: 17-21)




Njeriu i keq kurdis të keqen dhe mbi buzët e tij ka si një zjarr të ndezur. Njeriu i çoroditur mbjell grindje dhe ai që shpif përçan miqtë më të mirë. Njeriu i dhunës e josh shokun e vet dhe e çon nëpër një rrugë jo të mirë. Kush mbyll sytë për të kurdisur gjëra të këqija, kafshon buzët kur shkakton të keqen. Flokët e bardha janë një kurorë lavdie; atë e gjejmë në rrugën e drejtësisë. Kush nuk zemërohet shpejt vlen më tepër se një luftëtar i fortë, dhe ai që e urdhëron frymën e tij vlen më tepër se ai që mposht një qytet. (Fjalët e urta 16: 27-32)

Zoti u rri larg të pabesëve, por dëgjon lutjet e të drejtëve. (Fjalët e urta 15: 29)

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

Dhiata e vjetër përshkruan në mënyrë të konsiderueshme veprat e njerëzve të cilët bënë keq dhe u sollën me tirani, duke e bërë të qartë se të ligët do të fitojnë atë që meritojnë. Por ajo po ashtu thotë se ata të cilët pendohen do të pranohen si të mirë, nëse veprojnë në përputhje me fenë e Zotit:

Në rast se i pabesi largohet nga të gjitha mëkatet që kryente, në rast se respekton të gjitha statutet e mija dhe zbaton barazinë dhe drejtësinë, ai me siguri ka për të jetuar; nuk ka për të vdekur. Asnjë nga shkelje që ka kryer nuk do t'i kujtohet atij; ai do të jetojë për shkak të drejtësisë që zbaton. A ndjej vallë gëzim nga vdekja e të pabesit?", thotë Zoti, Zoti, "apo përkundrazi që ai të kthehet nga rrugët e tij dhe të jetojë? Por në rast se i drejti largohet nga drejtësia e tij dhe kryen paudhësinë dhe imiton tërë gjërat e neveritshme që kryen i pabesi, a do të jetojë vallë ai? Në rast se tërë drejtësia që ka bërë nuk do të kujtohet më; për shkeljen që ka kryer dhe mëkatet që ka bërë, ai ka për të vdekur, për shkak të tyre. Megjithatë ju thoni: "Rruga e Zotit nuk është e drejtë". Dëgjoni tani, o shtëpi e Izraelit: është pikërisht rruga ime që nuk është e drejtë ose janë më tepër rrugët tuaja që nuk janë të drejta? Në rast se i drejti largohet nga drejtësia e tij dhe kryen paudhësi dhe për këtë shkak vdes, ai vdes nga paudhësia që ka kryer. Përkundrazi, në se i pabesi largohet nga pabesia që ndiqte dhe zbaton barazinë dhe drejtësinë, ai do ta shpëtojë shpirtin e tij. Duke qenë se ka marrë parasysh të largohet nga të gjitha shkeljet që kryente, ai ka për të jetuar me siguri; nuk ka për të vdekur. Megjithatë shtëpia e



**Ai ta zbret ty (Muhammed) librin
me argument që është vërtetues i
librave të mëparshme. Ai e zbriti më
parë Tevratin dhe Inxhilin.**

**Udhërrëfim për njerëz, e zbriti edhe
Furkanin (dalluesin e së vërtetës
nga gënjeshtër). S'ka dyshim se ata
që mohojnë argumentet e All-llahut
i pret ndëshkimi i rreptë. All-llahu
është ngadhënjes, shpagimtar.**

(Koran 3:3-4)

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

Izraelit thotë: “Rruga e Zotit nuk është e drejtë”. A janë pikërisht rrugët e mia që nuk janë të drejta, o shtëpi e Izraelit, janë më tepër rrugët tuaja që nuk janë të drejta? Prandaj do ta gjykoj secilin prej jush sipas rrugëve të tij, o shtëpi e Izraelit”, thotë Zoti, Zoti. “Pendohuni dhe braktisni tërë shkeljet tuaja, kështu paudhësia nuk do të jetë më për ju shkak shkatërrimi. Flakni larg jush tërë shkeljet tuaja që keni kryer dhe bëjini vetes një zemër të re dhe një shpirt të ri. Pse vallë doni të vdisni, o shtëpi e Izraelit? Unë në fakt nuk ndjej asnjë kënaqësi me vdekjen e atij që vdes” thotë Zoti, Zoti. “Ndërroni rrugë, pra, dhe do të jetoni”. (Ezekieli 18: 21-32)

... Kështu thotë Zoti: “Ja, unë kam përgatitur kundër jush të keqen dhe një plan kundër jush. Tani le të heqë dorë secili nga e keqja.” Por ata thonë: “Është e kotë; ne duam të ecim duke ndjekur mendimet tona dhe dëshirojmë të veprojmë sipas kryeneçësisë së zemrës sonë të keqe.” (Jeremia 18: 11-12)

“Mos u bëni si etërit tuaj, të cilëve profetët e së kaluarës u kanë shpallur, duke thënë: “Kështu thotë Zoti i ushtrive: Konvertojuni nga rrugët tuaja të këqija dhe nga veprat tuaja të këqija”. Por ata nuk dëgjuan dhe nuk më kushtuan vëmendje”, thotë Zoti. (Zakaria 1: 4)

ËSHTË E NDALUAR TË DËMTOHEN TË TJERËT

Shumë urdhra të Dhiatës së vjetër ndalojnë që të tjerëve tu shkaktohet dëm, vrasjen, sundimin pa drejtësi apo sjelljen

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

e padrejtë. Nuk do të vrasësh. Nuk do të shkelësh besnikërinë bashkëshortore. Nuk do të vjedhësh. Nuk do të bësh dëshmi të rreme kundër të afërmit tënd. Nuk do të dëshirosh shtëpinë e të afërmit tënd...” (Eksodi 20: 13-17)

Nuk do të bësh padrejtësi gjatë gjykimit ... as do të nderosh personat e fuqishëm; por do të gjykosh të afërmin tënd me drejtësi. Nuk do të shkosh e të sillesh duke shpifur nëpër popullin tënd, as do të mbash qëndrim kundër jetës të të afërmit tënd. Unë jam Zoti. Nuk do të urresh vëllanë tënd në zemrën tënde; qorto gjithashtu fqinjin tënd, por mos u ngarko me asnjë mëkat për shkak të tij. Nuk do të hakmerresh dhe nuk do të mbash mëri kundër bijve të popullit tënd, por do ta duash të afërmin tënd si veten tënde. Unë jam Zoti. (Levitiku 19: 15-18)

Me qëllim që të mos derdhet gjak i pafajshëm në mes të vendit që Zoti, Perëndia yt, të jep si trashëgimi dhe ti të mos bëhesh fajtor për vrasje. (Ligji i Përtërirë 19: 10)

Çliro ata që i tërheqin drejt vdekjes dhe mbaji ata që po i çojnë në thetore. Po të thuash: “Ja, ne nuk e dinim”, ai që peshon zemrat a nuk e shikon? Ai që ruan shpirtin tënd nuk e di

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

vallë? Ai do t'i japë secilit sipas veprave të tij. (Fjalët e urta 24: 11-12)

TË JESH I MIRË NDAJ TË TJERËVE

Dhiata e vjetër përmban një numër thëniesh që urdhërojnë vëllazërinë dhe dashurinë, flijimin dhe përuljen. Mu sikurse Myslimanët, Çifutët dhe të Krishterët janë urdhëruar të sillen mirë me të tjerët, të bëjnë vepra të mira, kurrë të mos devijojnë nga rruga e drejtësisë dhe të kenë sjellje të butë, të jenë tolerant dhe falës. Disa shembuj përfshijnë:

Mbillni për vete sipas drejtësisë, korrni sipas dhembshurisë, lëroni arën tuaj të lënë djerrë, sepse është koha për të kërkuar Zotin, derisa ai të vijë dhe përhapë mbi ju drejtësinë. Ju keni lëruar ligësinë, keni korrur paudhësinë, keni ngrënë frytin e gënjeshtërs. Duke qenë se ti u ke besuar rrugëve të tua, në turmën e trimave të tu, (Osea 10: 12-13)

Ata e urrejnë atë që i qorton te porta dhe kanë neveri për ata që flasin me ndershmëri. Pastaj, duke qenë se keni shtypur të varfrin dhe kërkonit prej tij taksa në grurë, megjithëse keni ndërtuar shtëpi prej guri të palatuar, nuk do të banoni në to; keni mbjellë vreshta të mrekullueshme, por nuk do ta pini verën e tyre. Unë, pra, njoh sa të shumta janë shkeljet



VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

tuaja dhe sa të rënda janë mëkatet tuaja; ju shtypni të drejtin, pranoni dhurata dhe u bëni padrejtësi të varfërve në gjyq. Prandaj njeriu i matur në këtë kohë do të heshtë, sepse koha është e keqe. Kërkoni të mirën dhe jo të keqen, që të rroni, dhe kështu Zoti, Perëndia i ushtrive, do të jetë me ju, ashtu si thoni ju. Urreni të keqen, dashuroni të mirën dhe vendosni mirë drejtësinë në gjyq... (Amosi 5: 10-15)


NJERËZIT THIRREN TË KENË SJELLJE TË MIRË

O njeri, ai të ka bërë të njohur atë që është e mirë; dhe çfarë tjetër kërkon Zoti nga ti, përveç se të zbatosh drejtësinë, të duash mëshirën dhe të ecësh përulësisht me Perëndinë tënd? (Mikea 6: 8)

Deri kur do të gjykoni padrejtësisht dhe do të mbani anët e të pabesëve? (Sela) Mbroni të dobëtin dhe jetimin, sigurojini drejtësi të vuajturit dhe të varfrit. Çlironi të mjerin dhe nevojtarin; shpëtojeni nga dora e të pabesit. (Psalmet 82: 2-4)

Njerëzit e drejtë udhëhiqen nga ndershmeria, por ligësia e të pabesëve do t'i shkatërrojë këta. Pasuritë nuk sjellin dobi ditën e zemërimit, por drejtësia të shpëton nga vdekja. Drejtësia e njeriut të ndershëm i hap rrugën, por i pabesi bie për shkak të paudhësisë së tij. Drejtësia e njerëzve të drejtë

**Just like Christians and Moslems,
Jews have a duty to behave well
towards others and to do good.**



VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

i çliron këta, por njerëzit e pabesë do të kapen nga vetë ligësia e tyre. (Fjalët e urta 11: 3-6)

Dëshira e të drejtëve është vetëm e mira, por shpresa e të pabesëve është zemërimi. (Fjalët e urta 11: 23)

Kush kërkon me zell të mirën fiton dashamirësinë, por ai që kërkon të keqen, kjo do t'i bjerë mbi të. (Fjalët e urta 11: 27)

Rruga e të pabesit është një neveri për Zotin, por ai do atë që ndjek drejtësinë. (Fjalët e urta 15: 9)

Me mirësinë dhe me të vërtetën padrejtësia shlyhet, dhe me frikën e Zotit njeriu largohet nga e keqja. Kur Zotit i pëlqejnë rrugët e një njeriu, ai bën që edhe armiqtë e tij të bëjnë paqe me të. Më mirë të kesh pak me drejtësi, se sa të ardhura të mëdha pa drejtësi. (Fjalët e urta 16: 6-8)

Rruga kryesore e njerëzve të drejtë është të evitojnë të keqen... (Fjalët e urta 16: 17)

Mos i ki zili njerëzit e këqij dhe mos dëshiro të rrish me ta, sepse zemra e tyre mendon për grabitje dhe buzët e tyre thonë se do të bëjnë të keqen. (Fjalët e urta 24: 1-2)

O i pabesë, mos ngre kurthe kundër banesës së njeriut të drejtë, mos shkatërro vendin ku ai pushon, sepse i drejti bie shtatë herë dhe ngrihet, kurse të pabesët përmbysen në fatkeqësi. Kur armiku yt bie, mos u gëzo; kur është shtrirë për tokë, zemra jote të mos gëzohet, me qëllim që Zoti të mos shikojë dhe të mos i vijë keq, dhe të mos largojë prej tij zemërimin e vet. Mos u zemëro për shkak të atyre që bëjnë të keqen dhe mos i ki smirë të pabesët, sepse nuk do të ketë të ardhme për të keqin... (Fjalët e urta 24: 15-20)

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

NJERIU URDHËROHET TË JETË NË ANËN E PAQES

Mu sikurse Myslimanët, Çifutët dhe të Krishterët urdhërohen t'i shmangen luftës dhe në veçanti, të vendosin paqen. Libri *Hristiyan Ahlaki* (Morali i Krishterë) përshkruan sjelljen që duhet ta shfaq një i Krishterë, në pajtim me Dhiatën e vjetër dhe të re dhe përmbledh këtë pozitë me këto fjalë: "Konfliktet e përmendura në Librin e Shenjtë janë për qëllime vetëmbrojtëse." ²³ Është e ndaluar t'u shkaktohet dëm atyre që nuk luftojnë, si fëmijëve në rast lufte.

Sa filloi të ushtrojë një kontroll të rreptë mbi mbretërinë, ai i vrau shërbëtorët e tij që kishin vrarë të atin, mbretin; por nuk vrau bijtë e vrasësve, sipas asaj që është shkruar në librin e ligjit të Moisiut, në të cilin Zoti ka urdhëruar duke thënë: "Etërit nuk do të dënohen me vdekje për bijtë e tyre, as bijtë nuk do të vriten për etërit e tyre; secili do të dënohet me vdekje për mëkatin e vet". (2 i Mbretërve 14: 5-6)

KUR TË MBISUNDOJË MORALI I FESË, SIPAS DHIATËS SË VJETËR

Në të njëjtën mënyrë sikurse Islami, Judaizmi dhe Krishterimi sugjerojnë një model shembullor për shoqërinë. Me besimin e tyre të fortë, moralin e drejtë dhe besnikërinë e përpiktë ndaj vargjeve të Tij, të dërguarit të cilët Zoti i dërgoi si udhërrëfyes




VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

për Njeriun janë shembujt më të mirë. Për këtë arsye, është më se e rëndësishme për besimtarët të përpiqen të përvetësojnë moralin e profetëve si të tyre dhe të jetojnë ngjashëm me ta. Po të mund të përhapet morali i vërtetë i fesë në mbarë njerëzimin, ambienti që do të rezultojë nga kjo do të jetë shumë i përafërt me parajsën. Në një shoqëri të tillë, ankthet e anarkisë dhe terrorit do të zhduken. Besnikëria e përpiktë ndaj urdhrave të Zotit, ata të cilët ia kanë frikën dhe besojnë në Të do t'ju shmangen energjikisht të gjitha formave të ligësisë dhe keqberjes. Bota do të fillojë të mbushet me paqe dhe tolerancë, me njerëz të matur dhe të kuptueshëm. Dhiata e vjetër pasqyron me një numër shembujsh mënyrën e jetës, kur morali i fesë të mbisundojë:

Atëherë i drejti do të banojë në shkretëtirë dhe drejtësia do të banojë në pemishte. Pajojë e drejtësisë do të jetë paqja, rezultat i drejtësisë qetësia dhe siguria përjetë. Populli im do të banojë në një vend paqeje, në banesa të sigurta dhe në vende të qeta pushimi, (Isaia 32: 16-18)

Shkretëtira dhe toka e thatë do të gëzohen, vetmia do të gëzohet dhe do të lulëzojë si trëndafili; do të lulëzojë shumë dhe do të ngazëllojë me hare dhe britma gëzimi. Do t'u jepet lavdia e Libanit, madhështia e Karmelit dhe e Sharonit. Ata do të shohin lavdinë e Zotit, madhësinë e Perëndisë tonë. Forconi duart e dobësuara, bëjini të qëndrueshëm gjunjët e pasigurt! U thoni atyre që e kanë humbur zemrën: "Bëhuni të fortë, mos kini frikë!"... Atëherë do të hapen sytë e të verbërve dhe veshët e të shurdhëve; atëherë çalamani do të kërcejë si një dre dhe gjuha e memecit do të bërtasë nga

**Nëse publikoni ndonjë të mirë,
ose e fshihni, ose i falni ndonjë
të keqe (dikujt), All-llahu i
plotfuqishëm falë shumë.
(Koran, 4:149)**




VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

gëzimi, sepse do të dalin ujëra në shkretëtirë dhe përrenj në vendin e vetmuar. (Isaia 35: 1-6)

Ai që ecën me drejtësi dhe flet drejt, ai që i përçmon fitimet e shtrembra, që lëviz duart për të mos pranuar dhurata, që i mbyll veshët për të mos dëgjuar të flitet për gjak dhe sytë për të mos parë të keqen, ai do të banojë në vende të larta, shkëmbinjtë e fortifikuar do të jenë streha e tij, buka e tij do t'i jepet, uji i tij do t'i sigurohet. (Isaia 33: 15-16)

... Të thyesh zinxhirët e ligësisë, të zgjidhësh verigat e zgjedhës, t'i lësh të lirë të shtypurit, të dërmosh çdo zgjedhë? A nuk konsiston vallë në ndarjen e bukës sate me atë që ka uri, në sjelljen në shtëpinë tënde të të varfrit pa strehë, në të veshurit e atij që është lakuriq, pa lënë pas dore ata që janë nga gjaku yt? Atëherë drita jote do të shpërthejë si agimi dhe shërimi yt do të mbijë menjëherë, drejtësia jote do të të pararendë dhe lavdia e Zotit do të jetë praparoja jote. Atëherë do të thërrasësh dhe Zoti do të të përgjigjet, do të bërtasësh dhe ai do të thotë: "Ja ku jam!". Në rast se ti heq dorë nga zgjedha, tregimi me gisht dhe të folurit mbrapsht, në rast se plotëson nevojat e të uriturit dhe ngop shpirtin e pikëlluar, atëherë drita jote do të lindë nga terri dhe terri yt do të jetë si mesdita. (Isaia 58: 6-10)

Jews, Christians and Muslims who live by Allah's morality are enforced to live in peace and security.



KËSHILLAT E DHIA TËS SË RE PËR NJË BOTË ME DASHURI DHE

"...Duaje Zotin, Perëndinë tënde me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde". Ky është urdhërimi i parë dhe i madhi. Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: "Duaje të afërmin tënd porsì vetveten". (Mateu 22: 37-39)

Dhiata e re e krishterë po ashtu përmban shumë pjesë që e ndalojnë të keqen dhe shtypjen/tiraninë. Njerëzit thirren të jenë falës, paqësor, tolerant dhe që lëshojnë pe gjithmonë. Për këto arsye, Krishterimi pret prej njerëzve që të kenë mirëkuptim dhe të jenë të lumtur dhe të përmbahen nga konflikti. Të Krishterët të cilët veprojnë në përputhje me urdhrat e shpallura nga Profeti Jezus (paqja qoftë mbi të) dhe të cilët e pranojnë moralin e tij si të vetin përshkruhen me këto fjalë në Kuran (57:27):

Pastaj vazhduam pas tyre me të dërguarit Tonë, e pas tyre dërguam Isain të birin e Merjemes dhe atij i dhamë Inxhillin, e në zemrat e ithtarëve të tij dhuruam butësi e mëshirë...

Në një ajet tjetër (5:82), Zoti thotë: **Gjithqysh ti do të vëresh se jehuditë dhe ata që i përshkruan Zotit shok (idhujtarët) janë njerëzit me armiçësi të fortë kundër besimtarëve (kundër myslimanëve). Ndërsa do të vëresh se më të afërmit si miq për besimtarët thanë: "Ne jemi nesara-të krishterë". Këtë ngase prej tyre (të krishterëve) ka dijetarë (ulema) dhe të devotshëm, dhe se ata nuk janë kryeneçë, dhe i lavdëron të Krishterët të cilët i drejtohen Zotit me zemër të sinqertë.**


Ky moral pozitiv i të Krishterëve bazohet në urdhrat në Bibël. Ata këshillohen që të keqen ta kthejnë me të mirë, t'i duan

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

të afërmit e tyre në mënyrë të pakushtëzuar dhe t'ju ndihmojnë atyre që kanë nevojë në mënyrë të njëjtë. Në fakt, Dhiata e re përdor një fjalë të posaçme për “dashurinë e pakushtëzuar” që besimtarët e ndiejnë për Zotin tonë dhe për besimtarët. Një vepër që merret me Krishterimin pasqyron këtë gjendje me këto fjalë:

Fjala agape është përdorur 116 herë në 105 vargje të Dhiatës së re. Ajo është një formë shumë e lartë e dashurisë. Ndërmarrjet agape nënkuptojnë thjeshtë “Ndërmarrjet e dashurisë.” Shërbesa jonë arrin tek ata të cilët kanë nevojë, dhe s'kanë mundësi për ta kthyer borxhin.²⁴

Një numër i fragmenteve nga Dhiata e re urdhëron njerëzit t'i shmangen të keqes dhe gjakderdhjes dhe i inkurajon ata të shfaqin moral të vërtetë.



VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

DASHURIA DHE DHEMBSHURIA E PAKUSHTËZUAR

Po ju jap një urdhërim të ri: ta doni njëri-tjetrin; sikurse unë ju kam dashur, ashtu edhe ju ta doni njëri-tjetrin. (Gjon 13: 34)

Dashuria le të mos jetë me hipokrizi; urreni të keqen dhe ngjituni pas së mirës. Duani njeri tjetrin me dashuri vëllazërore; në nderim tregoni kujdes njeri me tjetrin. Mos u tregoni të përtuar në zell; jini të zjarrtë në frymë, shërbeni Perëndisë, të gëzuar në shpresë, të qëndrueshëm në shtrengime, këmbëngulës në lutje; ndihmoni për nevojat e shenjtoreve, jini mikpritës. Bekoni ata që ju përndjekin, beconi dhe mos mallkoni. (Romakët 12: 9-14)

Mos i kini asnjë detyrim askujt, përveç se ta doni njëri-tjetrin, sepse ai që e do tjetrin e tij e ka përmbushur ligjin. Sepse urdhërimet: "Mos shkel kurorë, mos vrajë, mos vidh, mos thua dëshmi të rreme, mos lakmo", dhe në pastë ndonjë urdhërim tjetër, përmbliidhen në këtë fjalë: "Duaje të afërmin tënd porsì vetveten! ". Dashuria nuk i bën keq të afërmit; dashuria, pra, është përmbushja e ligjit. (Romakët 13: 8-10)

Dhe Zoti shtoftë dhe teproftë në dashurinë për njeri tjetrin dhe për të gjithë, ashtu si edhe ne ndaj jush, (1 e Thesalonikasve 3: 12)

Vërtet, ata që besuan, ata që ishin jehudi, krishterët sabejët, (kishun lëshuar fenë e adhuronin engjëjt), kush besoi prej tyre (sinqerisht) All-llahun, dhe botën tjetër dhe bëri vepra të mira, ata e kanë shpërblimin te Zoti i tyre. Për ta nuk ka frikë as nuk kanë përse të pikëllohen (pasi që besuan All-llahun, librat të dërguarit në mesin e të cileve edhe Muhammedin).komen, noch zullen zij treuren.

(Koran, 2:62)



VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

Atëherë një nga skribët që e kishte dëgjuar diskutimin e tyre, duke kuptuar se ai u ishte përgjigjur mirë, iu afrua dhe e pyeti: “Cili është i pari i të gjithë urdhërimeve? “. Dhe Jezusi u përgjigj: “Urdhërimi i parë i të gjithëve është: “Dëgjo, o Izrael: Zoti, Perëndia ynë, është i vetmi Zot”, dhe: “Duaje Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd, me gjithë mendjen tënde e me gjithë forcën tënde!”. Ky është i pari urdhërim. Dhe i dyti i ngjan këtij: “Duaje të afërmin tënd porsì vetveten”. Nuk ka urdhërim tjetër më të madh se këta.

Atëherë skribi i tha: “Mirë, Mësues. The, sipas së vërtetës, se ka vetëm një Perëndi dhe s`ka asnjë tjetër përveç tij; dhe ta duash me gjithë zemër, me gjithë mendje, me gjithë shpirt dhe me gjithë forcë, dhe ta duash të afërmin porsì vetvetja vlen më tepër se sa gjithë holokaustet dhe flijimet”. (Marku 12: 28-33)

Mbasi të pastroni shpirtat tuaj me bindjen ndaj së vërtetës me anë të Frymës, për të pasur një dashuri vëllazërore pa hipokrizi, të doni fort njeri tjetrin me zemër të pastër, (1 e Pjetrit 1: 22)

Dhe më në fund jini të gjithë të një mendjeje, të dhembshur, plot dashuri vëllazërore, të mëshirshëm dhe dashamirës, pa e kthyer të keqen me të keqe ose fyerjen me fyerje, po, përkundrazi, bekoni, duke e ditur se për këtë u thirrët, që të trashëgoni bekimin. Sepse “kush don ta dojë jetën dhe të shohë ditë të mira, le ta ruajë gojën e tij nga e keqja dhe buzët e tij nga të folurit me mashtrim; (1 e Pjetrit 3: 8-10)

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)



Dhe të keni para së gjithash një dashuri të madhe për njeri tjetrin, sepse “dashuria do të mbulojë një shumicë mëkatesh”. Jini mikpritës njëri për tjetrin, pa murmuritje. Gjithsecili le ta vërë në shërbim të tjetrit dhuntinë që ka marrë, si kujdestarë të mirë të hirit të shumëfarshëm të Perëndisë. (1 e Pjetrit 4: 8-10)

TA DUASH ARMIKUN TËND

Ju keni dëgjuar se qe thënë: “Duaje të afërmin tënd dhe urreje armikun tënd”. Por unë po ju them: “Duani armiqtë tuaj, bekoni ata që ju mallkojnë, u bëni të mirë atyre që ju urrejnë, dhe lutuni për ata që ju keqtrajtojnë dhe ju përndjekin, (Mateu 5: 43-44)

Por unë po ju them juve që më dëgjoni: “T’i doni armiqtë tuaj; u bëni të mirë atyre që ju urrejnë. Bekoni ata që ju

VETËM DASHURIA MUND T'Ë SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT


mallkojnë dhe lutuni për ata që ju keqtrajtojnë. Nëse dikush të bie në njëren faqe, ktheja edhe tjetrën; dhe atij që të merr mantelin, mos e pengo të të marrë edhe tunikën. Jepi kujtdo që kërkon prej teje; dhe në se dikush merr gjënë tënde, mos kërko të ta kthejë. Por, ashtu siç dëshironi që t'ju bëjnë juve njerëzit, po ashtu bëni me ta. Por po t'i doni ata që ju duan, ç'meritë do të keni nga kjo? Sepse edhe mëkatarët i duan ata që i duan. Dhe në se u bëni të mirë atyre që ju bëjnë të mirë, çfarë merite do të keni nga kjo? Të njëjtën gjë bëjnë edhe mëkatarët. Dhe nëse u jepni hua atyre që shpresoni t'ju kthejnë, çfarë merite do të keni nga kjo? Edhe mëkatarët u japin hua mëkatarëve, që t'u kthehet aq sa dhanë. Por ju t'i doni armiqtë tuaj, bëni të mirë dhe jepni hua pa pasur shpresë për asgjë, dhe shpërblimi juaj do të jetë i madh... “ (Luka 6: 27-35)

NJË MORAL I VËRTETË

“Lum ata që janë të mëshirshëm, sepse ata do të gjejnë mëshirë. Lum ata që janë të pastër në zemër, sepse ata do ta shohin Perëndinë. Lum ata që përpiqen për paqen... “ (Mateu 5: 7-9)

“Mos gjykoni dhe nuk do të gjykoheni; mos dënoni dhe nuk do të dënoheni; falni dhe do të jeni të falur. Jepni dhe do t'ju jepet: një masë e mirë, e ngjeshur, e tundur, gufuese do t'ju derdhet në gj, sepse me atë masë që do të matni, do t'ju matet edhe juve gjithashtu. “ (Luka 6: 37-38)

Po pse ti e shikon lëmishten në sy të vëllait tënd dhe nuk e



**O ju që besuat! Mos i merrni për miq
ata të cilëve u është dhënë libri para
jush edhe as jobesimtarët që me fenë
tuaj tallen dhe luajnë. Keni dro
All-llahun po që se jeni besimtarë.
(Koran, 5:57)**

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

shih traun në syrin tënd? Ose, si mund t'i thuash vëllait tënd: "Vëlla, më lër të të heq lëmishTEN që ke në syrin tënd", kur ti vetë nuk e shih traun në syrin tënd? O hipokrit, nxirre më parë traun nga syri yt dhe atëherë do të mund të shohësh mirë për të nxjerrë lëmishTEN nga syri i vëllait tënd. (Luka 6: 41-42)

Pra, si të zgjedhur të Perëndisë, shenjtore dhe të dashur, me dhembshuri të brendshme, mirësinë, përlësinë, zemërbutesinë dhe me durimin, duke duruar njeri tjetrin dhe duke falur njeri tjetrin, në qoftë se dikush ankohet kundër një tjetri; dhe sikundër Krishti ju ka falur, ashtu bëni edhe ju. Dhe, përmbi të gjitha këto gjëra, vishni dashurinë, që është lidhja e përsosmërisë. (Kolozianët 3: 12-14)

Së fundi, vëllezër, të gjitha gjërat që janë të vërteta, të gjitha gjërat që janë të ndershme, të gjitha gjërat që janë të drejta, të gjitha gjërat që janë të pastra, të gjitha gjërat që janë të dashura, të gjitha gjërat që janë me famë të mirë, nëse ka ndonjë virtyt dhe nëse ka ndonjë lëvdim, këto mendoni. (Filipianët 4: 8)

"... Perëndia u kundërvihet mendjemëdhenjve dhe u jep hir të përlurve`. Nënshtroni, pra, Perëndisë, kundërshtoni djallin dhe ai do të largohet nga ju! Afrohuni te Perëndia dhe ai do t'ju afrohet juve; pastroni duart tuaja, o mëkatarë; dhe pastroni zemrat o njerëz me dy mendje! Pikëllohuni, mbani zi dhe qani; të qeshurit tuaj le të kthehet në zi, dhe gëzimi në trishtim. Përluni përpara Zotit, dhe ai do t'ju lartësojë! Mos flisni keq për njeri tjetrin, vëllezër; ai që flet kundër

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

vëllait dhe e gjykon vëllanë e vet, flet kundër ligjit dhe gjykon ligjin; dhe, po të gjykos ligjin, ti nuk je zbatues i ligjit, por gjykatës. Ka vetëm një Ligjdhënës, që mund të të shpëtojë ose të të çojë në humbje; por ti kush je që gjykon një tjetër? (Jakobi 4: 6-12)

T'I NDIHMOSH ATA QË KANË NEVOJË DHE TË BËSH VEPRA TË MIRA

“Sepse nuk ka pemë të mirë që të japë fryt të keq, as pemë të keqe që të japë fryt të mirë. Çdo pemë, pra, njihet nga fryti i vet, sepse nuk mblidhen fiq nga gjembat dhe nuk vilet rrush nga ferra. Njeriu i mirë e nxjerr të mirën nga thesari i mirë i zemrës së vet; dhe njeriu i mbrapshtë e nxjerr të mbrapshta nga thesari i keq i zemrës së vet, sepse goja e njërit flet nga mbushullia e zemrës.” (Luka 6: 43-45)

Dhe sa për ju, o vëllezër, mos u lodhni së bëri të mirën. Dhe në qoftë se dikush nuk i bindet fjalës sonë në këtë letër, shënojeni atë dhe mos u shoqëroni me të, që ai të turpërohet. Por mos e mbani atë si një armik, po këshillojeni si vëlla. (2 e Thesalonikasve 3: 13-15)

Dhe turmat e pyesnin, duke thënë: “Dhe ne, pra, ç` të bëjmë?”. Atëherë ai, duke përgjigjur, u tha atyre: “Ai që ka dy tunika le t`i ndajë me atë që s`ka, dhe ai që ka të hajë le të veprojë po kështu”. Tani erdhën edhe disa tagrambledhës që të pagëzohen dhe e pyetën: “Mësues, ç` duhet të bëjmë?”. Dhe ai u tha atyre: “Mos vilni asgjë më tepër nga sa ju është

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT



urdhëruar`. Edhe ushtarët e pyetën duke thënë: ``Dhe ne, ç` duhet të bëjmë?``. Dhe ai u tha atyre: ``Mos i bëni shantazh asnjëri, mos i bëni akuza të rreme kurrkujt dhe jini të kënaqur me pagën tuaj!``. (Luka 3: 10-14)

Dhe në çdo gjë ju kam treguar se, duke u munduar në këtë mënyrë, duhet të ndihmohen të lëngatët dhe të kujtohen fjalët e Zotit Jezus, i cili tha: "Ka më shumë lumturi të japësh sesa të marrësh!"`. (Veprat e Apostujve 20: 35)

Nëse kemi shërbim, le t`i kushtohemi shërbimit; po kështu mësuesi të jepet pas mësimit; dhe ai që nxit, le t`i kushtohet nxitjes; ai që ndan, le ta bëjë me thjeshtësi; ai që kryeson le të kryesojë me zell; ai që bën vepra mëshirë, le t`i bëjë me gëzim. (Romakët 12: 7-8)

Sepse ky është vullneti i Perëndisë, që ju, duke bërë mirë, t`ia mbyllni gojën paditurisë së njerëzve të pamend. Silluni si njerëz të lirë, por jo duke përdorur lirinë si një pretekst për të mbuluar ligësinë, por si shërbëtorë të Perëndisë. Nderoni të gjithë, doni vëllazërinë, druani Perëndinë, nderoni mbretin. (1 e Pjetrit 2: 15-17)

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

Sepse “kush don ta dojë jetën dhe të shohë ditë të mira, le ta ruajë gojën e tij nga e keqja dhe buzët e tij nga të folurit me mashtrim; të largohet nga e keqja dhe të bëjë të mirën, të kërkojë paqen dhe të ndjekë atë, sepse sytë e Zotit janë mbi të drejtët dhe veshët e tij janë në lutjen e tyre; por fytyra e Zotit është kundër atyre që bëjnë të keqen.” (1 e Pjetrit 3: 10-12)

TË SHMANGESH NGA E KEQJA DHE TA PËRKRAHËSH PAQEN

Nga vijnë luftërat dhe grindjet te ju?. A nuk vijnë, nga pasionet që luftojnë ndër gjymtyrët tuaja? Ju lakmoni dhe nuk keni, ju vrisni dhe keni smirë dhe nuk fitoni gjë; ju zihenit dhe luftoni, por nuk keni, sepse nuk kërkonit. Ju kërkonit dhe nuk merrni, sepse kërkonit keqas që të shpenzoni për kënaqësitë tuaja. O shkelës dhe shkelëse të kurorës, a nuk e dini se miqësia me botën është armiqësi me Perëndinë? Ai, pra, që don të jetë mik i botës bëhet armik i Perëndisë. (Jakobi 4: 1-4)



VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

Le të flaket larg jush çdo hidhërim, zemërim, inat, trazirë dhe shpifje me çdo ligësi. Por jini të mirë dhe të mëshirshëm njeri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin. (Efesianët 4: 31-32)

Lum ata që përpiqen për paqen, sepse ata do të quhen bij të Perëndisë. (Mateu 5: 9)

Po të jetë e mundur dhe aq sa varet prej jush, jetoni në paqe me gjithë njerëzit. Mos u hakmerrni për veten tuaj, o të dashur, por i jepni vend zemërimit të Perëndisë, sepse është shkruar: ``Mua më përket hakmarrja, unë kam për të shpaguear, thotë Zoti``. ``Në qoftë se armiku yt, pra, ka uri, jepi të hajë; në pastë etje, jepi të pijë; sepse, duke bërë këtë, do të grumbullosh mbi krye të tij thëngjij të ndezur``. (Romakët 12: 18-20)

Kini kujdes veten tuaj! Në se yt vëlla mëkaton kundër teje, qortoje; dhe në se pendohet, fale. (Luka 17: 3)

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)





**MORALI FISNIKI I
PROFETIT
MUHAMMED (savs)**

Kapitujt tonë të mëhershëm u përqendruan në dëmin fizik dhe shpirtëror që terrorizmi shkakton dhe cituam se si komunikimi i moralit të fesë në nivelin e ideve është hapi më i rëndësishëm në luftën kulturore kundër terrorizmit. Shpjegimi i moralit të vërtetë të fesë të përshkruar në Dhiatën e vjetër dhe të re dhe në Kuran – dashuria, dhembshuria, toleranca dhe maturia – janë rruga e vetme të zhduket gjakderdhja e pafund e terrorizmit. Në veçanti, zgjidhja për terrorizëm në emër të fesë qëndron posaçërisht në shpjegimin e saktë të fesë – me fjalë tjera në kuptimin e shembullit të moralit që diskutuam më herët. Cilido shembull që njerëzit e marrin për vete duhet të jetë një burim që ata mund ta konsiderojnë si udhëzues. Ai burim është Kurani, shembulli është jeta e Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Ky kapitull merret me shqyrtimin e jetës së tij në dritën e ajeteve të Kuranit dhe të *haditheve* – mësimëve dhe thënieve të tij.

Në çdo moment, Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) shfaqti një moral me të cilin Zoti ishte i kënaqur dhe jetoi në mënyrën më të përkryer. Çdo shoqëri që rregullohet sipas të dërguarve shembullorë të Zotit do të paraqet pengesë shumë të rëndësishme ndaj të këqijave shoqërore si terrorizmi, i cili nuk do të jetë në gjendje të mbijetojë në një mjedis të tillë. Terroristëve ju mungon çfarëdo koncepti i dashurisë njerëzore. Agresiv, të paepur, jo tolerant, të paaftë të bëjnë dialog me ata

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT


të cilët mendojnë ndryshe, duke mos parë asnjë vlerë në idetë e të tjerëve, ata përpiqen të zgjedhin çdo argument përmes dhunës. Në çdo moral shoqëror të ndërtuar mbi dashuri dhe tolerancë, ata kurrë nuk mund t'i arrijnë qëllimet e tyre.

PROFETI YNË (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ISHTE NJË NJERI I TOLERANCËS DHE DASHURISË

Në kohën e Profetit Muhammed (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), Arabia ishte vendbanim i bashkësive të feve, kulturave dhe ideve të ndryshme. Çifutët, të Krishterët, Sabianët, Zoroastrianët dhe adhuruesit e idhujve të gjithë jetuan pranë njëri tjetrit, së bashku me shumë fise të ndryshme të armiqësuar me njëra tjetrën. Megjithatë, pa marrë parasysh fisin apo besimet e tyre, Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) i thërriste njerëzit në fe me dhembshuri, durim, tolerancë dhe dashuri. Kurani (3:19) përshkruan sjelljen e tij të bukur/të këndshme ndaj atyre përreth tij:

Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta...

Sic u theksua më herët, Kurani shpall se nuk duhet bërë presion në askënd për ta përqafuar Islamin. Myslimanët janë të obliguar që vetëm ta shpjegojnë fenë e Zotit. Askush nuk mund ta shtrëngoje askënd tjetër të besojë apo të adhurojë. Vetëm me vullnetin e Zotit një njeri tjetër mund të udhëzohet në rrugën e



**© ti Pejgamber, Ne të dërguam ty
dëshmues, lajmëtar përgëzues e
qortues. Dhe me urdhërin e All-llahut,
thirrës për në rrugën e Tij dhe
pishtarë ndriçues.
(Koran, 33:45-46)**



**Që ju (njerëz) t'i besoni All-llahut dhe
të dërguarit të Tij dhe atë ta përkrahni
e ta respektoni, e (All-llahun) ta
madhëroni për çdo mëngjes
e mbrëmje.
(Koran, 48:9)**

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

drejtë dhe të besoj. Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) gjithnjë me përpikëri iu përmbajt kësaj ndalese dhe shpesh deklaroi se një njeri mund të jetoj sipas fesë/në pajtim me fenë vetëm kur, në zemrën e tij, ai me të vërtetë e dëshiron këtë. Zoti i tha Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) në një ajet të shenjtë (50:45) se si ai duhet të sillet ndaj atyre përreth tij:

Ne dimë më së miri çka thonë ata, e ti ndaj tyre nuk je ndonjë dhunues, ti këshillo me këtë Kuran atë që i ka frikë kërcënimit Tim.

Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) njëherë iu tha besimtarëve: “Jam dërguar për të shfaqur/treguar mëshirë/për të qenë i mëshirshëm.”²⁵ Çelësi i moralit të tij fisnik po ashtu përshkruhet me këto fjalë:

Ata që janë të mëshirshëm do të mëshirohen nga i Gjithëmëshirshmi.²⁶

Një numër i madh i haditheve flasin për dhembshurinë, dashurinë dhe tolerancën e Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Për shembull, ai njëherë ka thënë: “Ata të cilët nuk janë të mëshirshëm nuk do të mëshirohen.”²⁷ Fjalët tjera të tij përmbajnë:

Furnizuesi im m’i ka urdhëruar nëntë gjëra: Ta nderoj Atë, fizikisht dhe shpirtërisht, të flas të vërtetën dhe të jem i njerëzishëm, në mbarësi dhe fatkeqësi...²⁸

Pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti im, nuk do të hyni në Xhenet përderisa nuk besoni dhe nuk do të besoni përderisa nuk do ta duani njëri tjetrin. A doni që t’ju këshilloj për

VETËM DASHURIA MUND T'Ë SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

diçka që nëse e praktikoni, do ta duani njëri tjetrin? Përhapni përshëndetjen me selam (paqe) mes jush. ²⁹

Në përmbledhjen e tij të informacionit prej botës së haditheve, dijetari i madh Islamik Imam Ghazali bën një përmbledhje të sjelljes së Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ndaj atyre përreth tij me këto fjalë:

... Çdokush mendonte se Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) e nderonte atë më shumë. Kushdo që vinte te ai mund ta shihte atë.

... Ai e kishte zakon t'ë thërriste shoqëruesit e tij me mbiemër me respekt dhe e kishte zakon që t'ia vinte një mbiemër atij që nuk kishte mbiemër.

... Ai kishte një sjellje shumë të dashur dhe të butë ndaj njerëzve.

... Askush s'mund të fliste me zë të lartë në tubimin e tij. ³⁰

Dashuria e Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ndaj shoqëruesve të tij, nderimi dhe dashuria e tij i lidhi ata rreth tij dhe i inkurajoi ata të besojnë. Shembulli i tij i lartë i moralit është një shembull tek i cili të gjithë Myslimanët duhet të ndalojnë. Një ajet (9:128) përshkruan vetitë e Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) që u bë shembull për tërë njerëzimin:

Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët.

Dashuria dhe dhembshuria, toleranca dhe keqardhja janë veti të përbashkëta të të dërguarve të cilët Zoti i dërgoi si udhëzues

për në rrugën e drejtë. Kurani thotë se profetët tjerë kanë qenë të nderuar me një “ndjeshmëri të përzemërt” dhe i jap Profetit Gjon (paqja qoftë mbi të), të cilit Ai i dha urtësi/mençuri, si një shembull në këtë aspekt për tërë njerëzimin. Ajeti 19:13 përshkruan atë personalitet të shenjtë me këto fjalë:

Dhe nga ana jonë i mundësuam të jetë i butë, i pastër dhe respektues (i dëgjueshëm).

NDERIMI FISNIK I PROFETIT TONË

(paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)

Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ishte në kontakt të vazhdueshëm me të gjitha shtresat e shoqërisë dhe fliste me çdokënd, prej atyre në kulmin e fuqisë deri te robërit e luftës, fëmijët dhe jetimët. Me njerëz të gjitha pozitive të ndryshme në shoqëri, që jetonin mënyra të ndryshme të jetës, me karaktere dhe zakone të ndryshme, ai vendosi dialogje pozitive, duke fituar dashurinë e tyre dhe duke u sjellë me të gjithë ata me plot durim dhe mirëkuptim.

Siç njoftohemi prej shokëve të cilët ishin të afërt me të, Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ishte “shumë i mirë, moralisht mbi çdo kritikë, i këndshëm, miqësor dhe i kujdesshëm.” Fjalët e tij: “*Jam dërguar të përsos cilësitë e mira të karakterit*”³¹ janë shprehje e natyrës së tij të lartë. Aisha, e cila e njihnte atë shumë mirë, e ka përshkruar moralin e tij të bukur me fjalët në vazhdim: “*Natyra e Profetit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ishte Kurani.*”³²

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT



Anasi, i cili ishte rritur në shtëpinë e Profetit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) dhe që i ka shërbyer atij me vite e përshkruan mirësjelljen e tij me këto fjalë:

I Dërguar i Allahut (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), kur i jepte dorën dikujt, nuk e largonte dorën e tij derisa tjetri të mos e largonte dorën e tij. Ngjashëm, nuk e largonte shikimin nga askush përderisa tjetri njeri të mos e kthente fytyrën e tij në anën tjetër. Dhe asnjëherë nuk është parë të vinte gjunjët e tij përpara atij me të cilin ishte ulur.³³

Kurdo që dikush i fliste atij ai rrinte i heshtur dhe e dëgjonte derisa të mbaronte.³⁴

Anas bin Malik ("Allahu qoftë i gëzuar me të") thotë: "Unë mbeta në shërbim të Resulullahut (sasa) për dhjetë vite. Ai as edhe njëherë nuk më tha një fjalë përbuzëse. Kur bëra diç ai kurrë nuk më pyeti: "Pse veprime ashtu?". Kur nuk kryeja një punë të caktuar, ai kurrë nuk më pyeti se pse nuk e bëra atë."³⁵

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

Gjatë jetës së tij, Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) edukoi me mijëra njerëz. Përmes ndikimit të tij, njerëzit të cilët nuk kishin kurrfarë dijenie për fenë u bënë të vëmendshëm, të gatshëm të flijohen, kanë sjellje të pëlqyeshme dhe posedojnë moral të lartë. Madje edhe sot, sa e sa shekuj pas vdekjes së tij, Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) mbetet udhërrëfyese dhe mësuesi më i mirë, fjalët dhe morali i të cilit vazhdojnë të frymëzojnë miliarda njerëz.

PROFETI YNË (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) I KA KËSHILLUAR BESIMTARËT TË JENË TË DASHUR

Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë se është veçanërisht e rëndësishme që besimtarët ta duan njëri tjetrin me një dashuri të sinqertë, duke mos marrë parasysh interesat personale dhe kur të mos ushqejnë ndjenja negative si urrejtja, zemërimi apo xhelozia.

Në Kuran (42:23), Zoti urdhëron Profetin e Tij (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) të thotë si vijon:

“Ajo (dhunti) konsiston në atë që All-llahu u jep myzhde robërve të vet, të cilët besuan dhe bënë vepra të mira. Thuaj: “Unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim për thirrjen time vetëm se respektin e dashurisë për hir të fafesisnisë (akraballëkut)”. Kush bën ndonjë të mirë, Ne ia shumëfishojmë të mirat; vërtet, All-llahu falë mëkatet, është mirënjohës.”

Disa hadithe lidhur me dashurinë, miqësinë dhe vëllazërinë

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

e Profetit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) thonë:

Një besimtar dëshiron për të tjerët atë që dëshiron për veten e tij. ³⁶

I Dërguari i Allahut (saas) e kishte zakon të pranonte dhurata dhe të dhuronte diçka nga ana e tij. ³⁷

Atij të cilit i dhurohet një lule e borzilokut nuk duhet ta refuzojë atë, sepse është e lehtë në peshë dhe ka aromë të këndshme. ³⁸

Mos e urreni njëri tjetrin, mos i keni zili njëri tjetrit, mos shitni mbi shitjen e tjetrit, mos u grindni me njëri tjetrin dhe mos përgojoni njëri tjetrin. Robërit e Zotit janë vëllezër me njëri tjetrin. ³⁹

Ju kanë sulmuar veset e gjeneratave më të hershme– zilia dhe urrejtja. Urrejtja është e Nuk do të hyni në Xhenet derisa

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

të mos besoni. Nuk do të besoni derisa nuk do ta duani njëri tjetrin. A t' mos ju bëj me dije se cila gjë do t'ju shpie në të? Përhapni paqen midis jush. ⁴⁰

Nuk është njeri i fortë ai i cili është i fuqishëm në mundje, por ai i cili e kontrollon veten e tij në zemërim. ⁴¹

Ruajuni nga zilia, sepse zilia e asgjëson të mirën (veprat) sikurse flaka që gëlltit drurin. ⁴²

Myslimanët janë vëllezër me njëri tjetrin. Ata nuk duhet as ta mashtrojnë, gënjejnë dhe as ta poshtërojnë njëri tjetrin. ⁴³

PROFETI YNË (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) KA URDHËRUAR DREJTËSINË

Me rregullat që ai ju dha Myslimanëve, me sjelljen e tij të drejtë dhe tolerante ndaj feve, gjuhëve, racave dhe fiseve tjera; dhe me sjelljen e tij të njëjtë ndaj gjithkujt, të pasur dhe të varfër, Profeti ynë Muhammed (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) është një shembull i shkëlqyeshëm për tërë njerëzimin. Në një ajet (5:42), Zoti i thotë atij: “Po nëse gjykon mes tyre, gjyko drejtë; All-llahu i do të drejtit.” Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) kurrë nuk e bëri as lëshimin më të vogël ndaj kësaj drejtësie, madje as në rrethanat më të vështira.

Shumë ngjarje nga jeta e tij dëshmojnë për sjelljen shembullore të Profetit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Në vendin ku ai jetoi, bashkëjetonin një shumëllojshmëri e feve, racave dhe fiseve. Këto bashkësi e kishin shumë vështirë të jetonin në paqe dhe siguri, dhe edhe më të vështirë që t'i përmbajnë ata të cilët

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

dëshironin të mbjellin përçarje. Megjithatë, drejtësia e Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ishte burim i paqes dhe sigurisë, në të njëjtën masë për jobesimtarët sikurse që ishte për Myslimanët. Gjatë jetës së tij, çdokush në Gadishullin Arabik – i Krishterë, Çifut apo pagan – trajtohej me drejtësi, pa diskriminim.

Sjellja e bukur e Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), në pajtim me Kuranin, paraqet shembull për pjesëtarët e feve të ndryshme dhe tregon se si ata duhet të sillen ndaj njëri tjetrit. Drejtësia e tij solli kompromis mes njerëzve të racave të ndryshme. Në shumë prej fjalimeve të tij, madje edhe në Predikimin (Hutben) Lamtumirëse, ai e bëri të ditur se raca apo klasa e askujt nuk e pajisi askënd me superioritet. Ajo qëndron vetëm në besim, siç shpallet nga Zoti në Kuran (49:13). Hadithet tjera lidhur me këtë temë thonë:

Ju jeni bijtë e Ademit dhe Ademi u krijua prej dheut. Le të pushojnë së krenuari njerëzit për paraardhësit e tyre. ⁴⁴

Prejardhjet tuaja nuk janë arsye për ta fyer dikend. Ju të gjithë jeni bijtë e Ademit. Asnjëri nuk ka kurrfarë epërsie mbi tjetrin, përveç se në fe dhe takva (besim). ⁴⁵

PROFETI YNË (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) KA PËRKRAHUR PAQEN GJITHMONË

Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) kurrë nuk ka dëshiruar luftën por me vite të tëra, ka bërë përpjekje të mëdha për të përhapur Islamin në mënyrë paqësore. Ai ishte



VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

i durueshëm përballë sulmeve të ashpra dhe presionit, përveç kur marrja me një presion të tillë bëhej imperativ, ai jepte leje për luftë, në dritën e shpalljes prej Zotit. Ai kurrë nuk shpallte luftë përderisa ekzistonte edhe mundësia më e vogël për paqe, dhe përderisa sulmet dhe presioni i armikut nuk paraqisnin rrezik për vdekje.

Gjatë jetës së Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), ekspedita Mu'tah ishte më e përgjakshmja dhe më e vështira e zhvilluar nga ana e Myslimanëve. Ai e emëroi Zejd ibn Harithah si udhëheqës të ushtrisë dhe i paralajmëroi trupat:

Luftoni në emër të Zotit, në rrugën e Zotit, kundër atyre që e mohojnë Zotin. Mos u bëni pjesë e kurrfarë tradhtie. Mos preni veshë e hunda dhe pjesë të tjera të trupit. Mos i vritni gratë dhe fëmijët, të moshuarit dhe besimtarët në vendet e tyre të adhurimit. Mos i preni hurmat dhe pemët tjera dhe mos i rrëzoni ndërtesat.⁴⁶

Bazuar në urdhrat profetike për luftën, parimet vijuese, të cilat mund të quhen "Parimet Islamike të Luftës", janë nënvizuar nga dijetarët Myslimanë:

Lufta duhet të zhvillohet vetëm me ata të cilët e nxisin atë dhe përfshihen në të.

Priftërinjtë në kisha, fëmijët, gratë dhe të moshuarit nuk duhet të dëmtohen kurrë.

Fushat e mbjellura nuk duhet të dëmtohen.

Marrëveshjet dhe ujdite nuk duhet të thyhen.

Kafshët nuk duhet të dëmtohen.

Nuk duhet të ketë mizori dhe torturë.

Qytetet nuk duhet të shkatërrohen.⁴⁷

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)



Marrëveshja e Medinës, e nënshkruar nga Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) dhe bashkësitë Çifute dhe politeiste në këtë qytet, ishte gjithashtu një shembull i drejtësisë dhe respektit të ndërsjellë në mes të bashkësive të ndryshme. Marrëveshja e hartuar për të themeluar një lloj kushtetute në mes të bashkësive të besimeve të ndryshme dhe që lejon secilin t'i zbatoj parimet e tij, solli paqe për ata të cilët me vite të tëra kishin qenë armiq ndaj njëri tjetrit. Njëra prej tipareve më mahnitëse të saj ishte mënyra se si ajo ruajti lirinë e besimit. Neni lidhur me këtë çështje shënon:

Çifutët Banu 'Avf janë një komb me Myslimanët, Çifutët kanë fenë e tyre dhe Myslimanët të tyren...⁴⁸

Neni 16 i Marrëveshjes së Medinës lexon: "*Çifuti i cili na bindet sigurisht se ka të drejtë për përkrahjen tonë dhe të drejta të*

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

barabarta sikur secili prej nesh. Atij nuk do t'i bëhet e padrejtë dhe as që do t'i ndihmohet armikut të tij.” ⁴⁹ Pasardhësit e Profetit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) i qëndruan besnik kësaj rregulle me të cilën ai u pajtua, duke e shtrirë atë madje te Berberët, Budistët, Brahmanët Hindu dhe te njerëzit e besimeve tjera.

Njëra arsye pse koha e Profetit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ishte e bekuar me paqe dhe siguri ishte pikëpamja e tij për drejtësinë, pra në pajtim me moralin e Kuranit. Shkrimtarët e huaj, gjithashtu, kanë qenë të impresionuar me karakterin e lartë të tij dhe lëvdojnë moralin e Profetit tonë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) në veprat e tyre. Në Islamin e vërtetë, Xhon Berndard Sho përshkruan këto tipare të larta:


Gjithmonë e kam vlerësuar lartë fenë e Muhammedit për shkak të gjallërisë së mrekullueshme të saj. Ajo është feja e vetme e cila më duket se posedon atë aftësinë e përvetësimit për fazën e ndryshimit të jetës që mund ta bëj veten joshëse për secilën kohë. Unë e kam studiuar atë ... ai duhet të quhet Shpëtimtari i Njerëzimit. Besoj se nëse një njeri sikur ai do të merrte pushtetin mbi botën moderne, ai do të arrinte t'i zgjidhte problemet e saj në një mënyrë që do të sillte paqen dhe lumturinë aq shumë të nevojshme... ⁵⁰

Në kohën tonë po ashtu, veprimi në përputhje me moralin e Kuranit është e vetmja përgjigje ndaj të gjitha konflikteve, luftimeve dhe paqëndrueshmërisë në botë. Sikurse Profeti ynë (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), ne kurrë nuk duhet të largohemi nga rruga e drejtësisë dhe duhet gjithmonë t'i respektojmë të drejtat e bashkësive dhe individëve të ndryshëm, çfarëdo qofshin besimet dhe identitetet e tyre.



A golden archway with intricate carvings frames a scene. Inside the arch, a path leads through a field of purple and pink flowers towards a green valley. In the background, there are snow-capped mountains under a blue sky. A golden chandelier hangs from the ceiling of the archway.

**ZGJIDHJET
PËR TERRORIN
DHE ANARKINË, NGA
BEDUIZZAMAN SAID NURSI**

The page is framed by a highly decorative border. The border consists of an inner gold frame with intricate scrollwork and floral patterns, set against a dark blue background. This is further enclosed by a wider, more ornate gold border with similar decorative motifs. The text is centered within the white space of the inner frame.

Gjatë historisë, ka pasur kohëra kur kamxhikët e terrorit dhe anarkisë janë intensifikuar, duke paraqitur kërcënim për popullata të tëra. Zgjidhje të shumta janë propozuar. Njëri prej atyre i cili theksoi rëndësinë e një lufte gjithëpërfshirëse kundër terrorit dhe anarkisë ishte dijetari i madh Islamik nga Turqia, Bediuzzaman Said Nursi (1877-1960). Ai ka thënë se gjëja e parë që njerëzit duhet të bëjnë është ta përhapin moralin e Kuranit, për këtë qëllim, ai bëri një numër rekomandimesh.

Në kohën kur jetoi Bediuzzamani, bota po përjetonte ndryshime radikale. Lufta e Parë Botërore pat një ndikim të veçantë në jetën e tij. Gjatë Luftës, ai kishte udhëhequr forcat ushtarake Otomane në Frontin e Kaukazit kundër Rusëve që po invadonin për çka ishte dekoruar më vonë me Medalje Lufte. Ai ishte burgosur në Mars të vitit 1916 dhe ishte mbajtur dy vjet në Rusi. Në fillim të vitit 1918, ai iku nga burgu dhe u kthye në Stamboll përmes Varshavës, Berlinit dhe Vjenës.

Kështu ai ishte në rreshtin e parë për të qenë dëshmitar i kolapsit të Perandorisë Otomane dhe themelimit të Republikës Turke. Ai po ashtu pa se si Revolucioni Rus solli në fuqi Komunizmin, konfliktin në mes të fuqive të mëdha Evropiane dhe vështirësitë që i shkaktuan Republikës Turke të dy Luftërat Botërore. Siç mund të shihet në shkrimet e tij, ai bëri një analizë të hollësishme të gjithë këtyre ngjarjeve, duke vlerësuar të gjitha zhvillimet politike në dritën e vargjeve të Kuranit. Ai gjithmonë

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

theksonte se si një shoqëri që ia kthen shpinën fesë do të përjetojë humbje të madhe dhe se vetëm nëse Myslimanët do t'i bashkonin forcat do të mund të arrinin sukses të madh kundër ideologjive ateiste.

Bediuzzamani e dinte se terrori dhe anarkia do të shfaqeshin në kohën e tij dhe më vonë. Prandaj, ai u mundua t'i njoftonte njerëzit për një numër të mundshëm zgjidhjesh për këto probleme të tmerrshme. Në fjalët e tij: *"... Religjioni e dënon me forcë konfliktin dhe anarkinë. Anarkia nuk njeh kurrfarë të drejtash. Ajo e shëndreron moralin njerëzor dhe veprat e qytetërimit në moral kafshësh,"*⁵¹. Kjo ishte shprehja më e mirë e mundshme e pikëpamjeve Islamike për terrorin dhe dhunën, të cilën Bediuzzamani e kaloi tërë jetën e tij duke e shpjeguar. Siç ka thënë njëherë: "Durimi dhe qëndresa për t'i dhënë fund anarkisë dhe për të mbajtur rendin publik janë të domosdoshme, me sinqeritet të plotë në shërbim të besimit. Prandaj unë jam plotësisht i kënaqur të flijoj reputacionin tim për këtë qëllim."⁵² Ai theksoi se në luftën kundër anarkisë dhe terrorit – luftë që kërkoi durim dhe qëndresë – besimtarët bartën një përgjegjësi të madhe.

Përvoja dhe fjalët e tij udhëzuese kanë vlerë të madhe sot. Duhet të marrim parasysh me kujdes çdo thënie të këtij individi të admirueshëm, i cili kaloi jetën e tij duke u përpjekur të ndërtoj një botë me dashuri dhe mençuri, të bazuar në parimet morale të Kuranit.

**VETËM ME ANË TË DASHURISË,
BEDIUZZAMANI GJITHNJË THOSHTE,
MUND T’I SHKAKTOHET DISFATË
TERRORIZMIT**

Aspekti i thënieve të tij që vlen të përmendet më së tepërmi është rëndësia që ai i jap dashurisë dhe jetës njerëzore, i frymëzuar nga morali i Kuranit. Siç ka thënë njëherë:

Mësimi i vërtetë nga Kurani është ky: Nëse në një shtëpi janë dhjetë njerëz të pafajshëm dhe një përbindësh... a është e lejueshme të digjet ajo shtëpi... edhe pse parimet morale të Kuranit e ndalojnë një gjë të tillë... (të) shkatërrosh dhjetë njerëz të pafajshëm për shkak të një përbindëshi? A nuk do të ishte djegia e asaj shtëpie pabesia dhe mizoria më e madhe e mundshme? ... morali i Kuranit ndalon rrezikimin e jetëve apo dëmtimin e 90 përqind të njerëzve të pafajshëm për shkak të 10 përqindshit të përbindëshave që e kërcënojnë sigurinë. Duhet të jemi të vetëdijshëm se feja na obligon që të ruajmë sigurinë dhe të veprojmë në përputhje me këtë mësim nga Kurani...⁵³

Me këto fjalë, Bediuzzamani zbuloi rëndësinë e madhe të jetës njerëzore, se çdo sakrificë e mundshme duhet bërë për të shpëtuar jetën e një individi të vetëm, se veprimi i të kundërtës do të thotë mizori e vërtetë. Myslimanët duhet të punojnë për të vendosur paqen dhe sigurinë. Pasi që kjo përgjegjësi është urdhër prej Zotit, besimtarët përdorin të gjitha mjetet që kanë në disponim për të ndihmuar përhapjen e moralit të fesë. Aty ku terrori dhe anarkia bëhen kamxhikë të llahtarshëm, një mjedis ku jetohej sipas moralit

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

Islamik i ngjason parajsës. Bediuzzamani ka thënë po këtë në një numër deklaratash:

Nëse një Mysliman largohet nga një shoqëri Myslimane, largohet nga feja dhe bëhet anarkist dhe ka ndikim helmues në shoqëri. Sepse anarkia nuk njih të drejta dhe e shëndrron natyrën e vërtetë të njerëzimit në moralin e kafshëve të egra. ⁵⁴

Një Mysliman i vërtetë, një besimtar i sinqertë, kurrë nuk përkrah anarkinë dhe të keqen... feja ashpër e dënon konfliktin dhe anarkinë. Pasi që anarkia nuk njih kurrfarë të drejta dhe e shëndrron natyrën e vërtetë të njerëzimit dhe veprat e qytetërimit në moralin e kafshëve të egra. ⁵⁵

Ai e bëri të qartë se komunikimi i moralit të fesë do të hapte një dialog madhështor, madje edhe në zemrat e njerëzve jo tolerant, të pakompromis dhe agresiv. Dashuria e Zotit do të largonte njerëzit prej të gjitha formave të tiranisë. Ai theksoi se detyra e çdo Myslimani është që të rrëfejë bukuritë e fesë dhe të vërtetat e Kuranit, në mënyrë që të mbjellë atë dashuri në zemrat e njerëzve. Bediuzzamani



Bediuzzamna Said Nursi

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

në një rast theksoi se Risale-i Nur i tij ("Letrat e Dritës", një përmbledhje e të gjitha shkrimeve të tij) plotësuan këtë funksion:

Po, Risale-i Nur dhe besimi i mbështetur në të vërtetën dhe në fakte dhe të vërtetat e Kuranit, shpjegon dhe sqaron çështjet në mënyrë të përshtatshme për kohërat dhe në atë mënyrë që shoqëria të mund t'i pranoj ato, ka bërë që me miliona njerëz të ekzaminojnë besimin dhe fenë, ka zgjuar dashurinë Islamike dhe dialogun në shpirtat e tyre dhe ka ndërtuar një mur kundër ateizmit dhe amoralitetit, shenjave të anarkisë. Po, bashkimi i idealit dhe qëllimit të shenjtë e formojnë një forcë të pathyeshme, një mur të pakalueshëm, një fuqi shpirtërore në shpirtat, zemrat dhe mendjet e njerëzve.⁵⁶

RËNDËSIA E MORALIT TË KURANIT NË RASTIN KUNDËR TERRORIT

Në çdo rast, Bediuzzamani ua përkujtoi njerëzve se në luftën kundër terrorit dhe anarkisë, arma më e rëndësishme ishte përhapja e moralit fetar. Siç komentoi ai:

Qytetet janë po ashtu shtëpi për banorët e tyre. Nëse besimi në ahiret nuk i udhëheq pjesëtarët e asaj familjeje të madhe, veset si keqdashja, interesi personal, pretendimet e rrejtshme, egoizmi, shtirja, hipokrizia, mitoja dhe mashtrimi do të mbisundojnë – duke ia zënë vendin sinqeritetit, përzemërsisë, mirësisë, përkushtimit, vetëflimit, kërkimit të kënaqësisë së Zotit dhe shpërblimit të ahiretit, të cilat janë bazat e sjelljes dhe moralit të mirë. Anarkia dhe egërsia do të sundojnë me

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

një rregull dhe njerëzi të cekët, duke e helmuar jetën e qytetit. Fëmijët do të bëhen ngatërrestar, rinia do të jepet pas pijeve alkoolike, të fuqishmit do të fillojnë tiraninë dhe të moshuarit do të fillojnë të qajnë.⁵⁷

Në shoqëritë të cilat ia kthejnë shpinën fesë, shfaqen mashtrimi, tirania, anarkia, dhuna dhe terrori. Virtytet si bashkëpunimi, flijimi dhe ndershmëria lihen anash. Njerëzit mendojnë vetëm për interesat e tyre personale, duke dëshiruar vetëm rehatinë e tyre dhe duke punuar vetëm për veten e tyre. Mirëpo, kur një shoqëri jeton në pajtim me fenë, atëherë bashkëpunimi, miqësia dhe vëllazëria mbisundojnë. Më vonë në po të njëjtën deklaratë, Bediuzzamani jap shembuj të përparësive që morali fetar mund t'ju sjell familjes dhe jetës shoqërore:

Ngjashëm, vendi është po ashtu një familje dhe atdheu, shtëpia e familjes kombëtare. Nëse mbisundon besimi në ahiret, atëherë respekti i vërtetë, dhembshuria e sinqertë, dashuria pa interes, ndihma reciproke, shërbimi i sinqertë dhe raportet shoqërore, bamirësia e sinqertë, mirësia, madhështia modeste dhe përsosmëria, të gjitha do të fillojnë të formohen. Ai u thotë fëmijëve të vet: "Mos u merrni me gjëra të kota; ekziston Xheneti (Parajsa) që duhet të fitohet!" dhe u mëson atyre vetëpërmbytjen përmes udhëzimit në Kuran. Ai u thotë të rinjve: "Ekziston zjarri i Xhehenemit (Ferrit), hiqni dorë nga dehja juaj!" dhe ua kthjellon mendjet. Tiranëve u thotë: "Ekziston një vuajtje e tmerrshme, do ta pësoni keq!" dhe i bën ata që t'i përkulen drejtësisë. Të moshuarve, u thotë: "Në ahiret ju pret një lumturi e përjetshme, shumë më e madhe se lumturia që keni humbur këtu, dhe



VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

rinia e pavdekshme, përpikuni t'i fitoni ato!" Lotët e tyre i shëndrrojnë në të qeshura. Në çdo grup i shfaq efektet e mbara, të veçanta dhe universale, dhe i ndriçon ata. Sociologët dhe moralistët, të cilëve ju intereson jeta shoqërore e njerëzimit, duhet t'i kushtojnë vëmendje të posaçme kësaj. Në qoftë se krahasohen me mijëra dobi dhe përparësi tjera të besimit me pesë apo gjashtë të cilat i kemi përmendur tërthorazi, do të kuptohet se vetëm besimi është mënyra për të arritur lumturinë në këtë botë dhe në botën tjetër dhe në jetët e të dy botëve.⁵⁸

Siç sugjerojnë këta shembuj, me të jetuar të njerëzve sipas moralit fetar, është gjë e lehtë që ata të këshillohen, t'ju ndalohet atyre që të bëjnë gjëra të liga dhe të kthehen në rrugën e drejtë. Bediuzzamani shpeshherë thoshte se terrori dhe anarkia do të mund të shkatërroheshin vetëm nëse njerëzit jetojnë sipas parimeve morale të Kuranit – duke porositur dashurinë, tolerancën, paqen, faljen, dhembshurinë dhe mëshirën, duke iu kundërvënë të gjitha formave të së keqes dhe ligësisë. Këto fjalë të thirrjes së tij drejtuar Myslimanëve për të përqaftuar të vërtetat e Kuranit, duke theksuar përsëri se vetëm mbisundimi i fesë mund t'i jap fund anarkisë në botë.

Zgjidhja e vetme ndaj rrënimit dhe shkatërrimit të shkaktuar nga anarkia, që kërcënon dhe që ka sjellë fatkeqësi të tmerrshme mbi njerëzimin, janë të vërtetat e amshueshme dhe të pafund të një feje të shenjtë dhe hyjnore.⁵⁹

Bediuzzamani shpeshherë theksonte se morali i Kuranit dhe interpretimi i tij në *Risale-i Nur* dhanë një kontribut të madh në eliminimin e terrorit dhe anarkisë dhe do të vazhdojnë të kontribuojnë edhe në të ardhmen. Çdo përpjekje për të shpjeguar

moralin e Kuranit dhe për t'i ftuar njerëzit në rrugën e drejtë të Islamit ndihmon në përmbushjen e kësaj detyre dhe luan një rol të rëndësishëm në luftën kundër terrorizmit. Bediuzzamani tërhoqi vëmendjen ndaj rëndësisë që ka kjo: Risale-i Nur pa dyshim nuk ka kurrfarë lidhje me politikë. Por pasi që ka rrënuar mosbesimin e plotë, ai asgjëson dhe refuzon anarkinë, e cila mbështet mosbesimin e plotë dhe despotizmin absolut që i zë frymën.⁶⁰

Në një deklaratë tjetër, ai shpreh disa elemente të domosdoshme për të hequr qafe anarkinë: "Respekti, dhembshuria, ndalimi nga mëkatet, siguria, heqja dorë nga shkelja e ligjeve dhe bindja ndaj autoritetit."⁶¹ Më vonë në të njëjtën deklaratë, ai përshkruan mënyrën se si *Risale-i Nur* përmbush detyrat që ata kanë marr përsipër:

Kur Risale-i Nur vështron jetën e shoqërisë, vendos dhe forcon këto pesë parime në një mënyrë të fuqishme dhe të shenjtë dhe ruan gur themelin e rendit publik... Gjatë njëzet viteve të fundit, "Risale-i Nur" ka shëndrruar njëqind mijë njerëz në pjesëtar të padëmshëm, të dobishëm të këtij kombi dhe vendi.⁶²

ARTI, MENÇURIA DHE NJËZËSHMËRIA E QËLLIMIT

Në veprat e tij, Bediuzzaman Said Nursi ofron një përshkrim të hollësishëm të formës që duhet të marr lufta kundër terrorit, ateizmit, anarkisë dhe problemeve të Botës Islamike. "Armiqtë tonë janë mosdija, varfëria dhe konflikti i brendshëm. Ne do t'i luftojmë këta tre armiqtë me armët e dijes, aftësisë dhe njëzëshmërisë së qëllimit."⁶³

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

Këto fjalë jetike tërheqin vëmendjen ndaj tri rreziqeve më kërcënuese: mosdija, varfëria dhe konflikti.

Është me rëndësi të madhe të paralajmërohen njerëzit për të parën prej këtyre, mosdijen. Në botën e sotme Islamike, shumica e madhe ka njëfarë dijenie për fenë dhe besimin në Zot. Mirëpo rrallëherë kjo e njëjta shumicë e ekzaminon fenë dhe vlerat shpirtërore. Pasi që dijenia e tyre është përgjithësisht sipërfaqësore dhe e fituar nga dora e dytë, është e pamundur ta bartin moralin e vërtetë të fesë, në kuptimin e tij të vërtetë, në jetë. Prandaj është thelbësore, të hiqet kjo mungesë e dijes.

Skamja e botës Myslimane është rreziku i dytë që përmend Bediuzzamani. Skamja ua ndalon njerëzve që të kenë shkollim të duhur dhe kështu ushqen mosdijen. Ajo po ashtu bën që Myslimanët të ndihen të dobët dhe në këtë mënyrë ushqen zhgënjimin dhe radikalizmin. Rreziku i tretë është konflikti i brendshëm për aq shumë çështje në botën Myslimane. Kur palët nuk mund të arrijnë kurrfarë marrëveshje lidhur me vlerat themelore, debati i tyre për idetë zakonisht degjeneron në armiqësi, konflikte dhe madje edhe luftëra qytetare. Toleranca dhe respekti i dyanshëm nuk janë vetëm domosdoshmëri ndër-qytetëruese por po ashtu domosdoshmëri brenda-qytetëruese.

Por e vërteta është se një qëndrim dobiprurës mund të zgjidhë këto probleme dhe konflikte. Udhët e arsyes dhe ndërgjegjes janë një dhe të njëjta. Për atë arsye, e vërteta duhet të deklarohet botërisht, përballë kaosit dhe mosmarrëveshjes që konflikti sjellë me vete. Bediuzzamani gjithashtu theksoi masat që duhet ndërmarr kundër këtyre tri rreziqeve.

E para prej këtyre, arti, zë një vend të rëndësishëm dhe

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

nënkupton shumë gjëra: Së pari, që njerëzit duhet të mësohen ta kuptojnë bukurinë dhe estetikën. Këto mirësi prej Zotit do t'i largojnë shpirtrat njerëzor nga dhuna shtazarake. Dija se arti është një mirësi e dhuruar nga Zoti dhe falënderimi për këtë rrit forcën shpirtërore të njerëzve. Për këtë arsye, është më se e rëndësishme të shfaqet gjithë bukuria e artit të Zotit gjithandej rreth nesh. Artistët duhet të veprojnë në pajtim me këtë dijeni,



VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

dhe të devotshmit duhet t'i drejtohen artit me këtë vetëdije të njëjtë. Çdo shpjegim i moralit të fesë duhet të bart në mendje vlera artistike. Është tejet e rëndësishme që të demonstrohet kuptimi i lartë artistik i të devotshmëve në të gjitha veprat e shkruara, me piktura me ngjyra, gjuhë të thjeshtë dhe të qartë dhe botim të kualitetit të lartë.

Urtësia e mishëruar në fjalën e shkruar është po ashtu një formë arti. Fjalët e përdorura, shembujt e përdorur dhe mënyrat e mrekullueshme, efikase të shprehjes të gjitha përbëjnë përshtypje shumë të rëndësishme në lexuesin. Kur është fjala për shpjegimin e bukurive të fesë, mënyrat e thjeshta të shprehjes – në kundërshtim me metodat e paqarta, konfuze dhe të errëta – e bëjnë shumë më të lehtë që të perceptohet e vërteta dhe të kuptohet ajo.

“Mençuria” për të cilën bën fjalë Bediuzzamani nënkupton zotërimin e dijes. Myslimanët duhet të jenë zotërues të dijenisë në kohën në të cilën ata jetojnë. Kjo, natyrisht përfshin shkencën dhe shkencat shoqërore. Pasi që një Mysliman është përfaqësues tokësor i fesë që Zoti ka zgjedhur për Njeriun, ai duhet të jetë i përgatitur mirë në shkenca, kultura, mendimin dhe teknologjinë e kohës së tij, si edhe të jetë i aftë ta përdor atë dijeni në mënyrë efikase.

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

Metoda e fundit që rekomandon Bediuzzamani, njëzëshmëria e qëllimit, duhet të shkaktohet nga secili Mysliman i cili dëshiron të arrij sigurinë dhe mirëqenien dhe të shoh botën Islamike duke përparuar përsëri. Historia dëshmon se bashkimi dhe harmonia në botën Islamike gjithmonë kanë sjellë sukses. Epoka e artë e Profetit (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) dhe e kalifëve të parë, perandoria e Abasidit, perandoria e Saladinut apo Perandoria Otomane, të gjithë këta shembuj tregojnë se bashkimi midis vet Myslimanëve krijoi shtete të fuqishme dhe fitimtare, mirëpo të drejta dhe tolerante. Në kohë trazirash, si Myslimanët ashtu edhe jo Myslimanët kanë pësuar.

Pra, një ringjallje e botës Islamike varet nga bashkimi i Myslimanëve në mbarë globin, që i kalon konfliktet etnike, sektariane apo shoqërore. Me t'u arritur kjo, formimi i një uniteti politik – në lidhje me një Union Islamik – do të jetë pranë/afër po ashtu. Një Union i tillë do të zgjidhë konfliktet si në mesin e vet Myslimanëve ashtu edhe midis Myslimanëve dhe jo-Myslimanëve, do të shërojë elementet radikale në botën Islamike me anë të edukimit dhe bindjes dhe do të vendos raporte të mira midis qytetërimit Islamik dhe qytetërimeve tjera.

The image features a highly ornate, golden frame with intricate scrollwork and floral patterns. Inside the frame, the background is a deep blue color. The central scene is a perspective view of a grand, classical-style hallway. The hallway is characterized by a series of arches supported by columns, all rendered in a golden-yellow hue. The floor is also golden, with a pattern of diamond-shaped tiles. On the left side of the hallway, a glowing chandelier hangs from the ceiling. In the background, a lush green landscape is visible, featuring a prominent waterfall cascading down rocks. The overall aesthetic is one of opulence and grandeur.

PËRFUNDIM

Po qe se nuk ndërmerren hapat e domosdoshëm, nëse nuk paraqiten zgjidhje të qenësishme, shekulli i 21-të do të vazhdojë të jetë kohë terrori dhe dhune, pikërisht sikur që ishte shekulli i 20-të para tij. Prandaj, lufta ideologjike kundër terrorizmit duhet të fillojë me nguti të madhe, të përfshijë numër të madh njerëzish. Kjo luftë do të bëhet në rrafshin e ideve – midis njerëzve të cilët besojnë në moralin e vërtetë fetar, të cilët janë të dashur, falës, të mëshirshëm dhe që kanë në zotërim të plotë ndërgjegjet e tyre dhe atyre që fuqinë e tyre e nxjerrin nga mosdija, mendjemadhësia dhe dhuna.

Në një ajet të shenjtë (Sure Hud: 116), Zoti ynë pyet: **“E përse të mos ketë pasur nga breznitë që ishin para jush, të zotët e mendjes e të nderit që të ndalonin çrregullimin e kaosin në tokë...”** Besimtarët duhet ta posedojnë vetinë që përshkruan Zoti në këtë ajet. Ndërsa terroristët shpresojnë të arrijnë qëllimet e tyre me anë të dhunës, besimtarët duhet ta dinë se suksesi i vërtetë mund të arrihet vetëm duke u kapur fort pas religjionit të Zotit dhe duke vepruar në pajtim me të. Po qe se Çifutët, të Krishterët dhe Myslimanët bashkohen në këtë luftë, në frymën e respektit për të gjitha besimet dhe idetë dhe me vullnetin e Zotit, do të gëzojnë sukses përfundimtar.

Një terrorist mund të mësoj përmendësh të gjitha burimet fundamentale që qëndrojnë pas besimeve të tij. Megjithatë, një person i tillë nuk është i vetëdijshëm për një të vërtetë të qartë që atij do t'i sjellë lumturi dhe frymëzim, si në këtë botë ashtu

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

edhe në botën tjetër. Kjo për arsye se tërë jetën e tij, ai është edukuar me ideologji radikale, në kontekstin e idesë se jeta është një fushëbetejë në të cilën vetëm i fuqishmi mbijeton, ku dhuna dhe zgjedha janë mënyrat e vetme të mbijetesës. Çdokush që gjen mbështetje në terrorizëm, pa marr parasysh fenë, racën apo kombin e tij, duhet të kuptoj se po vepron nën ndikimin e një filozofie çorientuese, që në një analizë përfundimtare buron prej mendimit materialist dhe Darwinist, edhe pse ajo ndonjëherë paraqitet si ide fetare.

Ata të cilët i drejtohen terrorizmit laik nuk janë të vetëdijshëm se Zoti dhe ahireti ekzistojnë me të vërtetë, se kjo botë është thjeshtë një vend sprove dhe se vetëm ata të cilët besojnë dhe zbatojnë obligimet e tyre fetare me devotshmëri do të jenë të shpëtuar. Ata të cilët i drejtohen gjoja terrorizmit "fetar", janë shumë larg të kuptuarit të urdhrave të Zotit kundër keqbërjes dhe vlerës së jetës njerëzore, sikurse " ... Nëse dikush mbytet një njeri tjetër – përveç nëse hakmerret për dikend tjetër apo për shkak se ka shkaktuar korrupsion në tokë – është sikurse të kishte mbytur gjithë njerëzimin. Dhe nëse dikush e shpëton një njeri tjetër, është sikurse ta kishte shpëtuar tërë njerëzimin. " (Kuran 5: 32)

Në këtë pikë, një përgjegjësi e madhe bie mbi të gjithë besimtarët e singertë, pa marr parasysh se cilës fe i takojnë. Çifutët nuk duhet të shpërfillin thëniet e Dhiatës së Vjetër që u bëjnë thirrje njerëzve për paqe dhe tolerancë dhe ata duhet t'u bëjnë thirrje të gjithë Çifutëve tjerë t'i kundërvihen terrorizmit – duke përfshirë terrorizmin shtetëror të zbatuar nga Izraeli në territoret e okupuara. Po ashtu të Krishterët duhet t'u bëjnë thirrje të gjithë të Krishterëve tjerë, duke marrë si udhërrëfyes të vetin moralin me të cilin Zoti




VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

është më së shumti i kënaqur. Ata duhet po ashtu të theksojnë se **“lufta mbi terrorin” nuk duhet të shëndrrohet në një hakmarrje të dhunshme dhe se një “kundër-terrorizëm” paqësor duhet të parapëlqehet, pasi që besimi i Krishterë shpall: “Lum ata që përpiqen për paqen” (Mateu: 5: 9).** Njeriu nuk duhet të harroj se terrorizmi buron nga idetë e gabueshme dhe se lufta kryesore kundër terrorizmit duhet të zhvillohet në rrafshin e ideve. Besimtarët duhet të shpjegojnë se këto ide janë të gabueshme si për nga teoria e tyre ashtu edhe për nga praktika. Asnjë ide nuk mund të mbisundojë me ndihmën e dhunës, shtypjes dhe egërsisë dhe tirania kurrë nuk mund të triumfoj.

Ideologjia terroriste është e ndërtaur mbi rërë. Themelet e saj mund të fshihen lehtë me anë të vënies në lëvizje të një fushate të përshtatshme edukative. Pasi që besimtarët në të gjitha pjesët e botës mund të ndihmojnë t'i jepet fund mosdijes që ngjall terrorizmin duke kërkuar zgjidhje, duke shkruar libra dhe artikuj, duke promovuar aktivitete edukative dhe duke përhapur trashëgiminë e tyre kulturore.





MASHTRIMI I EVOLUCIONIT

Darvinizmi, me fjalë të tjera teoria e evolucionit, u prezantua me qëllim të mohimit të faktit të krijimit, por që në të vërtetë nuk është asgjë përveç një marrëzi e dështuar joshkencore. Kjo teori, e cila pretendon se jeta lindi rastësisht nga materia e pajetë, u zhvlerësua nga faktet shkencore të “projektimit” të qartë në gjithësi dhe në gjërat e gjalla. Në këtë mënyrë, shkencë vërtetoi se Allahu krijoi gjithësinë dhe gjallesat në të. Propaganda e zhvilluar sot për të mbajtur në jetë teorinë e evolucionit mbështetet kryekëput në shtrembërimin e fakteve shkencore, interpretimin e paragjykuar dhe gënjeshttrat dhe pavërtetësitë e maskuara si shkencë.

Mirëpo kjo propagandë nuk mund ta fsheh të vërtetën. Fakti

se teoria e evolucionit është mashtrimi më i madh në historinë e shkencës ka ardhur në shprehje shumë e më shumë në botën shkencore gjatë 20-30 viteve të fundit. Hulumtimet e bëra pas viteve të 80-ta në veçanti kanë zbuluar se pohimet e Darwinizmit janë krejtësisht të pabaza, gjë që është thënë nga një numër i madh i shkencëtarëve. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti, shumë shkencëtarë prej fushave të ndryshme biologjia, biokimia dhe paleontologjia pranojnë gjyminë e Darwinizmit dhe e përdorin konceptin e projektimit inteligjent për të shpjeguar zanafillën e jetës. Ky “projektim inteligjent” është një shprehje shkencore e faktit se Allahu i krijoi të gjitha gjallesat.

Ne kemi ekzaminuar rënien e teorisë së evolucionit dhe provat e krijimit në mënyrë shumë të hollësishme shkencore në shumë prej punimeve tona dhe vazhdojmë ta bëjmë këtë. Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, do të jetë shumë e dobishme që ta bëjmë një përmbledhje të saj këtu.

DËSHTIMI SHKENCOR I DARVINIZMIT

Teoria e evolucionit, edhe pse është një doktrinë që i ka fillimet në Greqinë e lashtë, u përqaftua gjerësisht në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Zhvillimi më i rëndësishëm që e bëri teorinë temën kryesore të botës së shkencës ishte botimi në vitin 1859 i librit Origjina e Llojeve të Çarlls Darvinit. Në këtë libër, ai doli me pretendimin se llojet e ndryshme në tokë nuk janë krijuar veç e veç, por rrjedhin nga një stërgjysh i përbashkët dhe kanë

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

ndryshuar nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla me kalimin e kohës. Teoria e Darvinit nuk mbështetet në asnjë zbulim shkencor konkret, siç e pranoi edhe ai vet, ajo ishte vetëm një “supozim”. Veç kësaj, ashtu siç e pranoi Darvini në kapitullin e gjatë të librit të tij të titulluar “Vështirësitë e Teorisë”, teoria dështoi përballë një sërë çështjesh vendimtare.

Darvini mbështeti të gjitha shpresat e tij në zbulimet e reja shkencore, të cilat shpresonte që do të zgjidhnin këto vështirësi. Mirëpo, në kundërshtim me atë që ai shpresonte, zbulimet shkencore zgjeruan përmasat e këtyre vështirësive. Disfata e darvinizmit përballë shkencës mund të përmbliidhet në tre tituj kryesorë:

- 1) Teoria nuk arrin të shpjegoj se si ka zënë fill jeta në tokë.
- 2) Nuk gjendet asnjë zbulim shkencor që tregon se “mekanizmat e evolucionit” të propozuara nga kjo teori, posedojnë asnjë force evoluese.
- 3) Të dhënat fosile provojnë pikërisht të kundërtën e ideve të parashtruara nga kjo teori.

Në këtë pjesë, do të shtjellojmë në vija të përgjithshme këto tri çështje themelore:



Charles Darwin

PENGESA E PARË E PAKAPËRCYESHME: ZANAFILLA E JETËS

Teoria e evolucionit pretendon se të gjitha speciet rrjedhin nga një qelizë e vetme e shfaqur në Tokën primitive 3.8 miliardë vjet më parë. Si është e mundur që një qelizë e vetme të ndërtojë miliona specie të gjalla e të komplikuar dhe, nëse me të vërtetë ka ndodhur diçka e tillë, përse nuk gjendet asnjë gjurmë në të dhënat fosile janë disa nga pyetjet në të cilat teoria nuk është në gjendje të jap përgjigje. Por në fillim, duhet të pyetemi: Si u krijua kjo “qelizë e parë”?

Meqë teoria e evolucionit e mohon krijimin dhe çfarëdo ndërhyrje të mbinatyrshme, ajo supozon se “qeliza e parë” është shfaqur rastësisht pa asnjë projektim, planifikim apo rregullim, përbrenda ligjeve të natyrës. Sipas kësaj teorie, materia e pajetë duhet të ketë krijuar rastësisht qelizën e gjallë. Por kjo hipotezë bie ndesh me ligjet më të pakundërshtueshme të biologjisë.

“JETA RRJEDH NGA JETA”

Darvini, në librin e tij, nuk ka folur kurrë mbi zanafillën e jetës. Koncepti primitiv shkencor në periudhën kur jetoi ai supozonte se gjallesat zotërojnë një konstrukt shumë të thjeshtë. Sipas teorisë së krijimit të rastësishme që besohet në mesjetë, lëndët e pajetë/inorganike, duke u bashkuar, mund të formojnë një qenie të gjallë. Në atë periudhë ishte shumë i përhapur mendimi se insektet formoheshin nga tepricat e ushqimeve, ndërsa minjtë nga gruri. Për të provuar diçka të tillë janë bërë

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT



eksperimente nga më të çuditshmet: Një leckë e ndotur me pak grurë mbi të, në një anë, ndërsa në anën tjetër një shkencëtar, duke pritur që pas një kohe të formoheshin minj.

Gjithashtu mendohej se shfaqja e krimbave në një copë mishi ishte dëshmi e krijimit të vetvetishëm/spontan. Por më vonë do të kuptohej se ata krimba nuk formoheshin vetvetiu në mish, por nga larvat e padukshme për syrin që silleshin nga mizat.

Madje edhe kur Darvini shkroi librin Origjina e Llojeve, besimi se bakteret formoheshin nga materia e pajetë ishte një gjë e pranuar gjerësisht në botën e shkencës.

Por vetëm 5 vite pas botimit të librit të Darvinit, Lui Paster shpalli përfundimet e arritura pas shumë studimeve dhe eksperimenteve të gjata që rrëzuan plotësisht krijimin spontan, i cili përbënte gur themelin e teorisë së Darvinit. Në ligjëratën e tij triumfale në Sorbonë në vitin 1864, Pasteri tha: “Kurrë më nuk do të rimarr veten krijimi spontan prej grushtit vdekjeprurës të dhënë nga ky eksperiment i thjeshtë.”⁶⁴

Mbrojtësit e teorisë së evolucionit i kundërshtuan për një kohë të gjatë zbulimet e Pasterit. Mirëpo shkenca, e cila po përparonte duke nxjerrë në dritë ndërtimin kompleks të qelizës së organizmit të gjallë, e përforcoi edhe më tepër pavlefshmërinë e pretendimeve mbi krijimin e rastësishëm të jetës.

PËRDPJEKJET E PAFRYTSHME TË SHEKULLIT NJËZET

Evolucionisti i parë, i cili u mor me çështjen e zanafillës së jetës në shekullin e njëzet ishte biologu i njohur rus Aleksandër Oparin, i cili u mundua të provonte, me anë të një sërë tezash të hedhura nga vetë ai në vitet 1930, se qeliza e gjallë mund të krijohet rastësisht. Por këto punime do të dilnin të pasuksesshme dhe Oparin do të detyrohej ta bënte këtë rrëfim:

Mirëpo, fatkeqësisht, çështja e zanafillës së qelizës përbën ndoshta pikën më të errët të gjithë studimit të evolucionit të organizmave.⁶⁵

Pasuesit evolucionist të Oparinit u munduan të bënin eksperimente për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Më i njohuri nga këto eksperimente ishte ai që u ndërmor në vitin 1953 nga kimisti amerikan Stenli Miler, i cili, duke bashkuar gazrat, që ai pretendonte se kishin ekzistuar në atmosferën primitive në një ambient eksperimental dhe duke i ekspozuar ato ndaj një burimi të jashtëm energjie, Milleri formoi disa molekula organike (aminoacide) të pranishme në strukturën e proteinave.

Mezi kishin kaluar disa vite para se të zbulohesh se ky eksperiment, i cili atëherë u paraqit si një hap i rëndësishëm në emër të evolucionit, ishte i pavlefshëm, sepse atmosfera e përdorur

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

në këtë eksperiment ishte shumë më e ndryshme nga kushtet reale të Tokës. ⁶⁶

Pas një periudhe të gjatë heshtjeje, Milleri pranoi se atmosfera e përdorur nga ai nuk ishte reale. ⁶⁷

Të gjitha përpjekjet evolucioniste që u ndërmorën gjatë shekullit të njëzet për të shpjeguar zanafillën e jetës përfunduan pa sukses. Xhefri Bada, gjeo-kimisti i njohur nga Instituti Skrips i San Diegos, në një artikull të botuar në vitin 1998 në revistën "Earth (Toka)", pranon këtë fakt:

Sot, duke e lënë pas shekullin e njëzet, akoma përballemi me problemin më të madh të pazgjidhur që kishim kur hymë në shekullin e njëzet: Si zuri fill jeta në tokë? ⁶⁸

NDËRTIMI I NDËRLIKUAR I JETËS

Shkaku kryesor që çështja mbi zanafillën e jetës ka hyrë në një dilemë të tillë është se madje ata organizma të gjallë që mendohej të jenë më të thjeshtat kanë ndërtim jashtëzakonisht të ndërlikuar. Qeliza e një gjallese është shumë më e ndërlikuar se të gjitha produktet teknologjike që ka arritur të prodhojë njeriu. Sot, madje edhe në laboratorët më të përparuar të botës, duke bashkuar materie kimike organike, nuk do të mund të arrijmë kurrë të përfitojmë një qelizë të vetme.

Kushtet që nevojiten për formimin e një qelize janë aq të shumta sa kurrë nuk mund të shpjegohen me rastësi. Probabiliteti që proteinat, njësia bazë e qelizës, të sintetizohen rastësisht është 1 në 10^{950} (për një proteinë mesatare me 500 aminoacide). Në matematikë probabilitetet më të vogla se 10^{50} konsiderohen të pamundura.

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

Molekula e ADN-së përmban informacionet gjenetike si një bankë informacionesh me kapacitet të pabesueshëm. Nëse do ta hidhnim në letër informacionin që përfshin ADN-ja e njeriut, do të krijohesh një bibliotekë me 900 volume enciklopedike me nga 500 faqe secili.

Në këtë pikë shfaqet një dilemë shumë interesante: ADN-ja mund ta kopjoj/përsëris vetveten vetëm me ndihmën e disa proteinave të specializuara (enzimave). Mirëpo, sinteza e këtyre enzimave mund të realizohet vetëm me anë të informacionit të koduar në ADN. Pasi që ato të dyja janë të varura nga njëra tjetra, ato duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë për kopjim/përsëritje. Kjo e sjellë skenarin se jeta ka zënë fill vetvetiu në një rrugë pa krye. Prof. Lesli Orgel, një evolucionist me reputacion nga Universiteti i San Diegos në Kaliforni, e pranon këtë fakt në botimin e revistës *Scientific American* të Shtatorit të vitit 1994:

Është krejtësisht e pamundshme që proteinat dhe acidet nukleike, duke qenë të dyja komplekse për nga ndërtimi, të jenë krijuar vetvetiu në të njëjtin vend dhe në të njëjtën kohë. Po ashtu duket e pamundshme ta kemi njëzën pa tjetrën. Dhe kështu, në shikim të parë, njeriut do t'i duhej të vjen në përfundimin se, në të vërtetë, jeta kurrë nuk ka mundur të zë fill me anë të mjeteve kimike.⁶⁹

Padyshim, nëse është e pamundur që jeta të ketë zënë fill nga shkaqet natyrore, atëherë duhet të pranohet se jeta u "krijua" në mënyrë të mbinatyrshme. Ky fakt zhvlerëson në mënyrë të qartë teorinë e evolucionit, qëllimi kryesor i së cilës është të mohoj krijimin.

MEKANIZMAT IMAGJINARË TË EVOLUCIONIT

Çështja e dytë e rëndësishme që e bën teorinë e Darvinit të pavlefshme është se të dy konceptet e paraqitura nga kjo teori si “mekanizma të evolucionit”, u kuptua se në të vërtetë nuk zotërojnë asnjë forcë evoluese.

Darvini e mbështeti hipotezën e tij në tërësi në mekanizmin e “seleksionimit natyror.” Rëndësia që i jepte këtij mekanizmi mund të kuptohet fare lehtë edhe nga titulli i librit të tij: Origjina e Llojeve nëpërmjet seleksionimit natyror”...

Seleksionimi natyror pohon se ato gjallesa që janë më të fuqishme dhe që i përshtaten më mirë kushteve natyrore të vendbanimeve të tyre do të mbijetojnë në luftën për jetë. P.sh., në një kope sorkadhesh që kërcënohet prej kafshëve të ndryshme grabitqare, do të mbijetojnë vetëm ato sorkadhe që vrapojnë më shpejt. Kështu që kopeja e sorkadheve do të përbëhet nga individët më të fortë dhe më të shpejtë. Mirëpo, sigurisht që ky mekanizëm nuk mund të shkaktojë evoluimin e sorkadheve e t'i kthejë në një lloj tjetër gjallese, për shembull, në kuaj.


Për këtë arsye, mekanizmi i seleksionimit natyror nuk zotëron asnjë forcë evoluese. Edhe Darvini ishte i ndërgjegjshëm për këtë realitet, ndaj në librin e tij Origjina e Llojeve u detyrua të pohonte:

Seleksionimi natyror s'mund të bëjë asgjë përderisa nuk shfaqen dallime dhe ndryshime të dobishme individuale.⁷⁰

NDIKIMI I LAMARKUT

Si mund të formoheshin këto ndryshime të dobishme? Darvini, kësaj pyetjeje u mundua t'i përgjigjej nga këndvështrimi

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)



i të kuptuarit primitiv të shkencës së asaj kohe. Sipas biologut francez Shevalie Lamark (1774-1829), i cili ka jetuar para Darvinit, gjallesat ia përcollën brezit pasardhës të gjitha ndryshimet fizike, të cilat kishin fituar gjatë jetës së tyre. Ai pohonte se këto cilësi, të cilat u akumuluan nga një brez në tjetrin, bënë që të formohen specie të reja. Për shembull, ai pohonte se gjirafat evoluuan nga antilopat gjatë përpjekjeve të tyre për të arritur gjethet e pemëve të larta, qafat e tyre u zgjatën nga njëri brez në tjetrin

Edhe Darvini ka dhënë shembuj të ngjashëm. Në librin e tij Origjina e Llojeve, për shembull, ai thotë se disa arinj për të gjetur ushqim në thellësi të detit me kohë u shëndrruan në balena.⁷¹

Por zbulimet e Gregor Mendelit (1822-1884) të ligjeve të trashëgimisë, të cilat u saktësuan nga shkenca e gjenetikës, e cila lulëzoi në shekullin e njëzet, hedhën poshtë plotësisht legjendën

VETËM DASHURIA MUND T'Ë SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

e përcjelljes së karakteristikave të fituara në brezat pasardhës. Kështu, u vërtetua përfundimisht se seleksionimi natyror ishte një mekanizëm joefektiv.

NEO-DARVINIZMI DHE MUTACIONET

Për të gjetur një zgjidhje, darvinistët nxorën në dritë "Teorinë Sintetike Moderne", apo siç njihet ndryshe Neo-Darvinizmin, në fund të viteve 1930. Neo-Darvinizmi shtoi mutacionet, të cilat janë shtrembërime të formuara në gjenet e gjallesave për shkak të faktorëve të tillë të jashtëm si rrezatimi apo gabimet në përsëritje, si "shkaqe të ndryshimeve të dobishme" përveç mutacionit natyror.

Modeli, i cili edhe sot e ruan vlerën në emër të evolucionit, është Neo-Darvinizmi. Sipas kësaj teorie miliona gjallesa në botë u formuan si rezultat i një procesi me anën e të cilit organe të shumta komplekse të këtyre organizmave (p.sh., veshët, mushkëritë dhe krahët) iu nënshtruan "mutacioneve," domethënë çrregullimeve gjenetike. Por ekziston një fakt i prerë shkencor që plotësisht e hedh poshtë këtë teori: Mutacionet nuk i zhvillojnë gjallesat, përkundrazi, ato janë gjithmonë të dëmshme.

Arsyeja për këtë është shumë e thjeshtë: ADN-ja zotëron një ndërtim shumë të ndërlikuar dhe çdo ndikim spontan mbi këtë molekulë, mund vetëm t'i shkaktojë dëm asaj. Gjenetisti amerikan B. G. Ranganathan e shpjegon këtë fakt si në vazhdim:

Së pari, mutacionet e vërteta janë shumë të rralla në natyrë. Së dyti, shumica e mutacioneve janë të dëmshme pasi që janë të rastësishme, më parë se ndryshime të rregullta në strukturën e gjeneve; çfarëdo ndryshimi i rastësishëm në një sistem tejet të rregullt do të ndikojë për të keq, jo për të mirë. Për

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

shembull, nëse një tërmet do të dridhte një ndërtim tejet të rregullt siç është një ndërtesë, do të ndodhte një ndryshim i rastësishëm në kornizën e ndërtesës, i cili sipas të gjitha gjasave, nuk do të ishte një përmirësim.⁷²

Nuk çudit fakti se deri më sot nuk është vëzhguar asnjë rast i ndonjë mutacioni të dobishëm, domethënë, i cili është parë të zhvilloj kodin gjenetik. Është vërtetuar se të gjitha mutacionet janë të dëmshme. Është kuptuar se mutacioni, i cili është paraqitur si një “mekanizëm i evolucionit,” është në të vërtetë një dukuri gjenetike që dëmton gjallesat dhe i lë të gjymtuara. (Efekti më i zakonshëm i mutacionit në qeniet njerëzore është kanceri.) Natyrisht, një mekanizëm shkatërrues nuk mund të jetë “mekanizëm evolutiv.” Seleksionimi natyror, në anën tjetër,



Crippled babies who were born in the aftermath of the Chernobyl disaster. This picture reveals that mutations, which evolutionists claim have an effect on the origins of living things, actually have disastrous effects on human beings.

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

“s’ mund të bëj asgjë i vetëm,” siç e pranoi edhe Darvini. Ky fakt na tregon se nuk ekziston ndonjë “mekanizëm evolutiv” në natyrë. Pasi që nuk ekziston asnjë mekanizëm evolutiv, asnjë proces i tillë i imagjinuar i quajtur “evolucion” nuk ka mundur të ndodhë.

TË DHËNAT FOSILE: ASNJË GJURMË E FORMAVE KALIMTARE

Të dhënat fosile janë treguesi më i qartë se skenari që sugjerohet nga teoria evolucionit nuk ka ndodhur kurrë.

Sipas kësaj teorie, të gjitha gjallesat kanë evoluar nga një paraardhës. Një specie, e cila ekzistonte më parë, me kalimin e kohës, u shëndrrua në diçka tjetër dhe të gjitha speciet u krijuan në këtë mënyrë. Me fjalë të tjera, ky transformim u zhvillua gradualisht gjatë një periudhe të gjatë prej qindra miliona vjetësh.

Po të kishte qenë kështu, lloje të shumta kalimtare duhej të kishin ekzistuar dhe jetuar brenda kësaj periudhe të gjatë transformimi.

Për shembull, disa krijesa gjysmë peshk–gjysmë zvarranik duhej të kishin jetuar në të kaluarën të cilat kishin fituar disa tipare zvarranikësh, përveç tipareve të peshkut të cilat ato tashmë i kishin. Apo duhej të kishin ekzistuar disa zvarranik-zogj, të cilët fituan disa tipare të zogjve përveç tipareve të zvarranikëve që ato tashmë i kishin. Meqë këto gjallesa do të duhej të kishin ekzistuar në një periudhë kalimtare, gjallesat duhet të kenë qenë të gjymtuara dhe me një sërë të metash. Evolucionistët, këto qenie imagjinare që besojnë të kenë jetuar në të kaluarën, i quajnë “forma kalimtare”.

LIVING FOSSILS REFUTE EVOLUTION

Fossils are proof that evolution never happened. As the fossil record shows, living things came into being in a single moment, with all the characteristics they possess and never altered in the least for so long as the species survived. Fish have always existed as fish, insects as insects and reptiles as reptiles. There is no scientific validity to the claim that species develop gradually. Almighty Allah created all living things.



A 54-to-37-million-year-old fossil sunfish



A 295-million-year-old fossil sea urchin



A 125-million-year-old fossil cicada



A 50-million-year-old fossil sequoia leaf

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

Nëse me të vërtetë do të kishin ekzistuar gjallesa të tilla në të kaluarën, atëherë do të duhej të kishte me miliona dhe madje miliarda sosh për nga numri dhe llojllojshmëria. Ajo që është më me rëndësi, mbetjet e këtyre qenieve të çuditshme do të duhej të haseshin në të dhënat fosile. Darvini, në librin Origjina e Llojeve, këtë fakt e shpjegon kështu:

Nëse teoria ime është e vërtetë, atëherë forma kalimtare të panumërta që lidhin speciet e të njëjtit grup, duhet të kenë ekzistuar sigurisht... Si rrjedhim, provat për ekzistencën e tyre të mëparshme do të mund të gjendeshin vetëm në mbetjet fosile.”⁷³

One of the facts nullifying the theory of evolution is the incredibly complex structure of life. The DNA molecule located in the nucleus of cells of living beings is an example of this. The DNA is a sort of databank formed of the arrangement of four different molecules in different sequences. This databank contains the codes of all the physical traits of that living being. When the human DNA is put into writing, it is calculated that this would result in an encyclopedia made up of 900 volumes. Unquestionably, such extraordinary information



SHPRESAT E VENITURA TË DARVINIT

Mirëpo, edhe pse janë bërë shumë kërkime intensive për të gjetur fosilet që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në mbarë botën, ende nuk është gjetur asnjë formë kalimtare. Të gjitha fosilet, në kundërshtim me atë që shpresonin evolucionistët, tregojnë se jeta në Tokë u shfaq rastësisht, krejt papritur dhe plotësisht e formuar.

Një paleontolog i njohur britanik, Derek V. Ager, edhe pse një evolucionist, e pranon këtë realitet:

Problemi ynë është ky: Tek analizojmë me hollësi të dhënat fosile në nivelin e klasave apo llojeve, hasim gjithmonë e më tepër jo evolucion gradual, por shpërthim të papritur të një lloji në llogari të një tjetri.⁷⁴

Me fjalë të tjera, te fosilet e gjetura, të gjitha llojet e gjallesave shfaqen papritmas dhe në formën e tyre të përfunduar, pa asnjë formë të ndërmjetme në mes. Kjo është pikërisht e kundërta e supozimeve të Darvinit. Për më tepër, kjo është një provë shumë e fortë që gjallesat janë krijuar. I vetmi shpjegim që një specie e gjallë të shfaqet papritmas e plotë dhe pa paraardhës nga i cili të ketë evoluar është se ajo u krijua. Kjo e vërtetë është pranuar po ashtu nga biologu i mirënjohur evolucionist Douglas Futuyuma:

Krijimi dhe evolucionin janë dy shpjegimet e vetme që mund të bëhen rreth origjinës së qenieve të gjalla. Krijimi dhe evolucionin, në mes tyre, shter shpjegimet e mundshme për zanafillën e gjallesave. Organizmat ose janë shfaqur në tokë të zhvilluara plotësisht, ose jo. Në rast se nuk janë zhvilluar gradualisht, ato duhet të jenë zhvilluar nga specie që kanë

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

ekzistuar më parë me anë të ndonjë procesi modifikimi. Në rast se janë shfaqur plotësisht të zhvilluara, ato me të vërtetë duhet të jenë krijuar nga ndonjë intelekt i plotfuqishëm.⁷⁵

Fosilet tregojnë se qeniet e gjalla u shfaqën në Tokë të formuara plotësisht dhe në gjendje të përkryer. Me fjalë të tjera “origjina e llojeve,” në kundërshtim me supozimin e Darvinit, nuk është evolucioni, por krijimi.

PËRRALLA E EVOLUCIONIT TË NJERIUT

Çështja që trajtohet më shpesh nga mbrojtësit e teorisë së evolucionit është prejardhja e njeriut. Mendimi darvinist mbi këtë çështje thotë se qeniet njerëzore moderne që jetojnë sot kanë evoluar nga disa krijesa të ngjashme me majmunët. Gjatë kësaj periudhe të supozuar, e cila mendohet të ketë filluar rreth 4-5 milionë vjet më parë, pretendohet se kanë jetuar “forma kalimtare” midis njeriut modern dhe të parëve të tij. Ka katër “kategori” bazë në gjithë këtë skenar të imagjinuar:

1. Australopiteku
2. Homo habilis
3. Homo erektus
4. Homo sapiens

Evolucionistët i japin emrin “Australopitek” (që do të thotë “majmuni i jugut”), të ashtuquajturit paraardhës të parë të njeriut të ngjashëm me majmunët. Këto qenie të gjalla nuk janë në fakt asgjë tjetër, përveçse një specie e zhdukur majmuni. Kërkimet e shumta të Lordit Solli Cukerman dhe Profesorit Çarlls Oksnard, dy anatomistë me famë botërore nga Anglia dhe ShBA-ja, rreth mbetjeve të australopitekëve tregojnë se këto qenie i përkisnin një

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

lloji të majmunit të zhdukur dhe se nuk kishin asnjë ngjashmëri me qeniet njerëzore. ⁷⁶

Evolucionistët e quajnë fazën tjetër të evolucionit njerëzor “homo,” domethënë “njeri”. Sipas këtij pretendimi, qeniet e gjalla të serisë “homo” ishin më të zhvilluara se australopitekët. Evolucionistët i vendosën fosilet e këtyre krijesave të ndryshme pranë njëra-tjetrës me një renditje të caktuar dhe përpiluan një plan imagjinar evolucionari. Ky plan është imagjinar, sepse faktikisht asnjë lidhje evolucionare mes këtyre klasave të ndryshme nuk është provuar. Ernst Majër, njëri prej mbrojtësve më të rëndësishëm të teorisë së evolucionit në shekullin e njëzet në librin e tij *Një argument i gjatë* pohon se: “në veçanti (enigmat) historike si zanafilla e jetës apo e Homo sapiensit, janë tejet të vështira dhe mund madje t’i bëjnë ballë një shpjegimi përfundimtar të kënaqshëm.” ⁷⁷



Evolutionist newspapers and magazines often print pictures of primitive man. The only available source for these pictures is the imagination of the artist. Evolutionary theory has been so dented by scientific data that today we see less and less of it in the serious press.

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

Kur bëjnë zinxhirin Australopitek > Homo Habilis > Homo Erektus > Homo Sapiens, evolucionistët nënkuptojnë se këto specie kanë qenë paraardhëse të njëra-tjetrës. Mirëpo, zbulimet më të fundit të paleo-antropologëve tregojnë se Austrolopiteku, Homo Habilis dhe Homo Erektus kanë jetuar në të njëjtën periudhë në pjesë të ndryshme të botës.⁷⁸

Për më tepër, një segment i caktuar njerëzish i klasifikuar si Homo Erektus ka jetuar deri në kohërat moderne. Homo sapiens, Neandertalët dhe Homo Sapiens Sapiens (njeriu modern) kanë bashkëjetuar në të njëjtin rajon.⁷⁹

Kjo, sigurisht, provon përfundimisht se këto specie nuk ishin paraardhëse të njëra-tjetrës. Stefën Xhej Gould, njëri prej paleontologëve të universitetit të Harvardit, megjithëse është evolucionist, e shpjegon qorrkakun në të cilin gjendet teoria darviniste në këtë mënyrë:

Çfarë i ndodhi shkallës sonë, nëse bashkekzistojnë tri linja hominide (A. Afrikanus, Robust Australopitekët robust (shtatmëdhenj) dhe H. Habilis) që nuk rrjedhin nga njëra-tjetra? Për më tepër, asnjë nga të tre nuk shfaq ndonjë tendencë evolutive gjatë qëndrimit të tyre në tokë.⁸⁰

Me pak fjalë, i gjithë skenari i evolucionit njerëzor që po mbahet gjallë me ndihmën e vizatimeve të ndryshme të krijesave imagjinare “gjysmëmajmun-gjysmënjeri”, që shfaqen në media apo libra shkollorë, domethënë, sinqerisht, me anë të metodave propagandistike, s’janë gjë tjetër veçse një mit pa asnjë bazë shkencore.

Lordi Solli Cukerman, një nga shkencëtarët më të njohur dhe më të spikatur të Mbretërisë së Bashkuar, e ka studiuar këtë

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

çështje për vite me radhë dhe ka kryer një punë kërkimore 15-vjeçare mbi fosilet e Australopitekut. Edhe pse evolucionist, ai arriti në përfundimin se, në të vërtetë, nuk ekziston asnjë pemë gjenealogjike midis majmunit dhe njeriut.

Cukerman gjithashtu bëri një “spektër interesant të shkencave”, duke i radhitur ato nga ato që ai i konsideronte si më shkencoret tek ato që i konsideronte si më joshkencoret. Sipas spektrit të Cukermanit, më “shkencoret,” duke marrë parasysh mbështetjen e tyre në argumente, janë shkenca e fizikës dhe kimisë. Më pas vijnë shkencat biologjike dhe pastaj shkencat shoqërore. Në fund fare, në pjesën që konsiderohet të jetë si pjesa më “joshkencore”, radhitet “perceptimi jashtëshqisor” – konceptet si telepatia dhe shqisa e gjashtë – dhe në fund të fundit u vendos “evolucionit i njeriut”. Cukerman shpjegon kështu arsyetimin e tij:

Më pas zhvendosim regjistrin e të vërtetës objektive në drejtim të atyre fushave të shkencës të konsideruara si shkenca biologjike, si p.sh. perceptimi jashtëshqisor apo interpretimi i historisë së fosileve të njeriut, ku për (evolucionistin) besnik gjithçka është e mundur – dhe ku besimtari i zjarrtë (i evolucionit ndonjëherë është në gjendje të besojë shumë gjëra kontradiktore në të njëjtën kohë.⁸¹

Siç shihet, evolucionit njerëzor nuk është gjë tjetër veçse një përmbledhje e “disa interpretimeve të paragjykuara të fosileve të zhvarrosura prej njerëzve të caktuar, të cilët ndjekin verbërisht teorinë e tyre.

FORMULA E DARVINIT!

Përveç të gjitha provave teknike me të cilat jemi marrë gjer

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

më tani, le ta shtjellojmë njëherë, se çfarë paragjykimi kanë evolucionistët me një shembull të thjeshtë që të kuptohet madje edhe prej fëmijëve:

Teoria e evolucionit pohon se jeta u krijua rastësisht. Sipas këtij pohimi, atomet e pajetë dhe të pavetëdije u bashkuan për të formuar qelizën dhe pastaj ata disi formuan gjallesat tjera, duke përfshirë edhe njeriun. Le të mendojmë për këtë. Kur i bashkojmë elementet që janë bazë e ndërtimit jetës si karboni, fosfori, nitrogjeni dhe potasiumi, vetëm një grumbull formohet. Pa marrë parasysh se çfarë trajtimi i nënshtrohet, ky grumbull atomesh nuk mund të formojë madje as edhe një gjallesë të vetme. Nëse dëshironi, le ta formulojmë një “eksperiment” në lidhje me këtë çështje dhe ta shtjellojmë në emër të evolucionistëve atë që ata vërtet e pohojnë pa e shprehur zëshëm me emrin “formula e Darvinit”:

Le të vendosin materialistët plot materiale të pranishme në përbërjen e gjallesave si fosfori, nitrogjeni, karboni, oksigjeni, hekuri dhe magnezi në fuçi të mëdha. Veç kësaj, le të shtojnë në këto fuçi çfarëdo lloj materiali që nuk ekziston në kushte normale, por që ata mendojmë se është i domosdoshëm. Le të shtojnë në këtë përzierje aq sa të dëshirojnë amino acide – të cilat nuk kanë mundësi të formohen në kushte natyrore – dhe proteina – që një e vetme e ka probabilitetin e formimit 10 në 950 – sa të duan. Le t’ia ekspozojnë këto përzierje deri në masën që dëshirojnë nxehtësisë dhe lagështisë. Le t’i përziejnë këto me çfarëdo pajisje të përparuar teknologjike që të duan. Le t’i vënë shkencëtarët më të shquar pranë këtyre fuçive. Le të presin këta ekspert me radhë pranë këtyre fuçive për miliarda dhe trilionë vite. Le të lejohen të përdorin të gjitha

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

Llojet e kushteve që ata besojnë të jenë të domosdoshme për formimin e një njeriu. Pa marrë parasysh se çfarë bëjnë, ata nuk mund ta krijojnë një njeri prej këtyre fuçive, të themi një profesor që ekzaminon strukturën e qelizës së tij nën një mikroskop elektronik. Ata nuk mund të krijojnë gjirafa, luanë, bletë, kanarina, kuaj, delfinë, trëndafila, orkide, zambakë, karafila, banane, portokaj, molla, hurma, domate, pjepra, shalqi, fiq, ullinj, rrush, pjeshka, pallonj, fazanë, flutura shumëgjyreshe apo me miliona gjallesa si këto. Me të vërtetë, ata nuk do të mund të përfitonin as edhe një qelizë të vetme prej cilësdo prej tyre.

Thënë shkurt, atomet e pavetëdijshme nuk mund të formojnë qelizën duke u bashkuar. Ato nuk mund të marrin një vendim të ri dhe ta ndajnë këtë qelizë më dysh dhe pastaj të marrin vendime tjera dhe të krijojnë profesorët të cilët së pari shpikin mikroskopin elektronik dhe pastaj ekzaminojnë strukturën e qelizës së vet nën atë mikroskop. Materia është një grumbull i pavetëdijshëm, i pajetë dhe ajo vjen në jetë me krijimin e lartë të Allahut.

Teoria e evolucionit, e cila pohon të kundërtën e kësaj, është një gjykim plotësisht i gabuar i kundërt me arsyen. Të menduarit madje edhe vetëm për pak kohë për pohimet e evolucionistëve zbulon këtë të vërtetë, sikurse në shembullin më lartë.

TEKNOLOGJIA E SYRIT DHE VESHIT

Një çështje tjetër që mbetet pa përgjigje nga teoria e evolucionit është cilësia e shkëlqyer e perceptimit të syrit dhe veshit.

Para se të kalojmë te syri, le t'i përgjigjemi shkurtimisht pyetjes "Si shohim ne?" Rrezet e dritës që vijnë nga një objekt,

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

bien në retinën e syrit duke dhënë një imazh të përmbysur të objektit. Këtu, këto rreze drite transformohen në sinjale elektrike nga qelizat dhe pastaj përcillen në një zonë të vogël në pjesën e prapme të trurit, ku ndodhet “qendra e shikimit”. Këto sinjale elektrike perceptohen në këtë qendër të trurit si imazh pas një sërë procesesh. Le të mendojmë pak, duke u bazuar në këto njohuri teknike.

Truri është i izoluar tërësisht nga drita. Kjo do të thotë se pjesa e brendshme e trurit është në errësi të plotë dhe drita nuk arrin atje. Qendra e shikimit është një vend në errësi të plotë ku nuk hyn kurrë dritë. Ka mundësi që të jetë vendi më i errët që ekziston. Megjithatë, ne shikojmë një botë të ndritshme plot dritë në këtë errësi të plotë.

Imazhi i formuar në sy është kaq i mprehtë dhe i qartë, sa që as teknologjia e shekullit njëzet nuk ka arritur ta realizojë. Për shembull, shikoni librin që jeni duke e lexuar, duart me të cilat e mbani atë dhe pastaj ngrini kokën dhe shikoni përreth. A keni parë ndonjëherë një imazh të tillë të mprehtë e të qartë si ky në ndonjë vend tjetër? Edhe ekrani më i zhvilluar i televizorit i prodhuar nga prodhuesi më i fuqishëm i televizorëve në botë nuk mund të sigurojë një imazh aq të mprehtë për ju. Ky është një imazh tre-dimenzional, me ngjyra dhe jashtëzakonisht i pastër. Për vite të tëra, mijëra inxhinierë janë përpjekur të prodhojnë një televizor tre-dimenzional, i cili mund të arrijë cilësinë e shikimit të syrit. Ata kanë arritur të shpikin një sistem TV tre-dimenzional, por ai nuk mund të shihet pa vendosur një palë syze speciale 3-D. Për më tepër, bëhet fjalë vetëm për një tre-dimenzional artificial. Sfondi është më i mjegulluar, ndërsa plani i parë duket sikur

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)



është dekor prej letre. Asnjëherë s'ka qenë e mundur të arrihet një imazh me cilësinë e syrit. Edhe në kamera apo në televizor, ka një humbje të cilësisë së imazhit.

Evolucionistët pretendojnë se mekanizmi që prodhon këtë imazh të mprehtë e të qartë është formuar krejt rastësisht. Nëse dikush do t'ju thoshte se televizori në dhomën tuaj është formuar si rezultat i bashkimit të rastësishëm të miliona atomeve, çfarë do të mendonit ju? Si mund ta bëjnë atomet atë që mijëra njerëz s'e bëjnë dot?

Nëse një pajisje që prodhon një imazh më primitiv se syri nuk mund të jetë formuar rastësisht, atëherë është shumë e qartë që edhe syri apo imazhi që shikohet prej tij nuk mund të jenë krijuar rastësisht. E njëjta gjë vlen edhe për veshin. Veshi i jashtëm i kap

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

tingujt dhe i drejton te veshi i mesëm, i cili ia përcjell veshit të brendshëm duke i përforcuar ato. Veshi i brendshëm ia dërgon valët zanore trurit, duke i kthyer në sinjale elektrike. Ashtu si me shikimin, procesi i dëgjimit përfundon në qendrën e dëgjimit në tru.

Ajo që thamë për syrin është e vërtetë edhe për veshin. D.m.th. truri është i izoluar nga tingujt, ashtu si është i izoluar edhe nga drita: asnjë tingull nuk mund të depërtojë brenda. Prandaj, s'ka rëndësi sa zhurmë ka jashtë, brenda trurit mbizotëron një qetësi absolute. Megjithatë edhe tingujt më të mprehtë perceptohen nga truri.

Nëpërmjet trurit tonë, i cili është i izoluar nga tingujt, ne dëgjojmë simfoninë e ekzekutuar nga një orkestër apo zhurmat në një vend të mbushur plot me njerëz. Megjithatë, nëse bëhet një matje ekzakte e nivelit të tingujve në trurin tonë në këto momente, do të kuptonim se një qetësi absolute mbizotëron aty.

Ashtu si në rastin e imazhit, dekada të tëra përpjekjesh kanë kaluar për të krijuar dhe riprodhuar tinguj sa më të afërt me origjinalin. Rezultatet e këtyre përpjekjeve janë regjistruarit e zërit, sistemet HI-FI dhe sistemet e ndryshme për kapjen e tingujve. Pavarësisht nga teknologjia e përparuar dhe përpjekjet e mijëra inxhinierëve e ekspertëve, nuk është përfituar asnjë tingull që të ketë të njëjtën mprehtësi dhe qartësi si tingulli që kapet nga veshi.

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

Mendoni për sistemet HI-FI të cilësisë më të lartë të prodhuar nga kompania më e madhe e industrisë së muzikës. Edhe në këto pajisje, kur regjistrohet zëri, humbet një pjesë e cilësisë. Kur ndizni një HI-FI gjithmonë dëgjoni një zhurmë të lehtë para se të fillojë muzika. Veshi i njeriut asnjëherë nuk e kap një tingull të shoqëruar me zhurmë; ai e kap tingullin pikërisht ashtu siç është, i mprehtë e i qartë. Kështu ka qenë gjithmonë që nga krijimi i njeriut.

KUJT I TAKON NDËRGJEGJJA QË SHEH DHE DËGJON NË BRENDI TË TRURIT

Kush shikon një botë joshëse në trurin tonë, dëgjon simfonitë dhe cicërimën e zogjve dhe ndien aromën e trëndafilit?

Nxitjet që vijnë prej syve, veshëve dhe hundës së një personi shkojnë në tru si impulse nervore elektro-kimike. Në librat e biologjisë, fiziologjisë dhe biokimisë, mund të gjeni shumë hollësi për mënyrën se si ky imazh formohet në tru. Mirëpo, kurrë nuk do të mund të ndesheni me faktin më të rëndësishëm: Kush i pranon këto impulse nervore elektro-kimike si imazhe, tinguj, aroma dhe ngjarje shqisore në tru? Ekziston një ndërgjegje në tru që i pranon gjithë këto pa ndier ndonjë nevojë për një sy, vesh apo hundë. Kujt i takon kjo ndërgjegje? Natyrisht se nuk u takon nervave, shtresës yndyrore dhe neuroneve që e përbëjnë trurin.

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

Kjo është arsyeja pse darvinistët-materialist, të cilët besojnë se gjithçka përbëhet prej materies, nuk mund të japin përgjigje në këto pyetje.

Sepse kjo ndërgjegje është shpirti i krijuar prej Allahut, i cili nuk ka nevojë as për syrin për të shikuar imazhet dhe as për veshin për t'i dëgjuar tingujt. Për më tepër, nuk ka nevojë për trurin për të menduar.

Çdo njeri që e lexon këtë fakt të qartë shkencor do të duhej të mendonte thellë për Allahun e Gjithëfuqishëm dhe të ketë frikë dhe të kërkoj strehim tek Ai, sepse Ai ngjesh tërë gjithësinë në një vend plotësisht të errët prej disa centimetrave kub në një formë tre-dimensionale, me ngjyra, me hije dhe të ndritshme.

NJË BESIM MATERIALIST

Informacioni që kemi paraqitur deri tani tregon se teoria e evolucionit është një pretendim që bie hapur në kundërshtim me faktet shkencore. Pretendimi i teorisë në lidhje me prejardhjen e jetës është në kundërshtim me shkencën, mekanizmat e evolucionit të propozuara nga kjo teori nuk kanë asnjë forcë evolutive, dhe fosilet tregojnë se format kalimtare nuk kanë ekzistuar kurrë. Prandaj, teoria e evolucionit duhet të hidhet poshtë si një ide joshkencore. Në këtë mënyrë shumë ide, si modeli i gjithësisë me qendër Tokën, janë nxjerrë jashtë agjendës së shkencës gjatë historisë.

Por teoria e evolucionit vazhdon të mbahet me vendosmëri në listën e teorive shkencore. Disa njerëz madje përpiqen t'i paraqesin kritikën në adresë të saj si "sulm ndaj shkencës". Po pse ndodh kjo gjë?

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

Arsyeja për këtë situatë të krijuar është se për disa njerëz të cilët u përkasin disa qarqeve të caktuara, teoria e evolucionit është shëndrruar në një besim dogmatik të domosdoshëm. Këto qarqe kapen fort pas filozofisë materialiste dhe ndikohen nga Darwinizmi, i cili për ta është shpjegimi i vetëm materialist për natyrën.

Nganjëherë ata e pranojnë hapur këtë. Riçard Levontin, gjenetist i famshëm nga universiteti i Harvardit dhe në të njëjtën kohë një evolucionist i njohur pranon se është “së pari materialist, pastaj shkencëtar”:

Nuk është puna se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë të pranojmë një shpjegim material për botën, por përkundrazi, ne jemi të detyruar nga përkrahja jonë arbitrare e kauzës materialiste të krijojmë një aparat hetimi dhe një sërë konceptesh që japin shpjegime materiale, edhe nëse janë kundër intuitës, pa marrë parasysh se sa të mjegullta janë për të panisurën. Për më tepër, materializmi është absolut, kështu që ne nuk mund të lejojmë të dalë në skenë një Qenie Hyjnore.⁸²

Këto fjalë janë deklarata të qarta se Darwinizmi është një dogmë e mbajtur gjallë për hir të lidhjes me filozofinë materialiste. Sipas kësaj dogme asgjë nuk ekziston përveç materies. Prandaj, ajo predikon se materia e pajetë dhe e pavetëdijshme krijoi jetën. Ajo këmbëngul se miliona specie të gjalla, (si zogjtë, peshqit, kafshët, insektet, pemët, lulet, balenat dhe qeniet njerëzore) u shfaqën si pasojë e bashkëveprimit të materies si shiut, rrufeve dhe kështu me radhë prej materies së pajetë. Ky besim është në kundërshtim të plotë si me arsyen ashtu edhe shkencën. Por

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

darwinistët vazhdojnë të mbrojnë këtë besim me qëllim që “të mos lejojnë daljen në skenë të një Qenie Hyjnore.”

Kushdo që nuk e shikon prejardhjen e gjallesave me paragjykim materialist do ta kuptojë këtë të vërtetë të qartë: të gjitha gjallesat janë rezultat i krijimit të një Krijuesi, i Cili zotëron fuqi, dije dhe inteligjencë superiore. Ky Krijues është Allahu, i Cili krijoi tërë gjithësinë nga asgjëja, i Cili e konstrukttoi atë në mënyrën më të përkryer dhe u dha formë të gjitha gjallesave.

TEORIA E EVOLUCIONIT ËSHTË MAGJIA MË E FUQISHME NË BOTË

Çdo njeri i lirë prej paragjykimit dhe ndikimit të çfarëdo ideologjie të caktuar, që përdor arsyen dhe logjikën e tij apo të saj, do të kuptojë qartë se besimi në teorinë e evolucionit, i cili na përkuajt besëtytnitë e shoqërive pa dijeni të shkencës apo qytetërimit, është plotësisht i pamundshëm.

Siç u shpjegua më lartë, ata që besojnë në teorinë e evolucionit mendojnë se disa atome dhe molekula të hedhura në një fuçi të madhe do të mund të krijojnë profesorë dhe studentë universiteti që janë në gjendje të mendojnë dhe gjykojnë; shkencëtarë si Ajnshtajni dhe Galileo; artistë si Hemfri Bogart, Frenk Sinatra dhe Luçano Pavaroti; si edhe antilopa, drunj limoni dhe karafila. Për më tepër, pasi që shkencëtarët dhe profesorët të cilët besojnë në këto gjepura janë njerëz të shkolluar, është krejtësisht e arsyeshme të flitet për këtë teori si për “magjinë më të fuqishme në histori.” Asnjëherë më parë asnjë besim apo ide tjetër nuk u ka larguar aftësinë e të gjykuarit të njerëzve, nuk ka pranuar t'i lejojë ata të mendojnë me mençuri dhe me arsye dhe u ka fshehur

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

të vërtetën sikur ata t'i kishin sytë e lidhur. Kjo është një verbëri madje edhe më e keqe dhe më e pabesueshme se adhurimi i Zotit të Diellit Ra nga egjiptianët, adhurimi i totemeve në disa pjesë të Afrikës, adhurimi i Diellit nga populli i Sabës, adhurimi i idhujve që kishin mbaruar me duart e tyre nga ana e fisit të Profetit Ibrahim (paqja qoftë mbi të) apo adhurimi i Viçit të Artë nga ana e popullit të Profetit Musa (paqja qoftë mbi të).

Në të vërtetë, Allahu ka theksuar këtë mungesë arsyeje në Kuran. Në shumë vargje, Ai zbulon se mendjet e disa njerëzve do të jenë të mbyllura dhe se ata do të jenë të pafuqishme të shohin të vërtetën. Disa nga këto vargje jepen në vazhdim:

E ata që mohuan, për ta është njësoj ua tërhoqe vërejtjen apo nuk ua tërhoqe, ata nuk besojnë. Allahu ua mbylli atyre zemrat, veshët e tyre dhe në të pamurit e tyre ka një perde. Ata do të përjetojnë një dënim të dhimbshëm. (Sure Bekare: 6-7)

...Ata kanë zemra me të cilat nuk kuptojnë. Ata kanë sy me të cilët nuk shohin. Ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur! Ata janë të pavetëdijshëm. (Sure A'raf: 179)

Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e të shihnin engjëjt e fshehtësitë), ata vetëm do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të pamët). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur. (Sure Hixhr: 14-15)

Fjalët nuk mund ta shprehin se sa është e habitshme se si kjo magji ka arritur të mbajë një komunitet aq të gjerë në skllavëri,

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

t'i largojë njerëzit nga e vërteta dhe të mos ndërpritet për 150 vjet. Është e kuptueshme se një apo disa njerëz do të mund të besonin në skenarë dhe pohime të pabesueshme përplot marrëzi dhe paarsyeshmëri. Mirëpo, "magjia" është shpjegimi i vetëm i mundshëm për njerëzit në mbarë botën që besojnë se atomet e pavetëdijshme dhe të pajetë papritur vendosën të bashkohen dhe të formojnë një gjithësi që funksionon me një sistem të organizimit, rregullit, arsyes dhe vetëdijes së përkryer; një planet të quajtur Tokë me të gjitha veçoritë e saj të përshtatura në mënyrë aq të përkryer për jetën; dhe gjallesat përplot sisteme të panumërta komplekse.

Në të vërtetë, Kurani rrëfen ngjarjen e Profetit Musa dhe Faraonit për të treguar se disa njerëz të cilët përkrahin filozofitë ateiste në të vërtetë ndikojnë tek të tjerët me anë të magjisë. Kur iu tha Faraonit për fenë e vërtetë, ai i tha Profetit Musa të ndeshet me magjistarët e tij. Kur Musai e bëri këtë, ai u tha atyre që të tregojnë aftësitë e tyre të parët. Vargjet pasojnë:

Ai (Musai) tha: "Hidhni ju!" E kur hodhën ata (shkopinj e litarë), magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe sollën një magji të madhe. (Sure A'raf: 116)

Siç kemi vënë re, magjistarët e Faraonit ishin në gjendje të mashtrojmë çdo njeri, përveç Musait dhe atyre të cilët i besuan atij. Mirëpo, dëshmia e tij zhduki magjinë, apo "gëlltiti atë që ata kishin sajuar," siç përshkruhet në ajet.

E Ne e frymëzuam Musain (duke i thënë): "Hidhe shkopinj tënd!" Kur ja, ai gëlltiste atë që kishin magjepsur. Atëherë u dëshmuua e vërteta dhe u zhduk ajo që kishin përgatitur. (Sure A'raf: 117-118)

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

Siç kemi vënë re, kur njerëzit e kuptuan se ata u magjepsën dhe se ajo që panë ishte vetëm një iluzion, magjistarët e Faraonit humbën gjithë besueshmërinë e tyre. Edhe në ditët tona, përveç nëse ata të cilët, nën ndikimin e një magjie të ngjashme, besojnë në këto pretendime qesharake nën maskën e tyre shkencore dhe kalojnë jetët e tyre duke i mbrojtur ato, i braktisin besimet e tyre paragjykuese, ata po ashtu do të poshtërohen kur e vërteta e plotë shfaqet dhe magjia prishet. Në të vërtetë, Malkolm Magerixh, një filozof ateist dhe përkrahës i evolucionit, pranoi se ishte i brengosur pikërisht nga kjo perspektivë:

Unë personalisht jam i bindur se teoria e evolucionit, posaçërisht shtrirja e zbatimit të saj, do të jetë njëra prej shakave më të mëdha në librat e historisë në të ardhmen. Brezat e ardhshëm do të çuditen se si një hipotezë aq jobindëse dhe e dyshimtë ka mundur të pranohej me naivitetin e pabesueshëm që ajo posedon.⁸³

Se e ardhmja nuk është larg: Përkundrazi, njerëzit së shpejti do ta shohin se “rasti” nuk është hyjni dhe do të shikojnë prapa në teorinë e evolucionit si në mashtrimin më të keq dhe magjinë më të tmerrshme në botë. Ajo magji tashmë ka filluar të ngritet me shpejtësi prej shpatullave të njerëzve në mbarë botën. Shumë

njerëz që e shohin fytyrën e saj të vërtetë po pyeten me habi se si është e mundur që të jenë kapluar prej saj.

SHËNIMET


1. Vladimir Orlov, Anton Khlophov, Nezavissimaia Gazeta, Moskova, Le Courier International, No: 571, 11-17 October 2001, pp. 99-100
2. Asli Zülal, Biyolojik Silahlar, (Biological Weapons), Bilim ve Teknik, no. 407, October 2001, p.44
3. Asli Zülal, Biyolojik Silahlar, (Biological Weapons), Bilim ve Teknik, no. 407, October 2001, p.44
4. www.terrorismfiles.org/organisations/besque_fatherland_and_liberty.html
5. <http://www.terrorismnews.com/groups/ira.html>
6. www.cia.gov/cia/di/products/terrorism/index.html
7. Patterns of Global Terrorism 2000, Department of State Publication Office, Nisan 2001, www.usisusembse/terror/rpt2000/yearinreview.html
8. www.teror.gen.tr/turkce/rakamlarla/index.html
9. www.worldtrek.org/odyssey/latinamerica/050899/050899team.html (emphasis added)
10. www.worldtrek.org/odyssey/latinamerica/050899/050899team.html
11. Philip Chard, Journal Sentinel, 24 September 2001, <http://www.jonline.com/lifestyle/advice/sep01/charcol25092401a.asp> (emphasis added)
12. John L. Esposito, Islam: The Straight Path, Oxford: Oxford University, England, 1991, p. 33
13. Sahih Bukhari Hadith
14. Prophet Muhammed's Last Sermon
15. Andy Thomas, Islam Insanlignin Ruh (Islam is the Spirit of Humanity), Timas Yayinlari, Istanbul, 1997, p.33
16. H.A.R. Gibb, Whither Islam, London, 1932, p.379.
17. Prof. Robert Briffault, Insanlignin Gelisini (The Making of Humanity), http://www.toluislam.com/Shabbir/SA_WINC_4.htm, Andy Thomas, Islam Insanlignin Ruh (Islam is the Spirit of Humanity), Timas Yayinlari, Istanbul, 1997, p.38
18. Sahih Bukhari, Volume 6, Book 60, Number 362
19. Sahih Bukhari Hadith
20. www.therevivalcoulk.com/articles/hadith_nonviolence.htm
21. Ali Bulac, Cagdas Kavramlar ve Düzenler, Iz yayincilik, 16. Edition, Istanbul, 1998, p. 241
22. Ali Bulac, Cagdas Kavramlar ve Düzenler, Iz yayincilik, 16. Edition, Istanbul, 1998, p. 241
23. Hristiyan Ahlaki, Turgay Ücal, Derek Malcolm, Ön Asya Basim Yayin Dagitim, Eylül 2000, s. 51
24. <http://www.agape-net.org/> (emphasis added)
25. www.therevivalcoulk.com/articles/hadith_nonviolence.htm
26. Timidhi Hadith
27. Sahih Bukhari, Number 91
28. www.dartmouth.edu/~alnur/ISLAM/PROPHET/sayings.htm
29. Sahih Bukhari, Book 8, Number 40
30. Imam Ghazzali's Ihya Ulum-Id-Din, The Book of Religious Learnings, Islamic Book Service, New Delhi, 2001, Volume II, p.240
31. Miskhat Shareef
32. Sahih Muslim Hadith

HARUN YAHYA (ADNAN OKTAR)

33. Maulana Muhammad Manzoor No'mani, Ma'arif Hadith, (Meaning and Message of the Traditions), Darul – Ishaat Publications, Karachi, Volume 4, p.334
34. Shamaa-il Timidhi Contents, (334) Hadith Number 9
35. Shamaa-il Timidhi, Islamic Book Service Publications, New Delhi, 2000, Islamic Book Service, New Delhi, 2000, p. 362
36. Imam Ghazzali's Ihya Ulum-Id-Din (The Book of Religious Learnings), Islamic Book Service, New Delhi, 2001, Volume II, p.68
37. Sahih Bukhari, Islamic Book Service Publications, New Delhi, 2002, Volume 3, p. 597
38. Riyad-us-Saliheen, Volume 2, Compiled by Al-Imam Abu Zakariya Yahya bin Sharaf An-Nawawi Ad-Dimashqi, p. 1330
39. Imam Ghazzali's Ihya Ulum-Id-Din (The Book of Religious Learnings), Islamic Book Service, New Delhi, 2001, Volume III, p.124
40. Imam Ghazzali's Ihya Ulum-Id-Din (The Book of Religious Learnings), Islamic Book Service, New Delhi, 2001, Volume III, p.167
41. Sahih Bukhari Hadith
42. Abu Dawud Hadith
43. Timidhi Hadith
44. Sunan Abu Dawud, Book 41, Number 5097
45. Ahmad, 158/4
46. Bukhari
47. Ahmet Hamdi Akseki, Abdurrahman Azzam Pasa'nin "Allah'in Peygamberlerine emanet ettigi ebedirisalet", Diyanet Isleri Baskanligi Nesriyat, Ankara, 1948, önsöz
48. The Constitution of Madina, [http://www.islamic-study.org/jews-prophet-](http://www.islamic-study.org/jews-prophet-p.-2.htm)
49. The Constitution of Madina, www.islamic-study.org/jews-prophet-p.-2.htm
50. Sir George Bernard Shaw in 'The Genuine Islam,' 1936., <http://www.geocities.com/Athens/Forum/9192/mainquote2.html#shaw>
51. Bediuzzaman Said Nursi, Tarihce-i Hayat, Isparta Hayati, p.2216
52. Bediuzzaman Said Nursi, Emirdag Lahikasi, 2 cilt, p. 200
53. Bediuzzaman Said Nursi, Tarihce-i Hayat, Isparta Hayati, p.2216
54. Bediuzzaman Said Nursi, Emirdag Lahikasi 2, p. 159
55. Bediuzzaman Said Nursi, Tarihce-i Hayat, Isparta Hayati, p.2216
56. Bediuzzaman Said Nursi, Bediuzzaman Cevap Veriyor, pp. 9-10
57. Bediuzzaman Said Nursi, Risale-i Nur Collections, Rays, 11.rays
58. Bediuzzaman, Said Nursi, Risale-i Nur Collections, Rays, 11. Rays
59. Bediuzzaman Said Nursi, Barla Lâhikasi - Takdim, p.1412
60. Bediuzzaman Said Nursi, Risale-i Nur Collections, Rays, 12. Rays
61. Bediuzzaman Said Nursi, Risale-i Nur Collections, Rays, 14. Rays
62. Bediuzzaman, Said Nursi, Risale-i Nur Collections, Rays, 14. Rays
63. Bediuzzaman Said Nursi, Risale-i Nur Kulliyati II, Divan-i Harbi Orfi, Nesil Yayinlari, p. 1921
64. Hugh Ross, The Fingerprint of God, p. 50

VETËM DASHURIA MUND T'I SHKAKTOJË DISFATË TERRORIZMIT

65. Sidney Fox, Klaus Dose, *Molecular Evolution and The Origin of Life*, W.H. Freeman and Company, San Francisco, 1972, p. 4.
66. Alexander I. Oparin, *Origin of Life*, Dover Publications, New York, 1936, 1953 (reprint), p. 196.
67. "New Evidence on Evolution of Early Atmosphere and Life", *Bulletin of the American Meteorological Society*, vol 63, November 1982, p. 1328-1330.
68. Stanley Miller, *Molecular Evolution of Life: Current Status of the Prebiotic Synthesis of Small Molecules*, 1986, p. 7.
69. Jeffrey Bada, *Earth*, February 1998, p. 40
70. Leslie E. Orgel, "The Origin of Life on Earth", *Scientific American*, vol. 271, October 1994, p. 78.
71. Charles Darwin, *The Origin of Species by Means of Natural Selection*, The Modern Library, New York, p. 127.
72. Charles Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 184.
73. B. G. Ranganathan, *Origins?*, Pennsylvania: The Banner Of Truth Trust, 1988, p. 7.
74. Charles Darwin, *The Origin of Species: A Facsimile of the First Edition*, Harvard University Press, 1964, p. 179.
75. Derek A. Ager, "The Nature of the Fossil Record", *Proceedings of the British Geological Association*, vol 87, 1976, p. 133.
76. Douglas J. Futuyma, *Science on Trial*, Pantheon Books, New York, 1983, p. 197.
77. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Tower*, Toplinger Publications, New York, 1970, pp. 75-94; Charles E. Oxnard, "The Place of Australopithecines in Human Evolution: Grounds for Doubt", *Nature*, vol 258, p. 389.
78. "Could science be brought to an end by scientists' belief that they have final answers or by society's reluctance to pay the bills?" *Scientific American*, December 1992, p. 20.
79. Alan Walker, *Science*, vol. 207, 7 March 1980, p. 1103; A. J. Kelso, *Physical Anthropology*, 1st ed., J. B. Lipincott Co., New York, 1970, p. 221; M. D. Leakey, *Olduvai Gorge*, vol. 3, Cambridge University Press, Cambridge, 1971, p. 272.
80. Jeffrey Kluger, "Not So Extinct After All: The Primitive Homo Erectus May Have Survived Long Enough To Coexist With Modern Humans," *Time*, 23 December 1996.
81. S. J. Gould, *Natural History*, vol. 85, 1976, p. 30.
82. Solly Zuckerman, *Beyond The Ivory Tower*, p. 19.
83. Richard Lewontin, "The Demon-Haunted World", *The New York Review of Books*, 9 January, 1997, p. 28

The image is framed by a highly decorative golden border with intricate scrollwork and floral patterns. The central scene depicts a sunlit interior space with a large, domed ceiling. Sunbeams radiate from the top center, illuminating the room. In the foreground, a river flows through a lush green landscape with vibrant purple flowers. To the left, a wooden sofa and a red cushioned bench are visible. In the background, there are arched doorways and windows leading to a bright outdoor area with greenery. The overall atmosphere is warm and serene.

**Engjëjt thanë: "Larg nga të metat je
Ti o Zot! Ne nuk kemi asnjë dije tjetër
përveç asaj që na mësove Ti. Vërtet,
Ti je i Gjithëdijshtëm e i Urtë."**

(Sure Bekare: 32)